

BIBLIOTEKA
SHTETIT

S1H-32
L 53

NASI LERA

ERA E PISHAVE

Tregime

814-32
253.

NASI LERA

ERA E PISHAVE

tregime



SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

UDHËTIM NË DIMËR

— Po qe se nuk të vjen keq për veten tënde, të paktën të të vijë për djalin, — tha banakieri.

— S'kam nevojë për mend, — tha shoferi dhe vështroi jashtë.

Banakieri nuk u fye dhe vazhdoi të fshinte tavolinat. Djali rrinte si i hutuar dhe nuk po kuptonte gjë prej gjëje. Ajo sallë e vogël sikur po ia merrte frymën. Donte të thoshte diçka, por trembej. Dëbora binte e ngrirë, dhe era e përplaste me forcë te xhamat e kllubit. Rruja ishte e shkretë. Ajo dëborë dhe ajo erë i kishëte mbyllur shumë shpejt nëpër shtëpi njerëzit.

— Shkoni sa nuk janë zënë vendet në hotel dhe këputjani gjumit, — tha përsëri banakieri.

— Të thashë një herë, nuk kam nevojë për mend! — ia ktheu Petroja, shoferi.

— Në qafë paç veten, po ç'taksirat ka djali! Atij po i mbyllen sytë.

— Jo, — tha djali, — nuk më flihet. — Dhe e pa që i ati qeshi lehtaz. «Lu bë qejfi», mendoi.

Banakieri mbaroi, së fshiri dhe vajti e u ul pranë një mangalli, ku po digjeshin thëngjijtë e fundit. Nxori paketen dhe i zgjati një cigare Petros. Ata e ndezën dhe nuk folën një copë herë të gjatë. Dëbora përlasej

te xhamat e klubit, sikur donte të ulej dhe ajo pranë mangallit.

— Kur fillon kështu dëbora, nuk di të pushojë, — tha banakieri.

— Mirë, mirë, — tha Petroja, — e ka kohën.

Djali e dinte se i ati nuk i trembej asgjëje. Ai i përballonte të gjitha. Kështu kishte ndodhur gjithmonë: i ati kënaqej kur mposhtte diçka. Edhe tani po bëhej gati. Djali nuk donte t'ia prishtë këtë kënaqësi. Shumë gjëra nuk i dinte, me gjithatë, e ndiente turbull forcën e të atit. Dhe ishte i lumtur. Dhe përsëri kjo lumturi ndryshonte nga ato që kishte provuar deri atëherë. Dhe nuk e zbërthente dot. Djali rrinte i menduar. I ati shau nëpër dhëmbë.

— Eja të shkojmë bashkë në hotel, — tha banakieri. Petroja e vështroi me inat dhe tha:

— Po të mërzitëm, ma thuaj troç.

— Jo, — tha banakieri, — jo. Unë kam hallin e djalit. Ti kështu ke qenë gjithmonë.

Djali u mat ta kurdërshtonte banakierin, por nuk foli dot. Në klub po hynte të ftohtët e asaj nate dimri. Ai mezi po priste sa të shuhej mangalli. Jashtë kishte dëborë dhe erë. Dhe nën atë dëborë e erë dredhonte një rrugë malore, që të çonte në qytetin e tij. Edhe ndonjë hallexhi që, para se të niste dëbora, kish ndër mend të merrte rrugën, tani me siguri që rrinte në shtëpi. Ajo natë ishte e tëra nën pushtetin e dimrit. Ata kishin hyrë në klub që para se të errej. Petroja, me sa dukej, kishte pritur ndonjë shok, por, për çudi, atë ditë nuk lëviznin fare makina. Qyteti ishte shumë i vogël, dhe dimri sikur e zvogëlonte akoma më tepër. Në pranverë ai gjallërohej si bimët, sepse ishte një qytet pranë pyllit. Tani gjithçka sikur mbulohej nga qetësia e pritjes dhe nga qetësia e bardhë e dëborës. Dhe banorët e atij qyteti nuk kup-

tohej se cilën stinë pëlqenin më shumë, sepse të gjithë ishin qeflinj gjahu. Djali vente në atë qytet me gëzim, sepse aty kishte edhe pyll, edhe lumë të rrëmbyeshëm. Aty kishte çdo gjë që i pëlqen një fëmije.

— Do të kemi gjah, — tha banakieri.

— Çfarë? — tha Petroja.

— Do të kemi gjah. Të dielën dola për lepuj dhe vrava dy.

— Kur të vrasë ndonjëri derr të egër, më mbaj ndonjë kofshë.

— Mirë. — Banakieri heshti një hop, pastaj shtoi:

— Kur kishe ndër mend të niseshe, të ishe nisur pa u ngrysur.

— S'kam nevojë për mend, — tha përsëri Petroja.

Banakieri u ngrit dhe la ndezur vetëm një dritë. Ajo e theksoi edhe më tepër atë natë me dëborë dhe erë. Dhe djali. u trondit. Ai kujtoi rrugën që duhej të bënin përtë arritur në qytetin e tij. Rruga ishte malore, plot kthesa dhe zakonisht bllokohej nga dëbora.

— Si thua? — iu drejtua i ati.

— Përse? — tha djali.

— Të nisemi apo jo?

Petroja i foli me një ton të tillë sikur i biri të ishte shok me të. Djali ngurroi dhe nuk dinte si të përgjigjej.

— Na jep ndonjë gjë, ta kemi për rrugës, — tha Petroja.

— Gjithmonë do të bëhet jotja, mos vdeksh kurrë!

— tha banakieri. Ai hyri prapa banakut dhe mori diçka, të cilën e mbështolli me një letër ambalazhi. Petroja u bë gati të paguante.

— Jo, — tha banakieri.

Kur dolën jashtë era u përplasi me forcë dëborën e ngrirë. Kabina e makinës ishte zbardhur. Edhe drutë që kishin ngarkuar po ashtu.

— Ndofta.

Makina kaloi urën e vogël, dhe Petroja ndërroi shpejtësinë. Zhurma e motorit u bë më e theksuar. Në një kthesë rrotat xhiruan, por Petroja manovroi me shkathësi. Djali ktheu sytë nga i ati dhe iu duk sikur ai e kishte harruar fare. Lëvizi për të têrhequr vëmendjen, por i ati i kishte mbërthyer sytë te rruga. Dëbora këtu ishte më e trashë se në luginë dhe binte më e dendur. Fshati më i afërm ishte përtej majës së malit. Në mal rrufetë kishin djegur shumë pemë. Ato nuk dukeshin tani, por djali përfytyronte mirë. Çdo gjë që i kishte lë-në mbresë, ai e përfytyronte mirë.

— Të paktën të vemi deri tek burimi, — tha Petroja.

Djali nuk dinte si t'i përgjigjej dhe pa e kuptuar as vetë sesi, tha:

— Më mirë të mos ishim nisur fare.

I ati ktheu kokën dhe qeshi.

— Jo, — tha, — mos u bëj pishman. Nuk është mirë kur bëhesh pishman.

— Unë thashë për ty, se mos sëmuresh.

— Nuk më gjen gjë, jo!

Petros i bëhej qejfi që djali fliste ashtu. Ata nuk kishin biseduar ndonjëherë kështu. Nata dhe koha e keqe e kishin shkrirë largësinë e moshave, siç shkrinte shpejtësia objektet gjatë rrugës. Megjithatë, ai ishte prind dhe kishte çastë që pendohej. Djali ishte i vogël, kurse dëbora do ta bllokonte rrugën, dhe era do të hynte në kabinë e acartë. Mbase nuk duhej të ishte nisur. Të kishte fjetur në qytetin e vogël. Sa vajti ora? Dhjetë? Qenka shpejt! Zakonisht në këtë orë djali flinte. Tani s'kishte pikë gjumi në sy. Domethënë se nuk ishte më i vogël. Kishte kohë që ai donte ta merrte me vete në një udhëtim si ky i sotmi. Edhe djali kishte kohë që e ëndërronte këtë. Djali

duhej të dinte për vështirësitë e rrugës. Makina ecte, e djali nuk e dinte mirë ç'do të thoshte të mbeteshe në rrugë nga dëbora.

Djali mendonte: «Babai është i fortë. Djall, o erë! Nga nise kështu tani! Babai më do shumë... S'paska kluar asnje makinë sonte. Do të mërzitesha, po të mos ishim nisur. Punë e madhe se do të flemë jashtë! Babai gjithmonë fle në makinë. Ai sillet me mua sikur të jem burrë».

Makina u drodh e tëra dhe rrëshqiti pak nga e majta. Petroja nuk frenoi, por lëvizti timonin me shpejtësi sa nga e majta, aq dhe nga e djathta. Pastaj makina u shtrua përsëri. Ishte diçka e çuditshme dhe krejt e papritur. Petroja pinte cigare. Ai e dinte se ky ishte revoltimi i parë i makinës. Djalit i vinte për të qeshur me makinën. Ajo u zbut menjëherë, si një lepur. Dhe ata ecnin shumë ngadalë në atë rrugë malore, ndërsa dëbora vazhdonte të binte shtruar dhe dukej që s'kishte ndër mend të pushonte atë natë. Djali nuk orientohej dot. Ndiente flokët e dëborës që përplaseshin në xhamam e sillte para syve dritaren e shtëpisë. Edhe mbi xhamat e saj tani përplasej dëbora, kurse motrën, me siguri, e kishte zënë gjumi. Dhe pëllumbat, ndofta, nuk i kishte mbyllur njeri.

— Keq e kemi, bir, — tha Petroja.

— S'ka gjë, baba.

Petroja donte të thoshte se kishte merakun e tij, por heshti. Ai çuditej me qetësinë e djalit dhe i dukej sikur ajo ishte e rreme. Ai e urrente çdo gjë të rreme. Dhe kishte çaste kur nxohej, por lehtësohej kur shikonte të birin, që i mbante sytë të ngulur nga rruga. Pastaj ndizte cigare dhe shpesh, pa e kuptuar, këndonte. Fjalët nuk merreshin vesh. Petroja këndonte si për vete.

Dritat ranë mbi jazin e mullirit, mbi shelgjet e gjata dhe grykën e thellë shkëmbore. Djali u mat ta pyeste

të atin se përse pranë mullinjve ka gjithmonë plepa, por atë çast dalloi ndërtesën dhe dëborën që kishte shkuar deri te mesi i derës. Mulliri ishte i shkretë. Djali u trish-tua. Nuk e përfytyronte dot një mulli të shkretë, pa zhurmë. Ishte hera e parë që haste në një mulli të tillë. U mblohd në sedile. E mbuluan mendime të shumta dhe në fantazinë e tij filluan të binin të shqetësuara flokë dëbore. Dhe ajo që e trembi më shumë ishte dëbora e vetmisë. Ajo ishte një dëborë e rëndë, e hirtë, e plumbtë, e hekurt, e ftohtë, por aspak e bardhë dhe fëshfërítëse. Nën peshën e saj shkretoheshin mullinjtë, peshqit mbe-teshin nën akullin e lumenjve, sorkadhet thithnin me zor ajrin dhe zgurdullonin sytë, pëllumbave u pritej forca e krahëve dhe këputeshin nga fluturimi si gurë, zhurmat fashiteshin... Në atë çast i ati e përfshiu për krahësh dhe e puthi në flokë.

— Baba, — tha djali, — do të më marrësh gjithmonë me vete?

I ati nuk u përgjigj. Makina po bënte xhiro. Petroja i dha makinës prapa, pástaj e nisi me shpejtësi, por nuk e kaloi dot pирgun e dëborës. Térhoqi frenat e dorës. Djali mbeti vetëm në kabinë dhe zuri vendin e shoferit. Petroja dukej nën dritat e makinës tek kontrollonte rrugën dhe provonte trashësinë e dëborës. Pastaj humbi. Djali ndjeu përsëri praninë e mullirit të braktisur. «Ç'ësh-të këshfu!» tha ai me vete.

Me t'u dukur i ati, kjo ndjenjë iu zhduk, si të mos ishte shfaqur fare në trurin e tij të shqetësuar.

— E? — tha djali.

— Keq e komi, — i tha i ati. — Jemi vonuar. Era ka hedhur shumë dëborë.

— Si do t'ia bëjmë?

— Ky vend është ters. Dimrin e kaluar këtu u rrë-zuan dy makina.

— Unë them ta kalojmë, — foli djali.

I ati, që deri atëherë nuk e kishte parë në sy, ktheu kokën.

— Do që të dukesh trim? — i tha.

Djali u fye, por e mbajti veten.

— Jo, — tha ai.

— Dil më trego rrugën, — i tha i ati.

Atë çast era solli një ulërimë të largët, por Petroja me djalin e dëgjuan. Heshtën dhe pritën. Ulërima nuk u dëgjua më.

— Hë, — tha Petroja, — do të dalësh?

— Po, — tha djali dhe hapi derën e doli pa e parë të atin.

«Nuk shtiret», mendoi Petroja.

Djali u fundos në dëborë deri në mes. E çau atë me zor dhe doli para makinës. Gjeti një vend ku kishte më pak dëborë dhe ia bëri me shenjë të atit ta niste makinën. Atë çast ulërima erdhi më e qartë. Djali hodhi sytë atje ku shuheshin dritat. Frynte erë. Ia bëri me dorë të atit ta niste makinën. «Ç'pret akoma?» u nxeh ai dhe u mat të thërriste. Ulërima erdhi nga e majta. Andej ishte pylli. Pishat fërshëllenin. I keni dëgjuar si fërshëllej-në pishat në dimër kur bie dëborë dhe fryn erë? Djali e dëgjonte për herë të parë zhurmën dimërore të pyllit të lashtë të pishave. Ai po e dëgjonte për herë të parë ulërimën dimërore të ujjqërve. Ai eci pak djathas dhe i thirri të atit. Motori i makinës e mybiti zërin e tij. Djali u tremb. Për një çast e mendoi veten aty pa njeri pranë, se zëri i tij nuk po gjente përgjigje. Por pastaj tha se nuk duhej të trembej. Makina u tund dhe filloj të lëvizte me rrëshqitje. Petroja preu timonin nga e djathta dhe përsëri frenoi. Djali iu afrua edhe më.

— Është e kotë, — tha. — Sonte nuk dilet dot. Dëbora është shumë e trashë.

— E di, — i tha i ati. — Kjo grykë bllokohet gjithmonë.

Djalin e kishte mbuluar dëbora. Ai ishte bërë krejt i bardhë.

— Shiko mos ka ndonjë vend me pak dëborë, — tha Petroja.

— Është një, por është buzë rrëpirës dhe mund të rrëshqasësh.

— Dil para makinës dhe më drejto.

Djali doli para makinës dhe ia bëri me shenjë. Ai e cte praptaz në mes të dy dritave. Petroja i futi marshin makinës dhe i preu timonin. Makina u nis duke u lëkundur. Rotat po i afroheshin rrëpirës, duke ngrënë me dhëmbëzat e tyre centimetrat e tensionit. Djali e cte, dhe sytë i mbante mbërthyer te rrotat. Ato i dukeshin më të mëdha, sesa ishin. Dukeshin si dy hije të rënda që shtynin dëborën. Që të dy harruan gjithçka. Djali harroi veten dhe mendonte për të atin. Jeta e të atit varej tani nga ato dhëmbëza dhe nga dora e tij e vogël që lëvizte ngadalë. Era e kishte fshirë dëborën në buzë të rrëpirës. Tani aty shkelën rrotat e makinës. Ato ecën, ecën... Djalit iu duk kohë e gjatë, kurse Petros jo. E kaluan vendin e bllokuar dhe tani po ecnin drejt majës. Djali kishte të ftohtë. I ati i hodhi velencën që mbante prapa sediles. Kur kapërcyen Gurin e Bardhë, para makinës kaluan disa ujq. Ata kaluan shumë shpejt, dhe djali, që gati po dremiste, nuk i vuri re mirë.

— Janë të uritur, — tha Petroja. — I dëgjove si ulërinin?

— Po, — tha djali.

— Ke frikë?

— Nuk e di.

Udhëtuan tërë natën. Djali zbriti edhe herë të tjera

rrugës. Ai hapte derën, kërcente jashtë, dhe dora e tij e vogël lëvizte duke treguar vendet me pak dëborë.

— Nuk do të ishim nisur, — tha Petroja kur nga larg u duk qyteti i zhytur nën perden e qetë të dëborës, që binte më e rrallë, — por nesër kam një punë tepër të rën-dësishme në park. Më presin shokët, por s'desha të të thosha.

Djali mezi hapi sytë dhe vështroi i habitur! I ati qeshi dhe i tha:

— A u trembe ndonjëherë?

— Po. Kur pashë mullirin e shkretë. Vetëm atëherë.

— Mirë, — i tha i ati.

Por djalin e kishte mposhtur gjumi. Petroja i mbuloi shpatullat e dobëta dhe e puthi në flokë. «Do të bëhet burrë i ndershëm», tha me vete.

DY NJERËZ MES ACARIT

Mbas pak në qafën e Malit do të fillonin erërat e ftohta që vinin nga Alpet. Ato do ta vërtitin dëborën në një valle të çmendur dhe do të zhduknin çdo gjë: edhe rrugën, edhe pishat, edhe shpatetet, herë të gurta, herë të gjelbra. Naimi nuk i njihte këto erëra, që vendasit i quanin murani. Ai, përveç një farë hutimi, nuk ndiente gjë. Kur hodhi sytë përtëj xhadesë, nuk i pa më malet e Munellës dhe të Kurorës së Dardhës. Ato sikur qenë zhytur nën hapësirën e hirtë të dimrit dhe të reve të rënduara të Veriut. Pishat dhe ahet dukej sikur ishin gjetur në befasi dhe, të habitura, prisnin atë që do të ndodhë pas pak. Naimi nuk e dinte se kështu ndodhë zakonisht në dimër në Qafën e Malit, se në pritjen e pishave dhe të aheve kishte diçka të përjetshme, të qetë dhe të sigurtë. Rruga ishte e shkretë. Ajo dredhonte, duke u kacavjerrë, si një hardhi e vjetër. Në një kthesë ai i ra borisë dhe thithi cigaren. Flokët e rrallë, që u përplasën mbi xhamin e kabinës që kur ai kaloi restorantin në Ujët e Ftohtë, tani po dendësoheshin dhe po bëheshin më të ngrira në rënien e tyre të çrregullt. Pastaj, kur u fut në një grykë të vogël, iu drodh timoni. Kishte kaluar në një korent ere. «Dreq!» tha Naimi. Dhe ai nuk i njihte erërat që do të fillonin pas pak në Qafën e Malit. Retë e rën-

duara u ulën pranë grykave dhe, krejt papritur, dëbora u dredh mbi rrugë, tamam sikur majat e pishave e të aheve të kishin shqyer barkun e reve. Naimi shkeli gazin dhe për herë të parë mendoi se nuk duhej të ishte nisur. Por e harroi shpejt këtë. Moti i keq dhe rruga e panjohur i thithën çdo mendim. Ai tha se duhej të arrinte me çdo kusht në Fushë-Arrëz. Nuk e vuri re traktorin, që Pjetër Deda e kishte lënë anës xhadesë. Iu duk si shkëmb. Dhe e kaloi e u zhduk pas kthesës së parë.

— Ku e shpie mushka këtë të çmendur! — tha Pjetër Deda dhe ndezi traktorin. Ai po bëhej gati të shkonte në shtëpi. Të nesërmen do të kishte shumë punë për të hapur rrugën nga gjithë ajo dëborë që do të hidhte natën era. Pjetër Deda u nis prapa makinës, duke folur me vete:

— Kushedi se ç'hall ka dhe ai.

Traktori ndiqte rrotat e makinës me një ecje të sigurtë, por të ngathët.

— Nuk do të shkojë shumë larg, — tha përsëri Pjetër Deda.

Por Naimi po largohej më tepër sesa ia priste mendja Pjetër Dedës. Dëbora përplasej e përplasej pas kabinës me egërsi. Motori ulërinte, si një kafshë e egër, e zënë në kurth. Pishat vërvhellenin, dhe dëgët e tyre të hallakatura dukeshin sikur donin të mbërthehenë me njëra-tjetrën. Dhe, sa po halat e tyre të holla çiknin njëra-tjetrën, futej era dhe i largonte. Dhe përsëri, sikur donte të tallej, era i afronte dhe i largonte, por kurrë nuk i linte të mbështeteshin bashkë në këtë buzëmbrëmje dimri të Veriut. Ahet ishin më delikate në përkuljen e tyre. Kishin kohë që ishin zhveshur. Pranvera donte kohë të vinte. Naimi i vështronte të gjitha këto dhe përsëri thoshte se në Fushë-Arrëz do të arrinte patjetër, megjithëse pak me vonesë. Turiri i makinës, si turiri i një dhëpre, ngjishej pas dë-

borës, sikur e nuhaste. Ishte e çuditshme si nuk po bllokohej akoma. Dhe ndodhi ajo që parashikonte Pjetër Deda. Makina u përplas pas dëborës së hedhur nga era. Naimi hapi derën, dhe sedilet u mbushën menjëherë me dëborë. Ai e mbylli derën dhe kërceu përtokë. U fundos deri në mes në dëborë.

— Ej, — tha, — mos kam ndërruar rrugën!..

Ai nuk i njihte erérat që fryjnë në Qafën e Malit dhe dëborën që bllokon çdo gjë. Eci me vështirësi dhe doli para makinës. Fytyra i ngriu dhe iu zbardh menjëherë. Ngriti kokën lart, sikur të shikonte se edhe sa kishte ndër mend të vazhdonte ajo kohë e keqe. Në hapësirën përreth vetëm dëborë e dendur, si mijëra miza të vogla, të bardha, që nuk dinin nga të shkonin. Naimi u kthyte përsëri në kabinë. I dha makinës prapa. Si u largua pak nga pirgu i dëborës, u nis me shpejtësi. Por ngeci. Ai e përsëriti disa herë këtë, por më kot. Nuk i besohej se ishte bllokuar. Zbriti dhe pirgu i dëborës iu duk më i madh se në fillim. U fut në dëborë dhe çau përpara. Ecej me vështirësi. Po të qenë bllokuar vetëm disa metra rrugë, ai do t'i pastronte ato, sikur ç'të bëhej, sikur t'i duhej që për këtë punë ta kalonte tërë natën jashtë, nën atë erë të fortë dhe të ftohtë. Por era kishte hedhur dëborë kudo, dhe Naimi, sado që largohej nga makina, me një shpresë të tendosur dhe krejt i bardhë, si një pishë e rënduar, nuk donte t'ia pohonte vetes se ishte bllokuar keq.

Ai çante me gjoks dëborën dhe as që e kthente kokën prapa. Iu duk se ishte larguar mjaft nga makina. Por nuk kishte bërë as pesë metra. Dëgjohej zëri i pishës që përkulej dhe kërcitja e degëve të thata që këputeshin. As gjë. Kishte kaq kohë shofer dhe nuk kishte parë aq dëborë. Ai ishte nga bregdeti. Kishte shpënë portokalle në Kukës.

— U pa puna për sonte, — tha dhe u kthyte.

Ishte errur. Mbi sedile ishte shtruar dëbora. Ai e fshiu dhe ndezi dritën e brendshme. Dhe atëherë sepse iu duk për një çast sikur hyri në dhomën e shtëpisë. Mbështeti ballin mbi timon dhe zuri të mendonte kët për ç'gjë t'i vinte në mendje. Kishte dy fëmijë dhe gruan. Ata nuk e prisnin të kthehej sonte. E prisnin nesër. Djali i vogël do të dilte për ta pritur në të dalë të qytetit, atje ku rruga i afrohet detit. Naimi qeshi. Djali do të rrinte gjatë, deri vonë dhe do të kthehej në shtëpi vetëm. Ndezi një cigare dhe tha:

— Të kisha qëndruar tek Ujët e Ftohtë.

Naimin e mbanin për burrë të qetë dhe të ndershëm. Edhe si shofer ishte i zoti. Ai filloi të përtyppte me nge hoshafet e kumbullave që kishte blerë në Kukës. Përtej xhamave nuk dukej gjë. Ndihej përplasja e dëborës dhe ulërima e erës, që dukej sikur donte t'i shkulte nga rrënjët pishat dhe ahet. Nuk e njihet vendin dhe nuk e dinte se ku ndodhej, se sa larg ishte fshati më i afërt dhe qyteti i vogël i Fushë-Arrëzit. Seç kanë diçka të ngrohtë qytetet e vogla të Veriut në dimër. Naimi këtë e kishte provuar rrallë, por mjaftonte të zije në gojë, kur bisedoje, atje në Jugun e ngrohtë, emrin e ndonjë qyteti, dhe me siguri përfytyrimi do të sillte para syve dëborën, pishat, shtëpitë e mbuluara krejt me të bardhë dhe dritat e verdha mes bardhësisë së dimrit. Seç kanë diçka intime emrat e qyteteve të vogla të Veriut në dimër... Naimi po kotej. Ishte lodhur. Të ftohtët nuk e linte të flinte. Ai hodhi supeve batanijen e leshtë. Tha me vete se nata do të ishte e gjatë, por, po të pushonte era, ai do të bënte një sy gjumë. Nuk u përfytyronte dot se ç'ndodhë përjashta. Futi në gojë një hoshaf kumbulle dhe po e përtyppte ngadalë. Tani po e kuptonte se rruga e kishte lodhur. «Sikur të bëj një sy gjumë...» tha.

Pjetër Deda ishte nxehur, Shoferi kishte shkuar më



larg, sesa e mendonte ai. Dhe përsëri tha se shoferi do të kishte ndonjë hall. Dritat e fuqishme të traktorit nuk e çanin dot dëborën e dendur. Dëbora hynte në kabinë dhe atij i kishin ngrirë këmbët. Vendin e njihte mirë dhe fshati më i afërt ishte nja gjashtë orë me këtë ecje breshke. Ai i urrente breshkat, megjithëse i dukeshin të urta dhe të shastisura. Pjetër Deda ishte burrë i duruar, i avashëm, por, kur i kërcente damari, kishte diçka që i ngjiste përrenjve malorë. Ferkoi me dorë këmbët dhe shkundi dëborën nga flokët. Rruga po vështirësohej, sa kishte rrezik ta humbiste. Alpet derdhnin mbi Qafën e Malit gjithë egërsinë e tyre dimërore. Pjetër Deda i njihet mirë erërat dhe e dinte se ato do të pushonin në mëngjes. Por deri atëherë gjithçka do të ishte tepër vonë, se do të mbulohej nga dëbora.

— Ku drequin është struktur! — tha Pjetër Deda.

Më tej nuk mund të ekte. Dëbora ngrihej si një ledh i huaj dhe i pakapërcyeshëm. Mbi majën e ledhit era i vërtiste flokët e dëborës në një kërcim të rrëmbyer dhe të egër. Kur ishte i vogël, i pëlqente të shikonte që nga dritarja e kullës kërcimin e dëborës që shtrohej e shtrohej. Njerëzit mbylleshin brenda dhe mbi mure dukej sikur endej trishtimi i dimrit. Babai bëhej më nevrik, se kurrë ndonjëherë. Ndërsa ai, Pjetër Deda, këndonte këngën e gjatë dhe monotone të pristes së pranverës.

— Ai duhet të jetë diku këtu pranë! — tha Pjetër Deda.

Fiku traktorin me një ndjenjë mërzie dhe doli jash-të. Nuk dukej gjë. Ai filloj të zvarisej mbi dëborë. Ekte ngadalë, sepse e pengonte era. Atje ku duhej të ishte një shpat, u çua dhe bëri disa metra në këmbë. Pastaj u mbështet pas një pishe. Fshiu fytyrën me pëllëmbë. Nuk ndjeu asgjë nga kjo prekje. Ishte i sigurtë se tjetrin do ta gjente pas pak. Dhe përsëri u rrëzua poshtë shpatit me

zvaritje. Era u vërtit rreth tij, sikur donte ta shkulte dhe ta pérplaste diku poshtë, në grykën e pérroit. Pjetër Deda ishte bërë aq dhe s'e kishte ndier ndonjëherë frikën e vdekjes. Dhe kjo zvaritje e tij drejt një njeriu të blokuar nga dëbora, i dukje si një nga ligjet e jetës kundër frikës së vdekjes. Pjetër Deda kishte kënduar një këngë të tillë dikur, kur mbi muret e kullës tendosej si tel çiftelie monotonia e netve të vetmuara të dimrit. Kënga ishte e zgjatur dhe të godiste në kokë me durim, si një ujëvarë, Ajo niste që në shtator dhe mbaronte në prill, kur ahishitet dridheshin lehtë nga erërat e ngrohta. Pjetër Dedës i ngrinë këmbët. Dhe ai shau erën që kishte nisur atë natë. Ai e shau erën jo sepse u tremb, por sepse ajo kishte hedhur dëborë mbi rrugën e një njeriu që duhej të kishte hall. Ai u mbështet përsëri pas një pishe të lashtë dhe ngrohu duart me frymë. Qerpikët i kishin zënë akull. «Edhe pak», i tha vetes, por nuk u largua nga trungu i pishës. Ajo tundej, sikur do të shkulej nga rrënjet. Pjetër Deda qeshi. As vetë nuk e kuptoi pse qeshi. Pisha ishte rritur nën atë erë, nën atë dëborë, nën atë dimër. Dikur kishte parë një pishë të butë në Tiranë, që ishte rrëzuar mbi bulevard. Ai i qe afruar te rrënjet. Ato nuk ishin të thella, dhe tabani ishte i butë. Pjetër Deda ishte largua i trishtuar. Pisha kishte qenë e bukur, vetëm kaq, e bukur...

Ai doli nga trungu dhe zbriti poshtë. Iu bë sikur dëgjoi një ulërimë të papërcaktuar. Ndonjë egërsire i ishte prishur strofulla dhe tanë pérplasej, e dëshpëruar, honeve të Qafës së Malit. Pjetër Deda nuk e mori vesh se çfarë egërsire ishte ajo. Ai zvarisej drejt njeriut të bllokuar nga dëbora. Era e godiste mbi fytyrë dhe ia vriste sytë. Shpesh i merrej edhe fryma. Nuk e mbante mend se sa ishte zvaritur ashtu dhe sa duhej të ishte ora. Në një dimër të tillë çdo gjë humbet kufijtë e saj: edhe koha, edhe hapësira, edhe vetë mosha e njeriut. Për

Pjetër Dedën në ato çaste tërë jeta e tij ishte mbledhur që nga zvaritja e tij e parë në dhomën e madhe të kullës, në burrërinë e tij e deri tek kjo natë e ftohtë e me furunë. Dhe ecte ai, tani i mbuluar krejt me dëborë, si një shpresë e bardhë. Ky nuk ishte dimri i parë i ashpër dhe, megjithatë, kishte diçka që nuk e kishte njobur deri atëherë. Pjetër Deda e kishte zët ta vriste gjatë mendjen. U dëgjua zhurma e një orteku që humbi përtej përroit. «Nuk është i madh,» tha ai. Lëpiu buzët. Ato i qenë plasaritur dhe i digjinin. Kërciti një pemë, dhe fare pranë era rrakulliste degë të thata dushku. Ato u zhdukën si hije. Nga zvaritja e gjatë, Pjetër Deda nuk po i ndiente më shpatullat. Dhe tha se nuk ishte aq i fortë, sa e mban te vëten. Dhe prapë, duke sharë nëpër dhëmbë lodhjen, eci drejt makinës, që tani duhej të ishte diku aty pranë. Era pushoi për një çast. Pjetër Deda ngriti kokën, i habitur. Mos vallë ishte shurdhuar dhe nuk dëgjonte nga lodhja? Në atë errësirë të bardhë, dëbora, si e çliruar nga një ankth, binte butë. Nanurisja e saj ia kapiti sytë, dhe ai uli kokën lehtë. I flihej. Pastaj turfulloj si ndonjë kalë dhe ngjeshi kokën mbi dëborën e ngrirë. Era, si më parë, frynte papushim. Ishte çarë shakulli i erërave alpine.

«Më flihet, se jam këputur,» tha Pjetër Deda dhe i dha me tërë forcën trupit përpara. Cipa e sipërme e dëborës kërciti, dhe ai u fundos. Doli me zor dhe ndjeu që dora iu ngroh. Ai e lëpiu dhe provoi shijen e gjakut. E lëpiu edhe një herë dhe ndjeu t'i ngrohej tërë trupi. Kafshoi dorën derisa i theri në zemër. Dhe bëri disa metra. «Ai duhet të jetë diku, këtu pranë», tha me vete dhe thirri:

— Eeeeej!

Zëri, i përzier me dëborë, u përhap nëpër natë. Atë zë asnjeri nuk do ta njihte. Ai i ngjiste sa fillimit të një

kënge, aq edhe një kushtrimi, sa një thirrjeje të vvetves, aq edhe një thirrjeje dikujt që ishte larg. Njeriu që lëshoi thirrjen u gëzua më shumë, sesa ai që do ta dëgjonte Dhe Pjetër Deda thirri përsëri.

— Eeeeej!

Dhe era, dhe pishat, dhe grykat ia bënë «eeee!»

Pjetër Deda e kuptoi se nuk duhej të pushorëtë asnjë çast. U ngrit në këmbë dhe qëndroi ashtu duke u lëkundur, si ndonjë pishë e njomë. Hodhi hapin e parë. Këmba e majtë iu fut brenda në dëborë. Ai mbeti si një vapor, të cilit i fundoset fundi dhe çon lart majën e mprehtë. Pjetër Deda u shtri dhe përsëri nisi zvaritjen. Iu duk sikur e dalloi nga lart makinën. Mbylli fort sytë. Asgjë. Errësirë. Makinën do ta kishte mbuluar dëbora. Ai tani i fitonte me më shumë vështirësi metrat.

Kështu kaluan aq orë, sa u tremb se mos e kishte lënë prapë makinën. Ai nuk i ishte shhangur xhadesë, e kishte ndjekur me shumë kujdes, por në një kohë të ti-lë gjithçka mund të ndodhë. Dhe nuk ishte çudi që të shihte vezullimin e zbehtë të dritave të Fushë-Arrëzit. Tani nuk e donte aspak këtë gjë, tani që ishte vetëm dhe i dërrmuar nga lodhja. Veshët i buçisnin nga era. Fërkoi fytyrën me dëborë, por përsëri nuk e ndjeu të ftohtët. U bë gati të therriste, kur shkrepëtiu. Dhe Pjetër Deda u mundua të shikonte nën dritën e saj makinën e fundosur mes dëborës, si një kasolle e braktisur barinjsh. Por nuk u shfaq asgjë nën dritën e shkrepëtimës. Vetëm malet u shfaqën. Megjithatë, shkrepëtimat do të përsëriteshin. Përsëritja po vonohej. Gryka rrokullisi zhurmën e rrufes. Pjetër Deda bëri tutje, duke shternguar dhëmbët tërë inat. Dhe kur shkrepëtiu (Pjetër Deda nuk e mbante mënd për të satën herë), ai dalloi diçka të zezë. Dhe vetëm kur e preku me dorë parafrangon, e kuptoi

se ajo ishte makina që e kishte kërkuar tërë natën nëpër stuhí.

Naimi u çudit dhe në fillim nuk e besoi se ishte njeri ai që shihte. Ai i ngjau si një ari, që nuhaste erën e njeriut të mbetur vetëm atë natë. Por njeriu ra përmbyss mbi parafango dhe nuk po lëvizte. Naimi hapi me zor derën, i hodhi krahun, e futi në kabinë dhe e shtriu në sedile. Njeriu dukej sikur flinte. Ishte i dërrmuar dhe tanë po flinte. Veçse nuk kuptohej përsë ky njeri kishte dalë nga shtëpia mes atij moti të keq. «Me siguri ka pasur ndonjë hall», tha Naimi dhe donte ta mësonte sa më parë hallin e njeriut që flinte mbi sedile. E tundi disa herë, por njeriu nuk përmendej. Naimi filloj të shqetësohej. S'dinte ç'të bënte. Nuk i kishte ndodhur ndonjë rast i tillë. Megjithatë, filloj ta fërkonte. Njeriu i ngrirë hapi sytë dhe hovi përpjetë, i turpëruar.

— Sa më ke lodhur! — tha njeriu. — Paske shkuar larg...

Naimi nuk mori vesh nga ato që tha njeriu dhe iu duk se foli përqart.

— Mos u bëj merak, dëbora do të pushojë.

— E njoh më mirë se ty kohën, — tha Pjetër Deda.

— Prej këtej je ti?

— Prej nga të jem? Po ti paske shkuar larg.

— Doja të arrija patjetër në Fushë-Arrëz.

— Të kishe qëndruar në Ujët e Ftohtë.

— S'ma mori mendja se do të bëhej qameti.

— Ke të drejtë. Ti nuk e njeh si duhet këtë vend.

Më bëre merak. Kur nuk po të gjeja dot, thosha se ishe rrrokullisur në ndonjë hon.

Naimi përsëri dëgjonte, i habitur. Njeriu i ngrirë dukej sikur bisedonte me dikë tjetër të cilin e kishte kërkuar nëpër natë.

— Si dukesh? — i tha. — Mos të kanë ngrirë këmbët?

— Nuk e di, por sikur si ndiej mirë.

— Ç'hall të shtyu të dalësh jashtë në këtë qamet?
Pjetër Deda qeshi dhe tha:

— Puna. Jam traktoristi që hap rrugën nga dëbora. Kur më kalove pranë, të shava; pastaj thashë se do të jesh jabanxhi dhe të ndoqa prapa. Mezi të gjeta.

— Si e ke emrin?

— Pjetër Deda.

Dhe asnje nuk foli. Era përplaste dëborën xhamave. Pishat ulerinin. Ata të dy dy shikoheshin në sy, si dy njërez që e kanë kërkuar njëri - tjetrin për një kohë të gjatë. Naimi s'kishte nevojë të pyeste më për Pjetër Dedën. Ai e njihte shumë mirë. Mjaftonte të dëgjonte si ulerinte era, si kërcisinin pishat, si u prishej strofulla egërsirave, që të njihte Pjetër Dedën.

NDOCI I MIRË

Aty nga ora tre e natës filloj të binte shi. Pikat zunë të binin të mëdha, të rralla, sikur i kishte hedhur era mbi xham. Gazetarin nuk e kishte zënë gjumi akoma dhe, nga që tërë ditën nuk kishin biseduar veçse për një shi, nuk u zuri besë veshëve. Ishte zagushi. Gushti po mbante me të nxeh të dhe misrat donin ujë. Shiu ishte kudo në qendër të çdo bisede. Toka lëshonte një afsh të rendë. Mbi xham trokitën përsëri pikat e shiut. Këtë radhë më të dendura dhe më të qeta. Gazetari u ngrit nga shtrati dhe hapi dritaren. Qielli ishte mbuluar nga retë; megjithëse vendevende dukeshin yjet. Ai mbushi gjoksin dhe nuk ngopej së pari kopshtet para shtëpive, majën e një malit dhe fshatin ku flinte. Iu kujtua fshati i lindjes diku në Jugë dhe fëmijëria. Ajo natë sikur kishte rënë vetëm përtë të futur në kuftime, dhe ai shi sikur po binte përtë të larguar gjumin. Gazetari ishte i ri dhe vinte përtë herë të parë në ato anë. Dhe bukuria e pyjeve të Tropojës, e ujërave të saj të pastër, e dëborës që fshihej hijeve të maleve dhe shkrinte ngadalë, duke shpërthyer në gjithë ato burime, dhe ky shi i ngrohtë vere sikur e hutuan. Ai ndjeu t'i lagej gjoksi, të pikonin strehët dhe të zhurmonte një vijë e hollë rrëzë shtëpisë ku e kishin çuar përtë fjetur. Retë zunë edhe copat e kaltra të qiellit dhe u ulën më poshtë. Tani ato rrëshqisnin ngadalë mbi fshat,

duke derdhur shiun. Erë nuk frynte fare. Nata po lahej, dhe zagushia s'ishte më. Gazetari u largua nga dritarja dhe u shtri përsëri në shtrat. U mbështet me kurriz mbas kokës së hekurt të krevatit dhe, me sytë jashtë, zuri të mendohej. Mendimet ishin të shkurtra, nga më të ndryshmet, sa e lodhën. Dhe megjithëse donte të mos e zinte gjumi, megjithëse donte të rrinte zgjuar derisa të vazh-donte shiu, nuk pati fuqi t'i mposhtte qepallat që i rën-doheshin.

Kur u zgjua, ndjeu të ftohtë. U vesh dhe doli në oborr. Dielli kishte lindur dhe gjithçka shndriste. Edhe ajri sikur kishte marrë një ngjyrë të bardhë. Qielli me ato ré të mëdha, të dendura, tufa - tufa, dukej sikur ishte ulur për të parë shiun që lëshoi natën. Gazetari shkoi nga zyra e lokalitetit të takohej me kryetarin. Kryetari po rrinte në tavolinë dhe po lexonte gazetën e djeshme.

— Si fjete? — i tha. U ngrit nga karrigia dhe i dha dorën.

— As e kuptova se si më zuri gjumi. Shiu e paska feksur kohën.

— Ishte një shi i avashëm, sikur ta kiske porositur. Edhe gjumi bëhej i rehatshëm, apo jo?

— Po, — tha gazetari. — I nxorët të dhënat?

— Përse nxitohesh? Dita tani është e madhe.

— Jo, aty nga mbasdreka duhet të nisem patjetër për në lokalitetin L. — Gazetari nuk e dinte ku binte lokaliteti L dhe sa orë duheshin deri aty. Ai do ta bënte udhën në këmbë, shkurt, mes pyllit, sepse rruga automobilistike s'kiske përfunduar akoma. Kryetari e zuri për krahu dhe dolën të hanin mëngjes. Pastaj, si mbaruan së ngrëni, shkuan në disa brigada. Orët iknin. Brigadat punonin larg njëra - tjetrës. Gazetari ishte i kënaqur. Edhe drekën e hëngrën shpejt e shpejt, sepse ai ngutej të nisej sa më parë për në lokalitetin L.

- Do të të shoqërojë Ndoci, — tha kryetari.
— Kush është Ndoci?
— Roja.

Në shkallët e bardha të zyrave po rrinte një burrë rreth të gjashtëdhjetave. Ai po pinte duhan dhe pushkën e vjetër e kishte mbështetur midis këmbëve. Ishte thatim, me ca sy si të përgjumur dhe që nguleshin diku e s'lëviznin për një kohë të gjatë. Ai pinte duhan i qetë dhe, ndryshe nga gazetari, nuk i bënte ndonjë përshtypje rruga që do të merrnin. Atë ditë rojes i flihej. Ishte lodhur, sepse kishte pasur disa punë në shtëpi dhe këmba e majtë e kishte shqetësuar mjaft. Ajo i dhimbte kur vrëhej koha dhe ndryshonte temperatura. Nuk e mbante mend se kur i ishte shfaqur ajo sëmundje. Megjithatë ai e duronte dhembjen, sado e fortë që të ishte, dhe nuk e tregonte fare as në fytyrë, as në të ecur. Vetëm kur udhetonte pa njeri, sikur i vinte rehat ta hiqte zvarë. Gazetarit nuk i kishte rënë në sy dhe, kur i njoihu kryetari, u çudit. Zakonisht, kur shkonte në zona të thella, mjaf-tonte të rrinte tri orë në një fshat dhe do t'i shikonte një herë si fytyra të gjithë burrat. Por këtë që qëndron-te tanë përpara tij, megjithëse ishte roja i zyrave të lokalitetit dhe të kooperativës, nuk ia kishte zënë syri. Por gazetari nuk e vau shumë mendjen, sepse donte të nisej sa më parë. I shtrëngoi dorën kryetarit të lokalitetit dhe iu drejtua rojes:

- Nisemi?

Roja nuk foli, por rregulloi pushkën në sup dhe u nis. I ranë përmes fshatit, ku përvëç disa fëmijëve, që linin lojën për të parë gazetarin, nuk takuan njeri të rritur.

Sapo hynë në pyll, gazetari harroi gjithçka. Dielli futej midis degëve të dendura, dhe zogjtë cicërinin tërë potere. Nga degët shpesh binin pikat e shiut. Kur pikat

rrëshqisnin dhe qëndronin në majën e gjethes për një çast, duke shin si llambushka shumëngjyrëshe nga rrezet e diellit. Sa fikej e para, ndizej e dyta. Gjethet e ahut ishin të lëmuara. Ai ngriti kokën dhe dalloi në një degë një fole zogu. Pastaj dalloi të dytën dhe fare në majë një grumbull. Shikonte zogjtë që kërcenin duke luajtur dhe e harroi rojen që e shoqëronte. Roja kishte qëndruar pak më tej dhe priste i qetë, që të nisej gazetari. Ai mund të rrinte kështu, pa folur, për orë të tëra. Gazetari e kuptoi se e teproi dhe donte të hapte bisedën.

— Të mërzita pak, më duket, — i tha.

— Jo, — tha ai, — ti mos u mërzit fare për mua.

Gazetari zuri të ecte për krah tij. Kur kishin bërë një copë rrugë dhe dielli binte në një vend të zhveshur, roja tha:

— U zbardh dielli.

— Çfarë?

— U zbardh dielli.

Gazetari nuk e kishte dëgjuar ndonjëherë këtë shprehje, prandaj mbeti i habitur. Ishte mesi i gushtit dhe të ftohtët i dukej akoma larg.

— Ç'do të thotë «u zbardh dielli»? — pyeti me drojtë.

— Filloi të ftohtët. Këtej kështu fillon, me një shi. Pastaj edhe këmba sikur po më shtrëngon.

— Pse, vuan nga reumatizmi? — e pyeti gazetari.

— Jo, jo, — tha roja, i penduar që i shkau goja për dhembjen e këmbës, dhe nxitoi hapat që ta linte pas gazetarin.

Vetëm atëherë gazetari e vuri re mirë rojen, shpatullat e tij të ngushta dhe ecjen e rëndë nëpër gjethet e rëna. I erdhi keq dhe u mat t'i fliste të kthehej. Le t'i trengonte rrugën, dhe ai do të shkonte vetë deri në lokalitetin L. Por e la për më vonë, që të mos e fyente. Rruga dre-

Q'honte nëpër degë dhe nuk mund të orientoheshe dot. Kudo ishte njëloj. Drurët e lartë me myshk e theksonin akoma më tepër qetësinë e mbasdites. Mes pyllit nuk e kuptonte dot sa mund të kishte vajtur ora. Kur u nda me kryetarin e lokalitetit, ishte mesditë. Ngaqë rruga e kishte tërhequr, i dukej sikur kishte kohë që ndodhej aty, mes drurëve, dhe sikur roja ishte një njeri që e kishte shoqëruar gjithmonë, ashtu i heshtur, i zhytur në hallet e veta. Por mungesa e zhurmave po e lodhte, sepse, sa më thellë futeshin, aq më i heshtur bëhej pylli. Roja i hidhete hapat të mëdhenj e të rregullt. Ai tërë jetën kështu kishte ecur e, po të rrinte në një vend, bëhej nevrik e lodhej. Por ishte aq kokëshkretë, sa nuk donte ta besonte se kjo ishte shenjë pleqërie. Në shtëpi nuk shqetëso-heshin për të, sepse ishin mësuar. Dhe atij nuk i vinte keq që, kur hynte në shtëpi, të gjithë flinin; bile shkelte mbi majat e gishtérinje që të mos i zgjonte. Edhe qentë nuk lehnin, kur e shikonin. Ai kalonte pranë tyre dhe, kur i tekej, i përkëdhelte ndonjërit kokën. Qeni tundte bishtin nga kënaqësia.

Roja ndaloi dhe u kthyte nga gazetari. E pa shpejt e shpejt dhe i largoi sytë, sa po ndeshi vështrimin pyetës të tjetrit.

- Kur të lodhesh, më thuaj.
- Dhe sa orë mban rruga?
- Dhe tre.
- Ou! Paska qenë larg! Unë mendova se e shumta do të ishte nja dy orë.
- Jo, jo, do edhe tri orë të mira.

Roja fliste i qetë dhe nuk mendonte se ç'përshtypje i linin fjalët e tij gazetarit, i cili sikur po e provonte që tani rrugën që kishte mbetur. As vetë nuk e kuptoi pse e kapi një ndjenjë plogështie, kur të pëlqen të shtrihesh përtokë, të vësh duart nën kokë e të shikosh kurorët

e pemëve dhe retë e bardha sipër tyre. Në një pozicion të tillë çdo send zmadhohet dhe merr përmasa shumë të çuditshme.

— Kjo rrugë të çon në lokalitetin L? — tha gazetari.

— Po, — u përgjigj prerë roja.

— Nuk ka ndonjë më të shkurtër?

— Po të kishte, unë do ta dija me siguri. Por kjo është më e shkurtra.

Gazetari mendoi se ishte rasti t'i thoshte të kthehej në shtëpi.

— Kur qenka kështu, po e bëj vetë, ti kthehu, — dhe u bë gati t'i zgjaste dorën.

— Mos e thuaj atë fjalë, or burrë, — tha roja. Toni me të cilin foli ia preu gazetarit çdo dëshirë për ta kundërshtuar. Ai qeshi dhe i hodhi krahun në sup.

— Ti mos u prek, or burrë, — tha.

Dhe vazhduan rrugën. Gazetari ishte lehtësuar nga një brengë e papritur dhe tanë e ndiqte rrugën me qejf. Bile prania e atij burri të heshtur ia bënte më interesant udhëtimin. Po të ishte pa njeri, shtegu që gjarpëronte duke u përdredhur nën hijen e degëve, do t'i dukej monoton, pa fund dhe do ta humbiste shumë shpejt kureshtjen.

Dolën në një lirishte që e rrihte dielli. U ulën në rrëzë të saj që të pushonin. Nja dy flutura të kaltra, të vogla, vërtiteshin mbi ca lule të vogla, me petale delikate. Nga një pemë u lëshua një zog i verdhë me bisht të gjatë. Ai i vështroi si i habitur dy njerëzit që po pushonin dhe cicëriu e u ngrit i trembur. Ai u zhduk përsëri papritur, ashtu siç ishte shfaqur. Gazetari nxori bllokun dhe shënoi diçka. Roja po hante bukë. Pastaj nuk pëtiu gjë prej gjëje. Kur gazetari mbylli bllokun, roja e ftoi të hanin bashkë.

— Nuk më ka marrë akoma uria, — tha gazetari.

— Çudi, — tha roja. — Kjo rrugë ha shumë bukë.

— E bën shpesh?

— Dy herë në javë. Po edhe ditë për ditë, kur e do puna.

— Vetëm?

— Më të shumtata e rasteve vetëm e bëj. Kjo rrugë s'para rrihet.

— Të ka takuar të kthehesht natën?

Roja ngriti kokën dhe e pa me habi gazetarin. Atij nuk ia kishte bërë kush deri tani këtë pyetje. Dukej që gazetari nuk i njihet mirë këto vende dhe nuk e dinte se qendrat e lokaliteteve ishin larg njëra - tjetrës. Roja i tha:

— Në çdo kohë. Edhe kur kjo rrugë mbulohet nga dëbora. Ja, si thua ti, ta lëmë punën përgjysmë sepse bie nata apo shiu, sepse bën furtunë dhe ka ngricë?

— Nuk doja të thosha këtë, por ky pyll është kaq i madh dhe...

Roja e nuhati ku donte të dilte gazetari.

— Po të kisha frikë, nuk do të kisha lindur. Do të më kishin mbytur, dhe askush nuk do të kujtohej përmua. — Dhe si u mendua pak shtoi: — Me siguri, do të më kishin mbytur dhe s'do të më linin të merrja frymë. Dhe askush nuk do të kujtohej përmua.

Gazetari vinte re që rojes nuk i ndryshonte asnjë tipar i fytyrës. Ai sikur kishte hedhur mbi sytë një perde që ishte zor ta çaje. Fliste thjeshtë dhe krejt natyrshëm edhe kur përmendte lindjen, edhe kur zinte në gojë vdekjen. Kjo gjakftohtësi ishte e ngjashme me një majë të lartë mali, që kur çohen retë dhe e zbulojnë, ajo është po aq e patundur, po aq e rreptë, po aq e heshtur, sa edhe para se të futej nën to. Edhe roja kishte diçka të rendë në tërë qënien e vet, diçka që të shtypte dhe të shtinte një siguri të habitshme për atë që kishe përparrë.

Gazetari tha se me atë njeri ai mund të ekte vazhdimisht. Mbi lirishte u shuan rrezet e diellit. E kishte zënë një ré. Roja ia mbërtheu sytë resë dhe tha ngadalë, pa e parë gazetarin.

— Nuk më pëlqen kjo erë.

Tjetri nuk ndiente të frynte ndonjë erë. Ishte aq qetë, sa të dukej sikur në atë vend kështu kishte qenë përherë. Ai ktheu kokën nga të katër anët, por gjethet ishin të palëvizura, të ngrira. Dhe mbeti enigmë shprehja e rojes.

Ata u ngritën dhe gazetari vuri re se roja po i nxitonte më shumë se zakonisht hapat. Shtegu u zhduk fare. Ata filluan të zbrisnin nëpër një të tatëpjetë të theksuar, tërë gjethë të rrëzuara. Poshtë këmbëve të tyre rridhente i përgjumur një përrua. Uji dukej vende - vende, sepse anëve rriteshin disa bimë fletëgjera, si ato të kungullit. Gazetari mendoi se, nga shiu që kishte rënë natën, uji duhej të ishte turbulluar dhe u çudit kur e pa aq të kthjetëllët. Roja u hodh me shkathtësi dhe as që e ktheu kokën prapa. Filluan t'i ngjiteshin një të përpjete, ku drurët ishin të dendur dhe barishtet e disa bimëve zvaritëse të arrinin deri në gjunjë. Ishte lagështirë dhe mbante erë myk, se vendin nuk e zinte kurrrë dielli. Shtegu nuk dukej gjökundi. Roja çonte herë pas here kokën dhe orientohej. Gazetari nuk shikonte ndonjë gjë që të dallohej prej të tjave dhe mund të shërbente si objekt orientimi. Ndofta roja ekte pas asaj erës që kishte zënë ngoje pak më parë. Gazetarit i dolën djersë, por nuk donte të mbe-tej pas. Ata vetëm ngjiteshin. Mungesa e një shtegu të rrrahur nga njerëzit po i lodhte. Ishte errët, sikur të kishte rënë muzgu. Gazetari po habitej që nuk po hasnin ndonjë gjë të gjallë. Edhe kur ndoqën brinjën e një shpati, ishte po aq qetësi, sa edhe kur po ngjisin një përpje-

tën. Gazetari u pengua pas një druri gjysëm të kalbur dhe u rrëzua. Roja ktheu kokën dhe u afrua duke kërcyer.

— U vrave shumë? — tha.

Gazetari përveshi këmbën e pantallonave dhe pa se i ishte zhvoshkur lëkura. Mishi i digjte.

— Pak, — tha ai. Mos u bëj merak.

— Ja, atje tej, ku është ai ahu i madh, shkon rruga. Çlodhemi aty, se është edhe një burim i ftohtë. Apo do të pushojmë këtu?

— Më mirë mbarojmë këtë copë rrugë që na ka mbetur.

Roja u nis dhe gazetarit iu duk sikur ai foli diçka me vete, diçka që ishte si ajo shprehja enigmatike për erën që nuk frynte gjékundi, por që ai e nuhaste. Nga ahu i madh shihej një pjesë e pyllit. Rrezet e diellit, që depërttonin nga retë e hirta, binin në mesin e pyllit, duke formuar një ligen të gjelbër, të palëvizshëm. Gazetarit iu kujtua lijeni i Pogradecit në një natë me hënë. Veçse pellgu i pyllit sepse ishte më i thellë dhe të linte një mbresë jo aq delikate. Ndofta ngaqë drurët janë më ngacmues dhe fshehin më tepër ndodhira. Ai pyll ishte shekullor.

— S'kemi dhe shumë tani, — tha roja.

— U lodhe? — i tha gazetari.

— Jo, pylli nuk më ka lodhur asnjëherë.

— Ti je njeri i mirë, Ndoc, — tha gazetari pa e kuptuar as vetë si i dolën ashtu ato fjalë.

Roja qeshi lehtë dhe vështroi tej, ku bënte ballë një majë mali. Gazetari donte t'i thoshte dhe fjalë të tjera, po prapë tha vetëm kaq:

— Ti je njeri i mirë, Ndoc, dhe...

— Ti je i ri dhe rrugës do të takosh mjaft njerëz të mirë, — e ndërpren roja.

— Unë do të vij përsëri nga këto anë, — tha gazetari.

— Mirë se të na vish! Atëherë do të kthehet edhe nga shtëpia ime.

— Mua më vjen keq që nuk erdha që sot.

— S'ka gjë. Unë u mata të të thosha, por e pashë që nxitoheshet.

Ata po bisedonin sikur kishin arritur aty për ku ishin nisur dhe tanë duhej të ndaheshin. Dielli po perëndonte. Të dy e ndienin veten të çlodhur. Ishte aq qetë, sa dëgjohej rrahja e zemrës.

— Ti ke tërë atë rrugë për të bërë, Ndoc, — tha gazetari.

— S'ka gjë.

— Ndofta në shtëpi merakosen.

— Janë mësuar dhe e dinë që mua nuk më gjen gjë.

Gazetari nuk e mbajti dot veten dhe i hodhi dorën në qafë. Nuk mund të fliste dot. Edhe roja.

— Më vjen keq që do të ndahemi, — tha pas pak gazetari.

Dhe përsëri nuk dinin ç'të flisnin. Gazetari ishte djali i drojtur.

— Rri me shëndet, Ndoc, dhe mirë të gjetsha!

— Dale, or burrë, s'kemi arritur akoma në lokalitet!

— S'ka gjë, ti ke tërë atë rrugë dhe tanë po bie nata.

Rri me shëndet.

Gazetari përqafroi rojen dhe u nis. Mbasë bëri disa hapa qëndroi. Roja nuk lëvizte dhe dukej si i shtangur.

— Qëndro në shtëpinë e pyjores, — i thirri ai.

Kur u gjend i vetëm në pyll, gazetarin e kapi një dëshirë e madhe të kthehej e ta takonte përsëri rojen. Por që ndarë tashmë me të. Gjethet u tundën. Ishte një erë e lehtë, si frymëmarrja e zemrës së pyllit. «Është freskia e mbrëmjes», tha gazetari me vete. Rruga ishte e ngushtë, e drejtë dhe tretej si në mjegull. Gazetari nuk po e shikonte se retë kishin myllur qiellin dhe era, që ishte

forcuar, i shtynte drejt lindjes. Shtëpia e pyjores ishte e qetë dhe pa njeri. Ai nuk ndaloi, megjithëse i pëlqenin shtëpitë e rojtarëve të pyllit. Kjo ndjenjë i kishte lindur nga librat me përralla që kishte lexuar, kur kishte qenë i vogël. Kur la pas një bërryl rruge, dëgjoi një lëvizje degësh. U kthyte menjëherë, por ishte aq qetësi, sa ai tha se i bënë veshët. Rruga zbriste, dhe ai nuk e kuptonte se po vravonte. Degët i fërshëllenin. Kjo zhurmë e dehu. Nga diku u ngritën ca zogj të trembur. Gazetari u ndal dhe pa që zogjtë fluturonin të shqetësuar, duke u ngritur mbi majat e pemëve. Ata ishin shumë. Gjoksin e kishin të kuq në kafe, kurse kokën dhe krahët të verdha dhe të kuqe. Gazetari mbajti frymën. Po, zogjtë nuk ishin shqetësuar nga prania e tij. Zogjtë i shqetësonë diçka tjetër, që ai nuk e merrte dot me mend. Mbi fytyrë i ra pika e parë e shiut. Retë ishin ulur, dhe ai e kuptoi se tani ato do të derdhnin tërë shiun. Filloi të kërkonte ndonjë vend, që ta mbronte nga shiu. U fut nën një gur tërë myshk.

— Ku do ta zërë shiu rojen? — tha gazetari dhe përsëri dëgjoi lëvizjen e shqetësuar të zogjve nëpër pemë dhe lëkundjen e një ahu të ri. Atij iu duk sikur pylli po shkundej dhe po pregeteje ta priste shiun po aq hijerëndë, siç priste edhe çdo ndërrim tjetër kohe. Pikat e para ishin të mëdha, pastaj shiu u dëndësua, sa dukej si një perde e gjelbër, por e zbardhur nga dielli. Një shi i tillë e kishte zënë djalin para ca vjetësh edhe në Malësi të Madhe. Shiu binte, dhe gjethet nuk e mbanin më ujin. Ai filloi të kullonte çurkë dhe dëgjohej zhurma e tij mbi gjethet e thata. Ishte një nanurisje e këndshme, që vazhdoi gati gjysmë ore. Retë u çanë po aq madhërisht, sa edhe u shfaqën. Përtëj një maje mali ato ishin aq shumë të bardha dhe aq shumë të dendura, sa dukeshin si dëborë. Dielli kishte perënduar, dhe rrezet e tij ngrihe-

shin që poshtë malit. Dhe përsëri pikat e shiut, që kullo-nin nga gjethet, dukeshin si llambushka me tërë ngjy-rat e ylberit, që ndizeshin dhe shuheshin pa ndërprerje.

Gazetari doli nga shkëmbi. Ajri ishte aq i freskët, sa ai nuk e ndiente rrugën fare. Era tani frynte e lehtë, dhe pylli po fillonte të bëhej gati pér gjumë. Muzgu ishte i shkurtër. Errësira e natës ndihej, dhe lokaliteti nuk po dukej akoma. «Ndofta është në ndonjë luginë dhe më del papritur», tha djali dhe në çdo kthesë priste të shikonte vezullimin e dritave. Rruga s'dallohej më tej se dhjetë metra. Gazetari doli në një shesh dhe kur ktheu kokën, drurët nxinin si një mur i lartë. Ai eci edhe pak, deri ku pylli fillonte përsëri dhe ngriu në vend. Rruga ndahej më dysh. Ai po mendohej se nga duhej të merrte dhe nuk po vendoste dot. U tremb se mos atë natë e kallonte duke u endur kot nëpër pyll dhe nuk e gjente dot lokalitetin L. Ishte errur dhe po ndriçonin yjet e para. Ajo natë do të ishte me hënë, por, ndofta, ajo nuk do të binte mbi sheshin e vogël. Gazetari qëndronte në më-dyshje. Më në fund vendosi të merrte rrugën në të dja-tthë. Sapo hodhi hapat e para, dëgjoi zhurmë degësh të thata, që kërciten nën peshën e diçkaje të rëndë. Gazetari mendoi se me siguri duhej të ishte ndonjë njeri ose kafshë e butë, ndonjë kalë apo mushkë. Ai u gjëzua, kur mendoi se do të takonte ndonjë fshatar, që kishte ardhur deri aty pér dru. «Edhe lokaliteti duhet të jetë këtu afër», mendoi dhe mbajti vesh që zhurma të përsëritez. «Edhe kjo pritje bën pjesë në të fshehtat e natës në pyll», tha prapë gazetari. Errësira sikur po shtrëngohet dhe qielli sikur po bëhej më i madh. Nga lindja u praruan majat. Po dilte hëna. Zhurma sikur ishte fundosur diku, mes asaj errësire. Gazetari dyshoi përsëri, por këmbët nuk donin t'i bindeshin. Atë çast ndjeu tërë lodhjen e udhës.

Piu ujë në një burim që rridhte mes ahishteve të reja. Befas shkarpat kërcitën përsëri nën peshën e dikujt.

— A ka njeri aty? — thirri. Askush nuk u përgjigj. Dhe përsëri gazetari mendoi se, ndofta, këtë pyetje e kishin bërë edhe shumë vetë para tij.

— A ka njeri aty? — Dhe gazetari u çudit kur thirri pér herën e dytë.

Degët lëvizën dhe prej andej doli një burrë me puskë në krah. Ai po afrohej duke hequr zvarë njëren këmbë. Nuk dallohej se ç'moshë kishte dhe, ajo që kish te rendësi, s'dihej se ç'kërkonte aty aq vonë.

— S'të qenkan tharë akoma rrobat, — tha njeriu, dhe gazetari ngriu, kur pa rojen. Edhe ai ishte lagur.

— Pse nuk qëndrove në shtëpinë e pyjores?

— Po ti pérse u ktheve? — i tha gazetari i habitur.

— S'më linte meraku, — tha roja. — Të zuri shiu në rrugë, dhe s'më linte meraku.

Roja ishte lodhur, dhe këmba i dhembte. Gazetari nuk ngopej së pari shpatullat e dobëta të rojes. Edhe i vinte keq që nuk ishte kthyer, edhe i vinte mirë. Tani nuk donte që lokaliteti të ndodhej përtëj së përpjetës. Donte të udhëtonte së bashku me rojen deri në agim: dhe pastaj të zinin ndonjë hije e t'ia këpusnin gjumit. Roja do të ndizte zjarrin dhe do të thanin rrobat. Por e përpjeta mbaroi shpejt, dhe lokaliteti i vogël, i futur mes pyllit, vezulloi plot ngrohtësi.

— Ja ku janë zyrat, ato të bardhat në mes. Po të çoj te zyra e kryetarit, — tha roja.

— Do të rrish dhe ti sonte, — tha gazetari. — Do të vish edhe ti. Sonte flemë bashkë dhe nesër nisu pa dalë dielli. Je këputur nga udha dhe je i lagur.

— Jo, — tha roja. — Nesër duhet të jem në punë që në mëngjes.

Ia kishte qejfi të flinte me gazetarin dhe të bënin

muhabet, por nuk mundej. Sytë i kishte mbërthyer mbi dritat e lokalitetit. Pylli fëshférinte, dhe hëna ngrivej mbi qiellin e larë.

Si e çoi në shtëpinë e kryetarit e si pinë nga një cigare tek dera, roja i zgjati dorën gazetarit:

— Bëfsh natën e mirë dhe mirë u pjekshim!

— Jo, — kundërshtoi kryetari, — të paktën eja satë thahesh.

— Vonohem. Pastaj, kjo natë nuk të ftoh. Jam mësuar të thahem rrugës. Po pata të ftohtë, ndez zjarr rru-gës.

Roja fliste i qetë dhe gazetari e vështronte me dashuri. U përqafuan. Roja humbi në errësirë, por gazetari e ndiente praninë e tij. Ai s'mund ta harronte kurrë atë njeri.

GABIM BUZË VJESHTË

Në Qafë - Panjë po vinte vjeshta. Mbrëmjet ishin të ftohta, dhe shoferët hidhnin përsipër velenxat e leshta, kur binin të flinin. Shirat nuk kishin filluar akoma, me gjithëse kishte kohë që retë lëviznin mbi grykat e maleve. Druyarët punonin me ngulm deri vonë. Djali dëgjonte zhurmën e sëpatave nëpër natë dhe e zinte gjumi shpejt. Zgjoheshin pa lindur dielli. Ai lante sytë te çezma poshtë sharrës dhe përsëri dëgjonte zhurmën e sëpatave përzier me zhurmat e tjera. Petroja merrej me motorin dhe priste sa të ngarkohej makina. Pastaj niseshin deri në xhadënë kryesore, ku ishte ngritur një pikë shpërndarjeje. Aty ngarkoheshin makina të tjera, që i çonin drutë në qytet. Ata kishin një javë që nuk kishin shkuar në qytet, sepse po të fillonin shirat, rruga bëhej e pakalueshme. Ishte një rrugë e hapur shpejt e shpejt, sa për ta shfrytëzuar në stinët e thata. Bëheshin gjithsej dhjetë shoferë. Zakonisht, kur sharrëxhinjtë linin punën, shoferët mblidheshin pranë zjarrit dhe bisedonin. Atë natë ata po bisedonin për gratë. Ishin pesë. Tre ishin të moshuar, si Petroja, kurse dy më të rinj.

— Kam tridhjetë vjet martuar, — tha Petroja, — dhe më besoni, kur kthehem nga rruga, më pret sikur

të jemi martuar, ja dje. Dhe menjëherë më ikën lodhja, sikur ma heq njeri me dorë,

— Ashtu është, — tundte kokén Ndrekova, një bu rrë i dobët, që rrinte shpesh pa rruar dhe që qimja e mjekrës i nxinte njëqind metra larg. Kur fliste, nuk të shikonte kurrë në sy, por diku, tej pyllit që fëshférinte.

— Ajo imja, kur bënim rrugë të gjata, hyri në kurset kundër analfabetizmit. Dhe e di, më tregonte fletoren ku kishte mësuar të shkruante. Njëherë nuk e gjeta në shtëpi. Kisha uri. Pyes vajzën ku është jot emë. «Në shkollë», më thotë. Edhe shkolla na kishte mbetur man-gun, u nxeva. Kur tëk, ajo hyn me vrap. «U lodhe?» më tha. E di, si më iku inati, sikur s'isha unë! Po ç'u bë-re! I thashë. Ajo m'u afrua dhe më pëshpëriti në vesh, që të mos dëgjonin fëmijët. «Kisha provim. Dola mirë, se fap-fap ma bënte zemra nga frika». Unë qesha.

— Prandaj ia ke frikën, se e ke me shkollë, — tha Petroja me shaka.

— Jo, a derëbardhë, por e kam shok e shkuar shokut!

Mihali, shoferi më i ri midis tyre, dëgjonte me go-jën hapur.

— Usta, kaq shumë e do ti gruan? — tha ai.

— E mo, Stavri, e dëgjon ç'thotë! — ia priti Ndrekova. E do gruan?! Si o nuk e dua! .. E kam shok, or, shok!

— Lëre, o Ndrekova, se ai, kur të martohet, do ta kuptojë vetë këtë, — tha Stavri.

Ai kishte nëntë fëmijë. I donte shumë fëmijët dhe me vete mbante një shportë të madhe që e mbushte me ç'të gjente: me domate, piperka, rrush, qershi. Në çdo orë që të kthehej në shtëpi, shtronte përpara ato që kishte sjellë. Vetë nuk prekte gjë me dorë, por tërhiqejet dhe kë-naqej me lumturinë e fëmijëve. E shoqja, një grua e tra-

shë, me sy të kaltër, e harronte inatin që burri ia kishte zgjuar fëmijët, dhe qeshte. Dhe Stavrin e kapte dëshira të kishte akoma fëmijë. Vajza e vogël nuk i kishte kaluar të dy vjetët.

— Do të bësh akoma? — tha një punëtor i sharrës.

— Jo, — tha Stavri. — E kam vajzën e fundit sa pér njëqind.

Djali i Petros e kishte vënë re se të gjithë shoferët flisnin më me dashuri pér vajzat, sesa pér djemtë. Kur dëgjonte të atin që fliste me mburrje pér motrën, e kapte zilia dhe ngrysej në fytyrë.

— Vajzat, sa janë të vogla, të kënaqin, — tha Petroja, — pa kur rriten, kanë telashe.

— Ku ka si djali! — tha Kasëmi, një sharrëxhi i porsamartuar. — Atë lëre dhe mos çaj kokën.

— Rri, mor, — tha Stavri, — ti akoma je kërthinjak. Kur të lindësh, pastaj flasim.

Sharrëxhiu qeshi me Stavrin dhe foli diçka që nuk e kuptoii asnjeri.

— Ore mistrec, ç'llomotit ashtu, si kukudh?

— M'u kujtua nusja, Stavri.

— Të thashë unë se ti je akoma kërthinjak.

Era i digje shpejt drutë e thata që kërcisin. Mihali ngrihej dhe i hidhte zjarrit bluashka. Stavri i dha paguren, një pagure të vjetër ushtari, të shkonte ta mbushët me ujë. Ai e mori dhe u largua nëpër errësirën e yjëzuar. Nata ishte e freskët dhe mbante erë drurësh. Ata ishin lodhur tërë ditën, por nuk kishin gjumë. Mbretëroi një heshtje e gjatë. Në një rrap të lashtë gjithë fole zogjsh kërcitën degët, por pastaj çdo gjë u qetësua. Djali i Petros ndiente zërat e largët të pyllit dhe i dukej vetja si në ëndërr. U kthye Mihali nga çezma. Ai sikur e kishët humbur gjallërinë e parë dhe sikur e kapi trishtimi. Kushedi se ç'iu kujtua rrugës. Ndryshimin e tij e vuri

re vetëm Stavri. Por edhe ai heshti. Papritur Petroja zuri të këndonte një këngë të vjetër për dashurinë. Të gjithë që rrinin pranë zjarrit, i mbanin iso. Dhe përsëri ajo këngë, u kujtoi gratë. Djalit të Petros i vinin të shkëputura fragmentet e melodisë. Ishte një këngë për dashurinë e parë në një sokak të ngushtë, tërë gurë. Të dy, edhe djali, edhe vajza, e donin njëri - tjetrin, por sepse i druheshin erës së malit. Kur mbaroi kënga, djali ndjeu të krijohej një boshllék në tërë atë hapësirë buzë pyllit dhe sikur gjithçka mbajti frymën. Nga maja e Shkëmbit të Sorkadhes u dukën dritat e një makine, zhurmën e së cilës e solli pranë zjarrit gryka e lumi.

— Po vjen Hilmiu, — tha Mihali, të cilit kënga ia kishte shtuar akoma më tepër trishtimin. Stavri vriste mendjen të gjente shkakun e trishtimit të tij. Ata nuk folën derisa erdhi Hilmiu. Ky përplasi derën dhe u ul pranë Mihalit.

— S'kini gjumë, ë? — tha ai.

— U mplakëm, — tha Stavri.

— Dhe kush thotë, pa! — tha Hilmiu. Dhe si e pa që ata heshtnin, vazhdoi: — Ç'kini kështu? Apo u zuri malli për gratë! .

— E si të mos na zërë, kur ato i zë më shumë se ne! — tha Vasili, një burrë rrëth të dyzetepesave. — Kur e di se do të kthehem, ajo imja nuk vë gjumë në sy, por rri dhe më pret. Unë e shaj, që të mos më presë, se lodhet, por jo. Ja, kam mbi njëzet vjet martuar dhe nuk ka bërë vaki ta kem gjetur në gjumë. Të ishte për ne, mazallah se e bënim atë që bëjnë ato.

— Ashtu është, — tha Petroja. — Në fillim s'doja ta futja në punë. Ç'ke ti, i thosha, të mbaj unë. Por jo. Pastaj thashë se kishte të drejtë. Hyri pak e madhe, por ia mori dorën zanatit. Dhe e di si ndryshoi? Or ndryshoi si nata me ditën!

— Posi, mo, posи, — aprovonte Stavri. — Se nganjëherë ne burrat bëhemи si qëmoti. Kur kthehet ajo imja nga puna dhe ka dalë mirë, zë dhe këndon. Mua sikur më çmpien damarët.

— Hajde, o Stavri, t'u mbylltë e mendjes, hajde! — tha Kasëmi.

— Posi, ore, të këndoje sa të shembet tavani, se e ka hak! — tha Stavri. Të gjithë sa ishin rreth zjarrit qeshën. Vetëm Hilmiu nuk qeshi. Ai trazoi thëngjift me dru, hodhi sytë nga makina dhe tha:

— Deri tani kam punuar me nder dhe nuk e kam ndier veten maskara. Ç'm'i shqyen ashtu sytë? S'të besohet, apo nuk e ke ndier veten ndonjëherë maskara? — iu drejtua si i nxehur Mihalit. Mihali ngriu, por nuk foli. Të gjithë prisnin. Hilmiu ishte rreth të tridhjetepesave. Ishte i fuqishëm dhe vonë e vishte xhaketën. Tërë verës punonte pa kanatiere. Flokët i ishin thinjur. Ishte një burrë i bukur, që pinte shumë cigare dhe lexonte çdo ditë romane. — Atëherë punoja për krom dhe nuk isha martuar. Ja, ishte si tani, po hynte vjeshta. Por bënte vapë, dhe unë punoja më tepër natën. Ngrihesha aty nga ora katër e gjysmë dhe flija nga ora një. Po bëhej muaji i tretë. Nejse, atë ditë e mbaj mend aq mirë, sa asnje ditë tjetër. Gjumi më doli kur ishte akoma errët. U përpoqa të flija, por isha ngopur me tri orë gjumë. Megjithatë ndenza shtrirë në sustë dhe pi ja cigare. Seç më kishin pushtuar nja dy mendime për veten time. Isha vetëm në mes të rrugës dhe më dukej sikur çdo gjë përgjonte lëvizjet e mia.

— Sa bukur që flet, qeni! — tha Petroja.

— Është me shkollë, nuk e ke parë si u futet librave, — tha Mihali.

Hilmiut i pëlqenin shumë librat, sidomos romanet

me dashuri. Ai nuk rrinte kot. Në sirtar mbante nga një libër, që ia blinte i vëllai, student për letërsi.

— Dhe nuk e di në u ka rënë në sy (me siguri që u ka rënë, por s'i keni vënë rëndësi), — vazhdoi ai — në ato çaste më dukej sikur më bënин pyetje dhe unë s'isha i zoti t'u përgjigjesha. Për t'u nisur, s'më bëhej. Hapa radion dhe kapa një stacion që transmetonte muzikë. O, sikur u çlodha dhe aq shumë e kam shijuar muzikën, sa nuk e shikoja se po binte agimi. Muzika vazhdoi gati gjysmë ore, dhe unë nuk isha fare në të. Atëhere thashë se duhej të martohesha dhe të lindja fëmijë, që, kur të kthehesha, të më prisnin dhe të më pyesnin. Atë ditë po gdhijej e diel. Xhadeja ishte e qetë dhe pylli me dushqe të reja s'pipëtinte. Dëgjohej uji që rridhte pak më lart, nga ku kisha ndaluar. Dola të lahem. Ajri ishte i lehtë, dhe dielli akoma s'po dilte, por çdo gjë filloi të dukej qartë nëpër turbullirën e mëngjesit. Edhe një herë thashë se duhej të martohesha. Nisa makinën dhe s'doja të më dilte njeri në rrugë. Por kur po kaloja nëpër Qafën e Buallit, pashë dy njerëz. Ishin një djalë dhe një vajzë. Ata më zgjatën dorën, dhe unë ndalova. Hipën. E dini ku hipën? Është një fshat i çuditshëm në fund të një grope, poshtë Qafë - Buallit. Emrin ia kam harruar. Kish-te diçka të bardhë në fund.

— Mos qe Fushë - Bardha, — tha Petroja.

— Jo, jo.

— Po kush të qe, dreqi!?

— Mbaron me «bardhë». Është një fshat i gjelbër, si oaz. Nga të katër anët ka male në ngjyrë të kuqe, me ndonjë shkurre të vogël. Kurse fshati që është ngritur në rrëzë të tyre, është i gjelbër. Duken fshatarë meraklinj. Aty mund të ketë qenë ndonjë liqen, por është tharë prej shekujsh. Do të ketë qenë ndonjë liqen i bukur, si ata të Lurës, sepse edhe malet s'duken të kenë qenë të zhveshu-

ra. Unë shikoja fshatin dhe diellin që binte nga lindja si prozhektor. Fshati ngushtohej derisa i afrohej lumit të Matit. Aty në dimër duhet të bjerë shumë dëborë dhe dielli si zor se e zë. Ndofta dhe gabohem. Ai fshat më pëlqente ta shikoja kur lindte dielli. Pasagjerët rastisën të urtë dhe nuk flisnin. Si u thashë, edhe unë nuk doja të flisja. Kur u zhduk fshati, ndeza radion. Kur dëgjoj se dikush po këndonte mbas meje. Kthej kokën. Ishte vajza. Atëherë e pashë mirë. Kishte një fytyrë të bukur dhe të qeshur. Të dukej sikur deri atë ditë ajo vetëm kishte qeshur. Djali rrinte hijerëndë dhe i zymtë. Por vajza as që donte t'ia dinte. Sa mbaronte një këngë dhe fillonte një tjetër, ajo e shoqëronte me zë të ulët. Unë nuk kam hasur ndonjë njeri të dijë aq shumë këngë, sa ajo vajzë. Këndonte pa e prishur gjakun. Djali u koll nja dy herë, por bosh. Dhe ajo vajzë, m'u mbush mendja, e kish kaluar jetën vetëm duke qeshur e duke kënduar. Andaj dhe ishte aq e bukur. Kurse djali mund të ishte më i vogël, po dukej si një burrë i plakur para kohe.

— Ç'e ke, — i thashë vajzës, — burrë?

— Jo, kushëri.

— Ku po shkoni?

— Në Burrel. Kemi një punë aty, pastaj do të kthehem.

— Kush ka punë, ti apo ky?

— Unë, — tha vajza dhe vazhdoi këngën.

Atëherë e pata më tepër inat djalin. Atë e kishin vënnë si roje të vajzës. Dhe m'u duk edhe më plak. Ai rrinte i ngrehur kur unë flisja me vajzën dhe filloj të dridhëtë një cigare. Unë i zgjata paketën.

— Janë të buta, — më tha.

— Merre! — i thashë me inat. — Ti i ke buzët akoma me qumësht për të njohur duhanin. — Ai sikur u pre dhe e ndezi nga paketa ime. Aty e kuptova se ai nuk

e pinte fare duhanin dhe se qeskën duhet t'ia kishte marrë të atit, për t'u dukur ca më i madh. Të çuditshëm janë malësorët.

Ia ula zërin radios që ta dëgjoja më mirë vajzën. Por ajo ishte e zgjuar dhe nuk e ngrinte zërin. Po e ndieja veten ngushtë. S'po hapja dot bisedë. Vajza po më pëlqente. Dhe thashë me vete se në mëngjes prandaj isha i shqetësuar, sepse do të takoja rrugës një vajzë që vetëm kishte qeshur dhe kishte kënduar. Dhe tek mendoja, se kjo kokë do shtypur, vajti për ters

— Ç'punon? — i thashë.

— Agronom e mesme. Sivjet mbarova dhe s'kam filluar akoma punën.

— Në konvikt ke fjetur?

— Në konvikt.

— Ke bërë dashuri? — e pyeta copë.

Ajo vetëm qeshi dhe e mori për shaka pyetjen time. Këtë e kuptova më vonë, po në atë çast e kuptova ndryshe. Dhe filloj maskarallëku im. Ndoshta, ajo edhe mund të mos e ketë dëgjuar atë që fola. Rrugë është, dhe zhurma e motorit s'të lë të dëgjosh mirë.

— Do ta dredhësh? — më tha djali.

— Jo.

Ai foli për të treguar se ishte aty dhe nuk lejonte teprime. Mua më dukej sikur e mbaja mbi kurriz. Ai kishte marrë tiparet e një burri të rëndë. E di si më vinte... ta nxirrja fishek jashtë! Po nuk kishte faj ai. Po bëhesha unë nervoz. Dita qëlloi e bukur. Janë nga ato ditët e rralla, para se të nisin shirat, kur mbi xhade rrokullisen nga era e lehtë gjethet e para të vjeshtës. Ato sikur të ngjallin trishtim, hë? Sepse kujton dimrin, kur pemët janë të zhveshura dhe të ngrira. Do thoni se edhe dimri ka lezitin e tij. E ka, si s'e ka! Por ajo ditë ishte shumë e bukur, se pastaj do të fillonin shirat, që s'kanë

të mbaruar. Nisa t'i shes mend vajzës me librat që kisha lexuar. Ajo më dëgjonte dhe sytë i ndrinin. Sepse njerëzit çuditen kur flasin shoferët për librat. Asaj s'para i pëlqenin librat, donte këngët dhe i dinte përmendësh. Unë andej jam pykë. Mbaroi muzika e kërkuar dhe filloj një emision tjetër me të folura, mbi kafshët që jetojnë më shumë dhe njerëzit më të gjatë dhe më të shkurtër në botë.

— Si i mban mend të gjitha, bre! — e ndërpren Stavri.

— Atë ditë s'e harroj, se edhe herë të tjera kam dëgjuar radion, por tani s'i sjell dot në mendje se ç'kanë folur. «Të pëlqen që u bëre agronomë?» e pyeta vajzën.

— Po të mos më pëlqente, s'kisha vazhduar shkollën, — më thotë.

— Po prindërit duan?

— Kësaj po i shkrepi në kokë, është njëlloj si dhia e egër, — tha djali.

— Të vjen keq që e mbarove shkollën?

— Edhe më vjen. Ishim tërë ata shokë, — tha vjaza. Dhe, me siguri, iu kujtuan vitet e shkollës dhe shokët e saj. Megjithëse, isha i sigurtë që nuk i besohej se kur të hynte shtatori nuk do të merrte rrugën nga fshati për në qytet.

— Tani ta shikojë, — tha djali dhe buzëqeshi, duke nxjerrë dhëmbët e zverdhur e të palarë.

— Çfarë të shikojë, more? — i thashë.

— Punën, — vazhdoi djali me një kënaqësi të ashpër.

— Mos ia qaj hallin kësaj, — i thashë.

— Ky ka inat që mbarova shkollën, — tha vajza pa djallëzi.

— Mirë, mirë, — tha djali, — pas një muaji llafose mi bashkë. — Ai nxori përsëri qesen e duhanit.

— Merr këtu, — i thashë.

Ai më bindej si qengj. Kjo më nxehete, se donte ta mbante veten burrë me zor. Po i afroheshim Burrelit. Mendimi për vajzën më godiste pa ndërprerje në kokë me forcë. Më dukej sikur do të më çuhej kafka, kaq fort më binte në tru. Vajza shikonte rrrotull, dhe djali sa s'kércente nga sedilja. Kushedi ç'mendonte ajo në ato çaste. Ndofta ditën e parë kur u nis për në shkollë nga fshati. E, sa mendime të lindin rrugës! Mua më kishte mbërthyer një mendim i keq dhe s'guxoja të hapja gojën, se do ta nxirrja jashtë. Prandaj haja veten me dhëmbë dhe ngadalësova shpejtësinë. Djalin sikur e zuri gjumi. Ai u mbështet mbi motor, dhe nga lëvizja e shpatullave e kup-tova se po flinte. Po sikur e bëri kastile, shejtani. Vajza queshte dhe këndonte. Të dukej sikur ajo, që kur kishte lindur, vetëm kishte qeshur dhe kënduar.

— Na e the një herë, — e ndërpree Petroja.

— Çfarë?

— Ja, që ajo kishte lindur e qeshur vetëm me këngë.

— Me tërë mend që ashtu ishte. Pastaj, unë s'po u tre-goj përralla. Po u tregoj kur e ndjeva veten maskara. Në një dishezë e lashë motorin në minimo dhe i thashë ngadalë të më priste vetëm kur të kthehesha. Ajo i hapi sytë na! — dhe ndryshoi menjëherë në fytyrë. S'kam parë njeri të ndryshojë aq shpejt. Posi, bre!.. Sikur nuk ishte ajo që queshte dhe këndonte, por një njeri që e kishin poshtëuar dhe asaj nuk i besohej që e kishin poshtëuar. Një njeri që deri atëherë u besonte të gjithëve dhe të gjithë i dukeshin të mirë. Nuk doja ta shihja më, por sepse nuk më linte diçka, këtu përbrenda, rehat. Ajo më gërryente dhe unë ktheva kokën përsëri. Ajo shikonte jashtë, dhe era ia shpërndante flokët. Në fytyrë kishte dhimbje. Sytë i qenë përlotur, dhe në ta pasqyro-heshin gjelbërimet e fundit të drurëve. Atëherë, ishte si

tani, buzë vjeshte, por mua më dukej sikur udhëtoja në-për një kohë të turbullt për t'i shpëtuar stuhisë që do të shpërthente nga çasti në çast. Djali as që po zjohej. Kur na u takuan sytë, ajo u mundua të buzëqeshte, por kjo gjë e theksoi akoma më shumë dhimbjen e saj. Megjithatë, isha i sigurtë se ajo përpiquej t'i mohonte vetes diçka. Kjo më vriste më tepër. Ajo përsëri luftonte dhe kërkonte të gjente mohimin e asaj që kishte dëgjuar. Por nuk po e merrte dot. Edhe unë ndodhesha keq. Doja të arrija sa më parë në Burrel dhe që ajo, sapo të zbriste, të më pështynte. Ngaqë kjo s'kishte për të ndodhur, doja t'i bija kokës me grushte. Ajo vajzë e urtë, nga një fshat i thellë midis maleve po hynte në jetë dhe që në fillim haste në një njeri si unë. Mendoni tani se sa e rëndë do të ishte ajo e diel. Kur ndalova, nuk doja ta shihja. Por ajo m'i nguli sytë e saj të trishtuar, sikur më pyeste vërtet kisha folur unë apo i kishin bërë asaj veshët. Dhe e di se mbas pak, kur të isha larguar, do t'i mbushte vetes mendjen se i kishin bërë veshët, se s'kishte mundësi që të thosha unë një gjë të tillë. Se si e shtyva atë ditë, s'mbaj mend. Të nesërmen u nisa për këtej dhe, sado që kanë kaluar tre vjet, s'kam harruar se andej thellë kam bërë një maskarallëk.

Hilmiu heshti dhe asnë shofer nuk e prishi heshtjen. Të gjithë ranë në mendime. Ishin shoferë që punonin për dru në Qafë-Panjë. Do të nisnin shirat, dhe rruga do të keqësohej, prandaj ata flinin shumë pak. Edhe atë natë s'kishin gjumë. Kishin folur për gratë, dhe Hilmiu u tregoi diçka që i zhyti në mendime. Pylli tani zhurmonte, i shqetësuar. Kaloi mesnata. Punëtori i sharrës u ngrit. Ai u tha natën e mirë dhe humbi menjëherë në errësirë. U dëgjua si i thërriste shokut të hapte derën e barakës ku flinin.

— Çohemi dhe ne, — tha Petroja.

Ata u ngritën me zor. Vetëm Hilmiu nuk lëvizi.

— Hajde dhe ti, — i tha Stavri.

— Do të rri edhe pak, — tha ai. — Sonte s'paskam gjumë fare.

Petroja e rregulloi djalin në sedile dhe e mbuloi me velenxë. Petron e zuri gjumi menjëherë. Djali zgjati koken dhe pa se Hilmiu po rrinte akoma tek zjarri dhe pinte cigare. Pastaj mbajti vesh mos dëgjonte zhurmën e natës së pyllit, por asgjë nuk pipëtinte. Po hynte vjeshta. Hëna e ngrënë nga perëndimi rrëshqiste mbi kurorat e drurëve, duke shqetësuar zogjtë. Ishte aq bukur, sa nuk mund të të zinte gjumi.

ERA E PISHAVE

Pa hyrë në Voskopojë, në të majtë të xhadesë, mes livadhesh dhe burimesh me ujë të ftohtë, është një rrugë. Ajo të çon thellë malevë, deri rrëzë dëborës së përjetshme të Tomorrit. Aty zbrisnin përherë ata të dy. Kërcenin nga makina, çmpinin për një çast këmbët, shkundnin pluhurin dhe, si i buzëqeshnin shoferit, niseshin. Ata ecnin katër orë deri në fshatin ku jepnin mësim. Ka-përcenin një mal dhe një lumë, futeshin mes një pylli të dendur, që s'mbaronte kurrkund. Dhe të dy e donin shumë pyllin. Mes drurëve gjëllonte një jetë e çuditshme dhe tërë të fshehta. Ata shkelnin mbi gjethet e rrëzuara të vjeshtës dhe prisnin pranverën; çanin shtigjet e gjelbra dhe mendonin dimrin; shikonin gjurmët e kafshëve të egra të pyllit, dëgjonin llokçitjen e ujrave nën dëborë, nën akull dhe kujtonin shkrirjen e tyre. Ata jetonin intensivisht me të katër stinët, edhe kur vera i vinte në gjumë kataraktet. Zakonisht për ato vise vera është stina më e shkurtër. Dhe në verë ata ishin me pushime. Largoreshin nga fshati kur fillonte vera dhe ktheheshin kur mbaronte. Vajza ishte e hequr, me një fytyrë të vogël, me një lëkurë të pastër, pak si të zbetë. Në sy gjithmonë i endej një dashuri e thellë dhe të dukej sikur ajo mendonte pa ndërprerje për djalin. Sytë i kishte si të lëngë-

zuar, si ato burimet, që fshihen nga njerëzit mes bari dëshirat dhe rrjedhin nën lajthi apo fier, nën ah apo lule-shtrydhe dhe dridhen kur dikush u afrohet, kur bie pikë e parë e shiut apo vesa e mëngjesit, kur ketrat lajnë ftyrën e tyre të zgjuar apo kur zogjtë futin sqepin e vogël. Në sytë e saj kishte gjithmonë lëvizje dhe drojtje. Djali ishte i shkathët dhe i fuqishëm. Zakonisht ecnin papushim. Ajo e donte djalin dhe s'mërzitej nga asgjë.

— Kur të largohemi prej këtej në ndonjë fshat tjetër, do të na zërë malli për këto vise! — thoshte.

Djali, sado që përpiquej të sillej serioz dhe t'i shikon-te gjërat që thoshte ajo me mospërfillje, nuk mundej. Edhe ai futej pa e kuptuar në natyrën e vajzës. Dhe harronin se muzgu binte e u duhej të ecnin natën nëpër pyll, derisa përtej bërryilit të fundit dukeшин dritat e fshatit. Fshatrat ishin të shpérndara faqeve të kodrave, rrëzë përrrenjve, përballë njëri - tjetrit. Kur fikeshin dritat, dukej sikur njëra shtëpi ia bënte me sy shtëpisë së fshatit fqinj. Ishte një lojë që ata e shikonin shpesh dhe qeshnin. Makinat fillonin ta rrihnin atë rrugë zakonisht në pranverë dhe vazhdonin derisa niste dëbora. Dhe dëbora niste të binte në tetor. Prandaj ata vinin me makinë deri në hyrje të Voskopojës dhe merrnin rrugën majtas. Petroja i merrte shpesh në makinë. Ata hipnin pa folur dhe, kur zbrisnin, i buzëqeshnin e i tundnin dorën.

Petroja nuk i kishte parë ndonjëherë vetëm. Kudo të dy. Ndofta prandaj i pëlqente t'i merrte në makinë, kur ata ktheheshin në qytet në fund të javës. Njëherë, kur vajza ishte ftohur dhe djali e kishte lënë në një fshat përtej kodrës, Petroja shkoi dhe e mori, megjithëse rruga ishte e prishur nga vijat e ujit dhe balta vinte deri në mesin e rrotave. Por ai e shpuri makinën deri në fshat.

Dhe përsëri erdhi vjeshta. Pishat fërshëllenin, dhe

dielli humbiste pértej maleve më shpejt. Por shirat nuk kishin filluar, dhe ditën nuk bënte ftohtë. Gorricat po piqeshin, kurse kumbullat zverdhnin akoma. Atë muaj Petroja do të transportonte dru. Ngrihej herët dhe kthehej ndaj të ngrysur. Ai punonte me qejf në Voskopojë. Atë vend dhe sidomos erën e pishës e pëlqente shumë. Ai thoshte se kur të dilte në pension, do të shkonte të jetonte në Voskopojë. Edhe të birin e merrete shpesh me vete. Sa ngarkonte makinën i ati, djali bridhte nëpër luanë, apo rrinte tek pérroi, nën shelgjishte dhe shikonte peshqit e vegjël. Pastaj, zbriste gjatë rrjedhjes së pérroit dhe kërkonte foletë e faqekuqve, çallmurëve, bishttundësve, verdhashëve. Ai i njinte mirë zogjtë dhe harrohej pas tyre. Petroja e ndalonte makinën tek ura dhe i binte fort borisë. Djali e dëgjonte kudo që të ndodhej dhe vravonte mes barit. Dielli perëndonte mes pishave dhe cicërimës së zogjve që mblidheshin në folë.

Dhe Petroja u çudit kur pa që një ditë vajza kishte dalë vetëm tek rruga që të çon në Voskopojë. Ai në fillim nuk besoi se ishte vetëm dhe nuk e nisi makinën kur hipi ajo. Priti. Dhe vajza nuk fliste. Në gjunjë kishte vënë çantën e zezë me ushqime dhe libra. Sytë i mbante ulur. Në rrugë nuk dukej njeri. Mëngjesi ishte, si zakonisht, plot drithë dhe i qetë. Ndofta të qetë atë e bënte edhe rruga pa lëvizje apo fëshfëritja e gjetheve të plepave që kishin filluar të zverdheshin. Ndofta të qetë e bënte ai peizazh buzë vjeshte.

— Përse nuk vjen dhe Zeneli? — tha Petroja.

Vajza mendoi se iu drejtua djalit të vogël, prandaj nuk foli.

— Çfarë? — i tha vajza, sikur u zgjua nga një kujtim, që duhej ta kishte përpirë.

— Përse nuk po vjen edhe ai, pra, Zeneli? — përsëriti Petroja.

— Nuk vjen më, — tha vajza dhe heshti.

— Përse, mos e transferuan?

— Jo, jo, shkoi student, në Tiranë.

— Aa! — ia bëri Petroja dhe nisi makinën. Ata udhëtuan pa folur deri sa lanë Voskopojën dhe hynë në pishat e rralla të Gjonomadhit. Fshatarët po kositnin jonxhën e fundit të atij viti. Dikush priste pishë thellë në pyll.

— Tani do ta bësh vetëm tërë atë rrugë, — tha Petroja.

— S'ka gjë, rrugës takoj gjithmonë fshatarë, — tha vajza.

— E di, — tha Petroja, — por kur ishit të dy, ish ndryshe.

Vajza qeshi. Fytyra sikur iu tulat, dhe ajo solli ndër mënd rrugën. Edhe ajo e ndjeu ndryshimin: tani do të ndalonte me ata që do të takonte rrugës pranë çezmave. Ajo u drodh dhe tha me vete se nuk do të kishte aq forcë, sa të ulej në atë vend ku ulej me atë. Dhe në fshatin ku jepte mësim nuk do të kthehej asnjëherë natën. Dhe nuk do të kërkonte në seksionin e arsimit ta lëviznin që andej, pa mbaruar ai. Ajo tha se ato që jetonte nuk ishin kujtime. Ajo donte të fliste, të fliste vazhdimisht, por ishte vajzë e drojtur dhe nuk dilte nga natyra e saj.

— Kur u nis? — tha Petroja.

— Sot në mëngjes.

— E përcolle?

Vajza s'u përgjigj në çast. Dhe Petroja e mori me mend se ajo duhej të kishte qëndruar diku mes pasagjerëve, larg tij. Ajo ka shoqëruar çdo lëvizje të tij, ka përpire çdo mbresë... Dhe kur është nisur autobusi, është bërë e guximshme dhe i është afruar më pranë. Djali ia ka bërë me dorë, kurse ajo i ka buzëqeshur lehtë, shumë lehtë, mos e shikonin prindërit e djalit. Ata, me siguri, ja-

në bërë kureshtarë se kë ka përshëndetur djali ashtu, aq sa edhe i harroi, dhe kanë ngritur kokën mbi rrëmujën e përcjelljes, por nuk kanë dalluar gjë. Zakonisht përcje-llja ka një fytyrë.

— Je mërzitur pak? — tha Petroja.

— Jo.

Rrugën ua preu një tufë delesh. Ai i ra borisë.

— Koha po mban mirë këtë vit, — tha.

— Po, — tha vajza.

Djali i vogël nuk i dëgjonte më. Ai mendonte përruin dhe foletë e zogjve në shelgjet e dendur. Edhe pak, dhe zogjtë do të nisin shtegtimin e largët. Djali u përpoq të përfytyronte udhën e tyre. Ajo ishte e gjatë dhe plot mundime. Kështu kishte lexuar në një libër.

— Nuk ke frikë ta bësh vetëm tërë atë rrugë?

— Jo, — tha vajza.

— Po më gënjen, — qeshi Petroja.

— Përse? — qeshi edhe vajza.

— Kështu s'ta mbush syrin.

Nga një kthesë u duk Voskopoja. Shtëpitë lëshonin tym. Ata ranë në një vend si gropë. Kaluan urën e bardhë. Përtej urës, rruga dredhonte midis ca gurëve të bardhë dhe të mëdhenj. Aty bënin fole pëllumbat e egër. Ajo hapi derën e i dha dorën Petros dhe djalit të vogël, që mendonte vetëm për zogjtë shtegtarë.

Priti sa të nisej Petroja, që të merrte rrugën. Si atëherë.

— Kur t'i shkruash, bëji të fala nga unë, — tha Petroja.

— Mirë, — tha vajza dhe u skuq. Për herë të parë po ia shprehte dashurinë e saj një njeriu tjetër, një burri babaxhan, të shkurtër e me mustaqe, një shoferi që transportonte dru pishe në qytet. Makina u nis. Vajza qëndroi edhe pak, rregulloi çantën në sup dhe mori rrugën

për në fshat. Sot donte ta bënte pa njerëz rrugën, vetëm sot. Donte ta përfytyronte deri në hollësitë më të vogla atë udhëtim. Por e pa se nuk mundej. Dhe tha:

— Sa shumë që e dua!

Kishte arritur në majë të pllajës. Po korrej bari i fundit. Lëngu i tij kundërmonte anembanë. Vjeshta e parë. Diku klithën dy zogj. Mbi Ostrovicë nuk kishin dalë akoma retë. Qyteti ishte larg. Ajo mori një shteg mes thanash dhe kulprash. Manaferrat nxinin tërë shkëlqim. Nga një luadh dikush thërriste me zë të lartë:

— Ndrekoo!

Pishat e Voskopojës u zhdukën. Tani çdo gjë po zgjohet nga tulatja e natës. Dhe tha:

— Sa shumë që e dua!

Dhe, pa e kuptuar, zuri të vraponte nëpër rruginat e holla, që i kishte aq të afërtë dhe aq të njobura. Ajo vrapoi e vrapoi, derisa iu mor fryma. Dhe kur ndjeu se ishte në mes të pyllit, i erdhi në mendje një këngë e vjetër që e kishte mësuar kur ishte e vogël. Por tani ishte e pjekur, e madhe...

Në fshat ranë shirat e parë. Ata nuk vazhdonin gjatë. Shiu kërciste mbi pllakat e çatisë dhe pikonte nga strehët. Ajo dilte në dritare dhe shikonte rrjedhjen e përrrenjve. Edhe kur bënte mësim, shkëputej për një çast dhe dëgjonte përplasjen e shiut pas xhamave. Pastaj kthehet nga nxënësit dhe fliste. Në mbrëmje i vinin vajzat e fshatit. Qëndisnin dhe ato i tregonin të fshehtat e tyre. Iknin vonë. Ajo shuante driten dhe mbante vesh. Ishte mësuar të ndiente edhe zhurmën më të lehtë të stinës. Ai i shkruante rregullisht dhe të dy prisnin me padurim dimrin, dëborën, pushimet.

Vajza zbriti dy herë në qytet. Dhe dy herë udhëtoi me shoferin e shkurtër e babaxhan, që mbante me vete

të birin, kur ky kishte pushime. Vajza, si gjithmonë, fli-ste pak, por shoferi e kuptonte menjëherë lumturinë e saj. Ajo nuk kishte forcë t'i fshihte asgjë.

— Të njoh nga sytë unë, — thoshte shoferi.

Vajza hidhte mënjanë flokët që i binin mbi sy.

— Mos u mërzit. E, si fluturon koha! Për dasmën tuaj mos zini taksi. Të marr unë me kamion. E, apo nuk e kam mirë?

Vajza qeshte dhe e shikonte me bisht të syrit.

Ky dialog u bë i zakonshëm, por asnjëherë ata nuk mendonin për të si për diçka monotone. Në fshat ra dë-bora e parë. Ajo nuk e bllokoi rrugën. Era që fryu nga jugu e shkriu. Dëbora pikonte nga halat e pishave. Si atëherë kur vjen pranvera.

Në fshat u shuan zhurmat e fundit. Dëgjohej vetëm ujëvara e bardhë. Një ditë vajzat ishin mbledhur para vatrës së kulturës.

— Erdhi dimri, mësuese, — i tha Fatimeja, një vaj-zë e hedhur, që këndonte bukur.

— Erdhi.

— Tani do të mblidhemi më herët në shtëpi. Shpre-sa se nga ka mësuar një këngë të re. Më duket se ia ka dërguar i fejuari që është ushtar.

— Si është Petriti? Besoj se të shkruan çdo ditë le-tra.

— Moj, korba! Ç'thërret kështu, apo të dëgjojë fshati?

— Ikim tani, se do të mblidhemi përsëri nesër, apo jo, mësuese?

— Patjetër.

Shpresa vrapi është dëborë, duke e ngritur atë me këmbë.

Erdhën pushimet e dimrit. Ajo zbriti në qytet. Djali kishte dalë ta priste në hyrje të qytetit. I pari e dalloi

shoferi. Djali po rrinte buzë xhadesë, mbështetur pas shtyllës elektrike.

«Paska mësuar cigaret», tha ajo me vete dhe sepse u drodh.

Pushimet kaluan shpejt. Dhe ai iku. Për tërë natën ra dëborë. Të nesërmen doli dielli.

— E përcolle? — tha shoferi.

Dhe përsëri ia vuri re në sytë e saj një hije të lehtë mali. Petroja e kuptoi se ajo kishte qëndruar mes njerëzve që e përcillnin dhe kapte çdo shprehje të ftyrës së tij. Pastaj, kur autobusi po nisej, i qe afruar xhamit. Xhami zuri një perde të hollë avulli. Ai e fshiu, po autobusi shtoi shpejtësinë, dhe ajo nuk e dalloi mirë. Kur djali e fshiu me nxitim xhamin dhe ktheu kokën, njerëzit du-keshin të gjithë njëlljo.

— Kjo është rruga e fundit, — tha Petroja.

— Përse?

— Do të punoj në një vend tjetër deri në behar.

Dëbora shkëlqente nën diell, e ngrirë. Edhe ditën ajo nuk do të shkrinte. Dielli s'ishte shumë i ngrohtë. Anash rrugës kishte shenja kafshësh. Makina nuk kishin kalar. Tek ura hipën edhe dy arsimtarë të tjerë. Ata jepnin mësim pranë fshatit të vajzës.

— Nuk ke frikë nga ujqit? — tha Petroja.

I biri, apo dëgjoi fjalën «ujq», u shkëput nga mendimet e tij.

— Edhe kam, — tha vajza, — por nuk e bëj veten rrugës.

— Ke parë ujq? — pyeti djali i vogël.

— Po, — qeshi vajza.

— Janë të ligj?

— Shumë.

— Kjo është e fortë, — tha Petroja, — dhe nuk trembet.

— As unë nuk trembem, — tha djali.

— Po të trembeshe, nuk do të merrja në makinë asnjëherë.

At e bir bisedonin me seriozitet. Vajza kënaqej kur i shikonte.

— Si vete me mësimet? — pyeti vajza.

— Mirë, — tha Petroja dhe vështroi të birin me një krenari të hapur. — Do ta bëj me shkollë.

Vajzës papritur iu kujtua Zeneli. Edhe ai kështu do të sillej me fëmijët. Ai ishte i dashur. Sa fëmijë do të lindnin? Në shtëpinë e saj ishin pesë fëmijë. Ajo nuk e kishte bërë ndonjëherë këtë bisedë. Kishte shumë qejf ta bënte, por stepej.

— *Ti ke një tē mirë, — i tha Zeneli një natë para se tē nisej pér nē Tiranë, — se nuk flet pér martesën.*

Vajza u drodh nga toni i djalit. Ajo nuk e përcaktonte si ishte ai, megjithëse e ndiente se diçka kishte ndryshuar. Ai sikur ishte pak i ftohtë, metalik. Por vajza i kalonte dyshimet, duke ia hedhur fajin vetes.

— Nuk tē kuptoj, — i tha ajo.

— Çfarë nuk kupton?

Po, çfarë nuk kuptonte? Dhe heshti.

— *I kam inat ato vajza që flasin pér martesë, — i tha ai. Dhe vajzës iu duk sikur ai po bisedonte me një njeri tē huaj dhe sikur ajo po përgjonte dialogun e tyre. Por vajza nuk donte tē dyshonte pér asgjë.*

— Këtej paska rënë shumë dëborë, — tha Petroja.

— Kështu bie gjithmonë këtej, — tha vajza.

— Jam rritur në këto vende.

Degët e pishave rëndonin deri përtokë. Ata panë se si u shkund nga dëbora një pishë e madhe.

— Po luajnë ketrat, — tha vajza.

Hapësira e bardhë e bënte mëngjesin madhështor.

Voskopoja dukej si e fundosur në dëborë. Shtëpitë lëshonin tym të dendur. Petros iu duk sikur nuhati erën e pishës. Ishte rritur duke thithur atë erë.

— Mbaje këtu, — tha vajza.

Petroja frenoi. I dha dorën vajzës dhe i tha:

— Tani do të takohemi kur të shkrijë dëbora, në behar.

— Mirë, — tha vajza dhe u nis prapa dy arsimtarëve të tjerë. Ata ishin të parët që çanin rrugën.

Asaj nuk i vinin më letra të gjata dhe të shpeshta, si më parë. Në njëren prej tyre ai i shkruante se donte të lexonte në letrat e saj meditime dhe jo për këngët e reja që mësonte me vajzat e fshatit, për nxënësit dhe pyllin e shqetësuar dimëror. Këto gjëra mbajnë erë myk, si rroba të ndenjura. Dhe përsëri vajza tha se ai bënte shaka.

Nga fillimi i marsit ajo mori letren më të shkurtër. Ajo e lexi atë në lirishten e vogël të pyllit. Nxënësit ishin shpërndarë dhe kudo dëgjoheshin të thirrurat e tyre. Në pyll çdo gjë merr një tingull të veçantë. Ajo shkëputej herë pas here nga letra dhe shikonte nxënësit. Ata e ftuan të lozta kukamçetas. Ajo i përkëdheli dhe u tha se do të luante më vonë. Nxënësit u larguan. Mbeti vetëm Pranvera.

— Shko luaj dhe ti.

Pranvera uli sytë dhe këputi një fije bari.

— Mësues, ti je e mërzitur.

— Jo, jo, — tha shpejt e shpejt, si e trembur. Pastaj përkëdheli flokët e kuqe të nxënëses dhe vuri buzën në gaz.

— Pse s'vjen dhe ti me ne?

— Jam pak e lodhur. Sa të çlodhem, do të vij. Shko, shko me shoqet. I dëgjon? Po të thérresin.

Pranvera u ngrit si me përtim dhe u largua duke

kthyer kokën disa herë pas. Pas pak në lirishte s'mbeti njeri. Nxënësit ishin futur mes drurëve dhe nuk bënин më poteren e parë. Me siguri që Pranvera duhej t'u kish-te thënë të mos e mérzisnin mësuesen. U mat të ngri-hej, të futej mes tyre, por vetëm kërcitja e letrës e stepi. Dhe sado që u përpoq ta harronte bisedën që pat bëre me Zenelin kur këtij i kishte dalë e drejta e studimit, prapë ajo e pushtoi si një rrymë e nëndheshme, që sapo gjen një të çarë shpërthen me forcë, duke mbuluar tokën.

— Je i gëzuar, Zenel?

— Shumë.

— Po të jesh kaq shumë, do të më dukesh egoist.

— Gëzimi gjithmonë është egoist.

Ajo ndaloi dhe ngriu. Zeneli eci përpara.

— C'rri si e mpirë? Ty nuk të bëhet qejfi, që po shkoj në universitet?

— Si nuk më bëhet, po ti, ti...

-- Unë, të paktën, nuk do të vij më në këtë fshat.

— Përse flet kështu Zenel?.. Ne këtu jemi...

— Shiko, Vjollca, sot nuk dua të më turbullosh.

Deri në shtator kanë mbetur edhe tre muaj. Shumë, ta marrë dreqi, shumë!

Zeneli i ra me këmbë një tufe lulesh të egra dhe hodhi vështrimin mbi Tomorr. Ata ecën një copë rrugë pa folur.

— Zenel, — tha Vjollca, — po të mos ishte ky fshat, ne nuk do të ishim njohur. Nuk e di, po ai ka hyrë në jetën time si shtëpia ku kam lindur dhe jam rritur.

— Ashtu?! Përse s'ma ke thënë më parë këtë gjë? — e pyeti Zeneli me ironi.

— Sepse kam menduar se edhe për ty, është po aq i dashur, sa edhe për mua.

Zeneli qeshi. Vjollca u drodh. Nuk e kishte parë ndo-

njëherë tē qeshte me aq ironi. E qeshura sikur derdhi nē heshtjen e tyre diçka tē ftohtë.

— Po tē ishte ashtu si thua ti, nuk do tē lëvizja gjithë ata gurë pér t'u bërë inxhinier. Dhe deri më sot, nē këtë fshat nuk ka inxhinierë. — Ai ishte i kënaqur dhe nuk vinte re ç'efekt shkaktonin fjalët e tij.

«Gëzimi gjithmonë është egoist», i ushtuan përsëri në vesh fjalët e Zenelit. Ky ushtim erdhi i rëndë, i turbullt. Vjollca ndjeu t'i thyhej diçka. Ishte thyerja e parë brenda botës së saj tē pastër, tē çiltër nga njeriu që e donte aq shumë.

— Ti ke bërë gabim që nuk ma ke thënë më parë se do tē studjosh pér inxhinieri. Unë mendoja se do tē ndiqje filologjinë.. .

— Po tē ta thosha, ti do tē më mërzisje. Pastaj, pér ty kjo s'ka rëndësi. Ty tē mjafton pedagogjikja.

— Jo, — tha Vjollca, — nuk më mjafton. Sivjet do tē regjistrohem nē filial.

— Ou! E kur vendose, kështu!? Tani?

— Po, tani.

— Mrekulli! Me diplomën e filialit gjendet edhe vendi nē qytet.

— Zenel, ti tani më njeh dhe e di se ky fshat... .

— Po, po, është si shtëpia ku je rritur dhe ku ke le-xuar librin e parë me përralla. Apo jo? —

Zeneli qeshi dhe nxitoi drëjt fshatit.

Mbi kurorën e pishës më tē lartë ishte shtruar disku i bardhë i hënës. Yjet, edhe ato tē bardha, tē largëta, dukeshin si fole zogjsh. Aty më tej djali i Hasanit po mblidhë qershítë e para. Nga rruga e fshatit po nisej një makinë. Nata mbante erë tërfil. . .

— Mësuese, mësuese!

Nga pylli doli Pranvera.

— Kemi gjetur një lule shumë të bukur, eja ta shikosh. Na erdhi keq ta këputnim, se do të thahej.

Ajo u ngrit. Pranvera e kapi për dore dhe vrapoi. Ajo shtrëngoi fort letrën, e grisi dhe e hodhi mbi lirishte. Ai i kërkonte *lekekë*.

Letra që erdhi në prill ishte më e gjatë e më e ngrohtë, dhe atë e zuri malli. Një mëngjes dielli lindi i ngrohtë, dhe akulli nuk bëri zbukurimet e veta mbi xham. Pastaj fryu juga. Pranvera derdhi mbi fshat tronditjen e tokës. Ajo vrapoi në të dalë të fshatit dhe hodhi sytë nga lindja. Në pyll dëbora shkrihej tërë zhurmë. Drurët drejtonin trupin e tyre delikat, dhe ajo dëgjonte zhurmat e ujërave të nëntokës. Natën pa rrjedhjen e kataraktit të bardhë si vello mbi trupin e saj. Ajo u vërtit mbi shtrat dhe s'mundi t'u shmangej ngacmimeve të pranverës dhe të dritës së hënës.

— Iku dhe një vit, — tha ajo me zë.

Në qytet nuk kishte zbritur që në janar. Në maj mori një letër ku ai i shkruante se do të vinte për të mësuar për provimet. Dhe ajo u nis. Makinat vinin të ngarkuara me dru. Ajo pyeti një shofer pér Petron. Ai i tha se Petroja do të fillonte të hënën. «Mirë, — tha ajo, — do të kthehem me atë».

Të hënën doli që në mëngjes tek rruga në dalje të qytetit. Ishte errët. Dielli donte edhe ndonjë orë pa të dilte. Ajo u ul në një gur dhe u mbështoll me shallin e kuq. Nga lindja frynte një erë e ftohtë. Era e mëngjesit të qytetit ku ishte rritur. E njihte mirë. Mbi rrugë ec-te duke kërkellitur një qerre. Plepat nuk shushurinin aksoma. Sapo lëshonin sythet. Ajo vështronë degët gjysmë të zhveshura dhe nuk përqëndrohej dot. Ishte takuar të dielën me Zenelin dhe kishte qëndruar fare pak. Ai ishte nervoz dhe vazhdimisht shikonte rreth e qark, sikur priste të vinte njeri.

— Edhe një muaj ka mbetur, — tha ai.

— Po, edhe një muaj.

— S'është kohë e gjatë.

— Po.

— Atëherë edhe do të njihemi më mirë.

Vajza u habit dhe tha:

— Cfarë?

— Do të njihemi më mirë. Njerëzit ndryshojnë me ditë dhe javë, dhe jo ne që kemi gati një vit. Apo e kam gabim? Pas një muaji do të dal të të pres. Mirë?

— Mirë, — tha ajo dhe çdo dëshirë për të qëndruar më gjatë iu zhduk.

«Unë nuk kam ndryshuar, — tha ajo me vete, — nuk kam ndryshuar. E dua...»

Megjithëse ngulte këmbë me veten e saj se e donte si më parë, e kuptonte se kjo ishte e pamundur. Dhe kë-të ia thoshte dashuria e saj për gjithçka. Ajo ishte një vajzë e thjeshtë, që nuk e humbiste veten me çekërrima. Ajo kapej pas jetës me guximin e njerëzve që e duan atë. Dhe e dinte se në jetë mund të kishte edhe humbje, por ato do të ishin të përkohshme. Bile ajo e ndiente se nuk po humbiste gjë. Vjollca do të mërzitej, sikur fjalët e Zenelit t'i errësonin njerëzit që e rrethonin dhe èndrrat e saj për të ardhmen. Dhe duke menduar kështu, brenda saj rritej një forcë e çuditshme, si rrënjet e pi-shës, që shtrihen thellë tokës dhe nuk i shkul dot as stuhia më e tërbuar. Sa herë i kishte parë ajo dimrit! Era ulërinte, kurse pishat as donin t'ia dinin. Kur mbaronte stuhia, ato ngriheshin më të forta, më të larta, më krenare. Stuhia thyente yetëm ndonjë degë të kalbur apo të thatë. Sa shumë që i donte pishat! Edhe ai shoferi, me emrin Petro, kishte mall për pishat dhe erën e tyre.

Petroja i ra borisë fort për të dytën herë. Vajza ngri-ti kokën dhe qeshi si e zënë në faj.

— E paske humbur fare, — tha ai dhe i shtrëngoi dorën.

Petroja e kuptoi se vajza ishte e mërzitur, prandaj nuk guxoi ta pyeste. Ishin vetëm. Për çudi atë mëngjes nuk kishte pasagjerë. Ai ndezi një cigare. Vajza sikur i trembej çdo fjale të shoferit. Megjithatë e pyeti:

— Si e ke djalin?

— Mirë është, qerratai. Mezi pret të mbarojë shkolla, që të vijë me mua.

Dhe asnjëri nuk dinte si ta vazhdonte më tej bisedën.

— Si është Zeneli? — tha shoferi.

— Mirë, — u përgjigj vajza shpejt e shpejt, sa edhe ajo vetë nuk e kuptoi përsë foli ashtu.

Makina kërcente mbi gropat e rrugës. Ujërat e kishin prishur rrugën mjaft. Punëtorët e mirëmbajtjes sapo kishin filluar ta mbulonin e ta mbushnin me zhavor. Shoferi i përhëndeti me dorë. Luadhet po çelnin lulet rozë të tefilit. Tek e shihte vajzën ashtu të mërzitur, Petroja mendoi se do të ishin zemëruar. Kur kishte qenë i ri, edhe ai ishte zemëruar me të shoqen. Por, ama, ata duheshin shumë. Bile Petroja thoshte se tani që po plakeshin, s'bënин dot pa njëri - tjetrin. «Edhe do të zemërohen ndonjëherë, — tha me vete. — Janë të rinj dhe duhen shumë». Kishin çelur thanat. Ai zbriti dhe këputi një degë. Vajza e shikonte si kënaqeje me lulet dhe ndiente ta pushtonte një dashuri e çuditshme për atë njeri të moshuar, që bëhej si fëmijë para një degë të lulëzuar thane.

— Më pëlqejnë thanat, — tha ai. — Im atë, ndjesë pastë, nuk donte bastun tjetër, përveç me dru thane. I sollën një nga jashtë shtetit, por nuk e mbajti asnjëherë. E, ka qenë plak i çuditshëm!...

Kur u ndanë, i tha:

— Mos u mërzon.

Ajo i tundi dorën dhe i thirri:

— Bëji të fala djalit.

Petron e kapi një mall i çuditshëm për të birin. As vetë nuk e kuptoi përsë. Djali ishte bërë një vit më i madh. Ndofta mot nuk do të luante më buzë përroit. Ai do të vinte, por nuk do të luante. Do të dilte të shëtiste sa për t'u çmallur. Dhe Petros sepse i erdhi keq.

Muaji i provimeve kaloi. Gjatë tërë muajit Vjollca u mor me preqitjen e nxënësve për provimet. Dhe ata dolën shumë mirë. Në gjëzimin e tyre ajo harroi rrjedhjen e ditëve. Nxënësit e klasës së tetë bënë lutjet për të vazhduar shkollën. Disa do të shkonin në qytet, në pedagogjike. Ndofta do të uleshin në bangon e saj. Ajo e kujtonte me mall shkollën e mesme, klasat, oborrin, shqet dhe veten me përparsë të zezë. Tani ishte rritur. As-kush nuk do ta njihte atë nxënëse të drojtur në Vjollcën e tanishme. As Zeneli nuk e njohu kur e takoi.

— Sesi më dukesh, — tha ai, — sikur je bërë më e ashpër.

— Në ç'kuptim më e ashpër?

— S'e ke më atë drojtje apo edhe frikë para meje.

— Unë s'kam pasur frikë ndonjëherë para teje!

— u habit Vjollca.

— Ashtu?! Po më habit. Kurse unë mendoja se ti do të ishe akoma më e drojtur tani që unë mbarova edhe vitin e parë. Dhe nuk e mbarova keq.

— Ty do të të pëlqente kjo gjë?

— Zakonisht burrit kjo gjë i pëlqen.

— Ndërsa mua jo.

— Ou! kisha të drejtë kur të thashë herën e fundit se njerëzit ndryshojnë me ditë dhe jo me vite. Hë, se kam harruar të të pyes: mos ka ardhur në vendin tim ndonjë arsimtar i ri?

Vjollcës iu errën sytë. Por pastaj i erdhi turp që u turbullua. U pérpoq tē buzëqeshte.

— Do tē vijnë dhe do tē jenë më tē mirë se ty, shumë më tē mirë! — Ajo i tha këto me përbuzje dhe u mat tē largohej. Zeneli e kapi pér krahu.

— Mos mendo se je e fortë.

— Kam tē drejtë tē mendoj se jam e fortë, kurse ti nuk mund tē mendosh dot kështu pér veten tënde, — ia ktheu Vjollca me mllef e u largua. Dhe asnjëherë nuk e ktheu kokën pas.

Vera kaloi shpejt dhe po vinte shtatori. Të nesërmë fillonin mësimet.

— Sot do tē marrim me vete mësuesen, — tha Petroja.

— E marrim, — tha i biri.

Petroja u çudit kur dalloi tek guri mësuesen. Ai e dinte se atë ditë niseshin studentët. «Nuk paska dalë ta përcjellë tek autobusi», mendoi.

Ajo i shtrëngoi dorën fort. Sytë i kishte tē bukur dhe pak tē trishtuar. Edhe ajo vjeshtë ishte ndryshe nga vjeshtat e tjera. Ishte një vjeshtë e shëndetshme, dhe mollët sa s'thyheshin nga kokrrat. Në kabinë nuk u zhvillua biseda e zakonshme. Dhe tërë kohës vajzës i endej në sy një dashuri e thellë. Petroja ia kishte mbërthyer sytë rrugës. I biri e ndiente se ishte rritur. Ai rrinte serioz. Nuk i vinte keq, që po linte pas fëmijërinë. Edhe vajza linte pas diçka. Dhe bëhej më e fortë e më e qetë. Nuk i pritej sa tē zbriste nga makina dhe tē merrte rrugën mes luadheve e mes drurëve tē pyjeve. Petroja e shikonte dhe, pér habinë e tij, nuk i vinte keq pér vajzen. Kur u ndanë, ai i tha:

— Kushedi kur takohemi bashkë.

— Përse? — tha vajza.

— Do të marr makinë të re dhe do të punoj në një rrugë tjetër.

Vajza u mërzit një çast, por pastaj qeshi. I dha dorën.

— Mirupafshim! — tha ajo.

— Shiko, shoferëve u thuaj se je mbesa ime dhe s'ke për të mbetur kurrë rrugëve, — tha Petroja, megjithëse ishte i sigurtë se ajo nuk do t'i thoshte asnjeriu dhe s'kishte për të mbetur kurrë në rrugë.

Në sytë e saj endej një dashuri e thellë, kurse përreth ndihej era e pishave.

UJQ NË VERË

Kur u kthye nga fshati, ku kishte shkuar, si zakonisht, për të biseduar me ata që njihte, babai tha se në pyll ishin dukur disa ujq. Motra, sapo e dëgjoi, u ngrit dhe iu fut nënës në gjoks. Unë me vëllanë prisnim që ai të na tregonte më gjatë, por babai donte të flinte dhe u shtri në dyshek. Ne rrinim rreth tij dhe nuk ia ndanim sytë. Babai nuk e vuri re kureshtjen tonë dhe mbuloi kokën, mos i binte drita e llambës me vajguri. Ishte natë e dytë që kishim ardhur aty, në rrëzë të pyllit, pranë sharrës, për të kaluar pushimet. Babait i pëlqente shumë ai vend dhe, sa herë që i binte leja në verë, na hipte majë makinës, merrte çadrën e vjetër dhe e ngrinte në të njëjtën lëndinë. Ne e kalonim ditën duke bredhur në-për pyll pas ketrave dhe zogjve, nëna gatuante, kurse babai shkonte në fshatin pranë dhe bisedonte në klub. Ai i njihte gati të gjithë, sepse kishte kohë që punonte në ato anë. Bile ai kishte shkuar i pari kur qe hapur rruga automobilistike. Babai lëvizi në dyshek. Fierërat që kishim shtruar përtokë kërcitën. Atëherë ai na pa që ne nuk kishim gjumë.

— Bini, — tha, — se nesër do të shkojmë larg.

Ne bëmë sikur do të binim, por përsëri nuk na linte kureshtja. Unë s'kisha parë kurrë ujk. Dimrin e kaluar,

kur dëbora kishte arritur deri në një metër trashësi, ujquit, siç thoshin, ishin tërbuar nga uria e kishin zbritur deri në shtëpinë tonë, që është në të dalë të qytetit. Unë dëgjova ulërimën e tyre dhe të lehurat e qenve të mëhallës. Por ata ishin qen të vegjël, qen shtëpish. Të nesërmen në mëngjes dëbora ku rrëshqisnim ishte skuqur. Ujquit kishin shqyrr konen e Mitas, që e priste të zotin tek dera jashtë sa të kthehej nga puna. Ajo ishte një kone e bardhë me lesh, me turi të vogël dhe të zgjuar. Të gjithëve na erdhi keq dhe u betuam se do të hakmerreshim. Netët e tjera rrugët në periferi të qytetit ruheshin nga gjuetarët. Në për gjumë dëgjohej ndonjë e shtënë. Unë dilja me vrap në dritare, por s'dalloja gjë. Dëbora ngrinte dhe jashtë ishte qetësi, një qetësi e veçantë, sikur fshihte diçka. Edhe kur binte dëborë e dendur, me flokë të vogla, ishte po ajo qetësi që fshihte diçka. Kur shikoja rastësisht ndonjë gjuetar që ecte i kërrusur me çiften gati, prapë më dukej sikur heshtjen e dëborës ishte vështirë ta prishje. Thoshin se ujquit zbrisnin si hije dhe shikonin shumë larg. Dhe ajo heshtje i ngjante vështrimit të thellë të egërsirave të uritura. Kur takoheshim me shokët, thoshim të tërë se natën kishim parë nga një ujk të madh, kurse vetëm Berti nuk gënjente. Ai e kishte babanë gjuetar dhe të shtunave rrinte deri vonë me të në pritë. Babai i Bertit kishte vrarë dy ujq. Unë mërzitesha që babai im nuk ishte gjuetar. Ujquit u trembën dhe nuk u dukën më në qytet. Pastaj u ngroh koha dhe dëbora nisi të shkrinte. Dhe ne të gjithë i urrenim ujquit.

— Përse nuk bini të flini, — tha përsëri babai, — apo keni frikë?

— Gjete dhe ti kur të tregosh! Nuk të durohej sa të gdhihej, — tha nëna, e nxehur, — apo do që të llahta-risen natën?..

Babai u ngrit mbi bërryla dhe na i mbërtheu sytë

me radhë për disa minuta, sikur na bënte kontroll.

— Po ti ke frikë? — i tha vëllait.

— Jo, — tha vëllai.

— Po atëherë përsë nuk fle?

— Kot.

— Mirë. Po ti? — m'u drejtua mua.

Unë isha më i vogli. Frikë nuk kisha, por s'dija si t'i përgjigjesha. Babai nuk do që ta gënjejmë. Dhe se pse më dukej sikur, po ta shprehja se s'kisha frikë, nuk do të më besonin. Prandaj vetëm sa e pashë në sy dhe nuk fola.

— Po të kesh frikë, eja fli ngjitur me mua.

— Jo, — i thashë, — do të fle pranë nënës.

Nëna më zuri për dore dhe më përkëdheli.

— Kush ka armë, ka zënë shtigjet pranë bagëtive,

— tha babai. — Doja të rrija edhe unë, se sonte qenka kohë e bukur, por do të bëheshit ju merak.

— Hajde shkojmë tani, — tha vëllai.

Babai u mendua. Mua më hipi një dëshirë e madhe të shkoja në pritë të ujqve. Por kujtova se babai nuk do të më merrte me vete dhe u nxeva, që nuk i thashë, kur më pyeti, se nuk kisha frikë fare.

— Hë! Ti thua të shkojmë? E di që nuk e ke keq. Vishu!

— Je në terezi apo shkallove? — tha nëna.

— Rri, moj, urtë, — i tha babai, — dhe më jep elektrikun e dorës.

— S'ta jap! — tha nëna e vendosur.

— Ohu! — tha babai. — Po të shkoja me mendtë e tua, kushedi se ç'do të më kishte ngjarë! Ky nuk është i vogël. Pastaj, nuk është keq të shohë si vriten ujqit.

Vëllai sa s'fluturonte nga gjëzimi. Unë e mata zili.

— Po ne me kë do të na lësh? — tha nëna.

- Mc këtë, — tha babai duke më rrahur shpatullat.
- Nuk ta mbush syrin?
- Ky është i vogël dhe do njeri të madh pranë, kurse ti...
- Jo, tha babai, — ky s'është më i vogël, apo jo?
- Po, — i thashë unë.
- Ai nuk merr vesh se ç'bëhet, — tha nëna.
- Mirë, mirë, — tha babai pa e përfillur dhe iu drejtua vëllait: — Gati?
- Gati, — tha vëllai.
- Babai ngjeshi në rrip thikën e madhe. Vëllai donte të merrte pér vete sëpatën e vogël, por babai nuk e la.
- Këtë do ta mbajë ky, — dhe ma dha mua. — Ki mendjen, — më tha, por unë nuk e mora vesh në tallej apo e kishte seriozisht. Vëllai kapardisej para nesh. Nëna nuk nguli më këmbë. Ajo ia njihte mirë kokën babait dhe nuk e kishte kundërshtuar ndonjëherë. Ajo tundte kokën, kurse motra as merrte frymë.
- Po ua mbyll derën që jashtë, — tha babai. — Ti ki mendjen.
- Mos ki merak, — i thashë dhe sepse nuk e pata zili vëllanë. Ata dolën jashtë. Ishte errët dhe nuk dukej asgjë. Në malin përballë barinjtë kishin ndezur zjarr. Drita e tyre dukej si yll. Qielli ishte i kthjellët, por pa hënë. Dëgjohej vetëm vija e ujit që zbriste pak më poshtë se çadra jonë. Babai mbylli derën prej mushamaje me gurë. Ne dëgjonim nga brenda se si ata kontrollonin me kujdes çadrën dhe si zunë disa vrima të vogla. Pastaj ikën. Ne nuk folëm deri sa humbën hapat e tyre. Nëna rregulloi dyshekun që kishte prishur babai.
- Bini të flini, — u thashë.
- Po ty të pëlqen mendja, që e le babanë të ikte, apo do të hiqesh trim? — tha motra duke shtrembüuar fytyrën.

— Fli, fli! — i thashë me inat. — Unë do të presa të kthehen ata.

— Hajde mblidhemi të tre, — tha nëna.

— Jo, — u thashë, — unë nuk do të fle. Do të rri zgjuar gjersa të vijë babai.

— Trim i madh, ti, posl!.. — u tall motra.

— Mbylle gojën! — i thashë.

— Mos u zini, se është natë.

Sa dëgjoi fjalën «natë», motra u tulat dhc m'i ngulit sytë me dashuri.

— Mos ki frikë, — i thashë. — Natën e mirë!

— Hajde dhe ti këtu.

— Jo.

— Lëre, mos iu lut, edhe ai kokën e t'et ka.

Mua m'u bë qejfi që nëna tha ashtu dhe shkova të kontrolloja çadrën. Këtë e bëra për t'u dhënë zemër, me gjithëse e pashë që nëna e kishte mbledhur veten dhe e kishte harruar inatin për babanë. Asaj i ikte shumë shpejt inati. Fitili i llambës po kërciste. Kishte mbaruar vajguri. Flaka lëshoi tym dhe u fik. Në çadër u bë errët. Nga jashtë nuk hyntë fare drítë. M'u duk sikur edhe ne ishim në pritë. Nuk merrte frymë asgjë, as edhe pylli. Dhe unë ndjeva sikur ujqit thyenin degët e thata, shkelnin barin, zinin ujin e burimit dhe afroheshin duke u zvaritur. Vetëm sytë u ndrisnin tërë lakmi. Shtrëngova sëpatën dhe bëra për nga dera. Sepse më dukej sikur ujquit donin të shkallmonin derën për të hyrë brenda. Nëna nxori shkrepsen dhe ndezi një copë letër, të cilën ia dha motrës ta mbante. Shkoi në qoshe të çadrës, ku lini m bidonin. Motrës iu dogj dora dhe e hodhi menjëherë përtokë. Në çadër u bë përsëri errësirë. Kisha dëgjuar se ujquit duan kohë të turbullta, të ngrysura, me stu-

hi dhe furtunë. Kur iu shua flaka e letrës motrës, unë pata idenë sikur qelli u mbush me ré të zeza sterrë dhe plumb të rënda dhe sikur ato u çanë pér një çast dhc shkrepëtinë rrufetë. Nën dritën e tyre pishat sa s'thyen majat e tyre, aq shumë u përkulën. Ky ishte një imazh i ngacmuar nga fantazia ime e ndezur.

Dhe unë u bëra më i fortë. Por nëna ndezi llambën me vajguri, dhe tërë përfytyrimi im u tret nën dritën e zbehtë, të verdhë të llambës.

— Përse e ndeze? — i thashë nënës. — Kështu ujqit shikojnë dritë dhe ata këtë presin.

Edhe motra më vështroi sikur kisha të drejtë, por nuk foli.

— Ujquit nuk vijnë deri këtu, — tha nëna, — prandaj mos ki frikë. Hajde të flesh.

— Jo, moj! Ujquit atë duan që unë të fle dhe të sulmojnë. Me kë flas dhe unë! Këtë gjë ti nuk mund ta kup-tosh, sepse nuk je burrë. Këto janë punë burrash.

Nëna më vështroi me ngulm, dhe unë sepse dallova në sytë e saj një farë habic, përzier me një farë trishtimi. Më erdhi keq pér të dhe u pendova që fola aq ashpër. Por kur kujtova se ujquit mund të vërsuleshin nga çasti në çast, nuk e zgjata më. Kur pret ujquit, edhe mund të flasësh ashpër. Pastaj unë nuk doja aspak të fyeja nënën. Megjithatë, e kapa pér dore dhe e ula pranë motrës. Ajo më shtrëngoi në gji tërë mall. Ashtu të mbledhur të tre, qëndruam duke dëgjuar natën që përgjonte. Sytë filluan të më mbylleshin. Kjo erdhi nga ngrohtësia që përhapte nëna dhe që më sillte në mendje shtëpinë tonë. Edhe motrën po e zinte gjumi. Befas nga thellësia e fshatit lehën me të madhe qentë dhe ushtuan çiftet. Kjo zgjati vetëm dy - tre minuta, sepse qetësia u theksua akoma më tepër. Të lehurat u rralluan dhe duhej të vinin nga një distancë e madhe. Motra nuk ndjeu gjë. Nëna e uli

me kujdes dhe e mbuloi. Unë u ngrita në këmbë, i revol-tuar.

— Përse më le të më zinte gjumi? — i thashë në-nës.

— Isha unë zgjuar, — tha ajo.

— Jo, ti duhet të flesh pa merak.

Nëna donte të më mbushte mendjen të shtrihesha edhe unë, por tani kjo gjë ishte e pamundur. Isha i sigurtë se egërsirat do të vinin nga anët tonë. Ato duhej të ishin tërbuar fare dhe do të bënën të pamundurën, që të realizonin qëllimin e tyre. Kisha dëgjuar se kur plagosen, ato egërsohen më tepër. Tani nuk do të kisha të bëja vetëm me një armik dinak, por edhe shumë luf-tarak e kokëshkëmb. Andej nga fshati patjetër që do të kishin vrarë ndonjë ujk. Nëna futi në gji kokën e motrës dhe mbylli sytë. Por gjumi nuk do ta zinte. Ajo, edhe kur vonohej babai, e priste zgjuar me sytë mbyllur. Unë po mërzitesha duke qëndruar mbyllur brenda në çadër. S'kisha me kë të shkëmbeja dy fjalë dhe të thurnim plane. Dija vetëm që nuk duhej t'i lija ujqit të futeshin në çadër. Fillova të përfytyroja vëllanë dhe babanë andej nga kishin ngritur pritë. Babait i pëlqente shumë mulliri dhe me siguri që andej do të ishte me Pe-çin e Gjatë. Për Peçin thoshin se ishte zënë me një ari. Babai e njihte që në kohë të Luftës. Fytyrën e kishte të ashpër dhe tërë të gërvishura. Ai u shkonte ujqve, dhel-prave dhe kafshëve të tjera mu në strofull. Kishte ni-shan dhe të gjithë e mburrnin si gjuetarin më të zot. Ne kishim vajtur me Peçin për turtuj. Atë ditë jemi këpu-tur fare, sepse gjithë kohën vrapoja. Peçi një hap e kishte dy metra. Tani ai me babanë dhe vëllanë tim përgjoni se mos dilnin ujqit nga buza e përroit. Sikur e kisha para syve vendin: ja ura e vogël prej dërrase me par-makë anash, ja shtegu që të con thellë në pyll si verdhon

nën dritën e yjeve, ja livadhi me fier dhe luleshtrydhe dhe fshati që nuk bën gjumë, me ato shtëpi të vogla, të bardha, me bashtat plot vishnja të zeza. Sa doja të isha dhe unë aty! Ata patjetër kishin vrarë ndonjë ujk. Peç i nuk i harxhon fishekët bosh. Hajde të dëgjoje nesër vëllanë! Ai do të hiqej më i madh, sesa ishte. Fryu një erë e papritur. Kështu fryjnë erërat, si valë deti, në pyll, kur është verë. Dhe duket sikur drurët shkundin nga supet dremitjen. Por janë të lodhur dhe qetësohen prapë, si një njeri që vërtitet nëpër krevat natën në gjumë.

Po mërzitesha dhe e humba besimin që do të përlshesha me ujquit. Jashtë ishte aq qetësi, sa nuk mund ta përfytyroje se, në një natë të tillë vere, në fshat kishin vërshuar kopera ujqish dhe njerëzit rrinin zgjuar. Por dikush më ngacmonte përbrenda që të mos i zija besë qetësisë. Ajo ishte e rreme. Gjersa ka ujq, qetësia është gjithmonë e rreme, e pabesë. Ajo sikur bie kastile, që të të zërë gjumi. Në gjumë e kishin shqyer qenin e Jorgjit dhe një fshatar nga malet e Oparit. Edhe atëherë ishte verë dhe nata qe plot me yje dhe e tejdukshme. Nga era që po shpeshohej, e kuptova se kishte nisur dita e re dhe se nata po thyhej. Kjo është edhe koha kur të pëlqen të kotesh në èndrra. Nuk doja të shihja èndrra, doja të rrija zgjuar. Ujquit do të përpinqeshin me dëshpërim, sepse do të lindte dielli dhe do të shpérndahej hija. Çudituesha me veten time se nga i dija gjithë këto. Por kisha dëgjuar shumë biseda për luftën. Tani ato merrnin forma aq të vërteta, sa unë mund t'i prekja me dorë. Është diçka e çuditshme, e pashpjegueshme, por unë i prekja dhe ndieja pranë tërë tymin, zjarrin, gjakun, zhurmën e saj. M'u duk se dëgjova një të shtënë. Prita. Vetëm kur lehën qentë, e kuptova se nuk isha gabuar. Dikush kishte shtënë. Ajo erdhi andej nga livadhet e mëdha, në perëndim të fshatit. Ujquit kishin ndërruar taktikën. Do-

nin tē sulmonin jo nga pylli, siç mund tē pritej, por nga luadhet. Nuk e mbaja mend sa orë kishin kaluar nga tē shtenat e para deri tek e shtëna e dytë. Gjatë këtyre orëve ujqit i kishin rënë pyllit përqark, kishin kapërcyer malin e zhveshur dhe ishin afruar nëpër arat me thekër dhe misër. Nuk kuptohej kjo këmbëngulje pér t'u vërsulur mbi atë fshat tē vogël, gati tē humbur, mes maleve. Dhe unë thashë se ujqit nuk ishin budallenj që kishin ndërruar pozicionin e sulmit. Hapa pak derën dhe, nga e çara që u krijua, pashë si zverdhnin arat me thekër e tershërë. Ato nuk ishin tamam tē verdha. Nën mugëtirë dukeshin si tē përziera me një tē bardhë tē ndritshme. Nuk e dëgjoja fëshfërimën e tyre, por e kisha para syve. U përpoqa ta hapja më shumë derën, por babai i kishte vënë gurë tē mëdhenj nga jashtë. Po thi-thja ajrin e ftohtë dhe prisja tē kthehej babai me vëllanë, kur befas tërë gryka ushtoi nga tē shtenat e tē gjitha llojeve tē cifteve që ndodheshin në fshat. Këtë herë poterja ishte shumë më e madhe dhe shumë më e gjatë. Edhe qentë lehnin tē papërmajtjatur. Ata e kishin humbur durimin dhe ishin vërsulur pér t'u përlleshur. Gjer tek unë vinin tē cunguar emra fshatarësh, që i thërrisin njëri - tjetrit. Nëna u zgjua dhe dëgjonte pa folur. Mua nuk m'u duk e trembur. Ajo tha:

— Sa shumë paskan qenë!

— Shsht! — i thashë, sepse m'u duk sikur dëgjova zérin e babait. Por jehona deformohej nga pengesat dhe nuk kuptohej. Pastaj mugëtirën e theu një ulërimë e shëmtuar, e gjervishur dhe shumë e egër.

— Ulkonja, — tha nëna. — Tani ajo është më e rrezikshme se kurrë, dhe ata duhet tē kenë kujdes.

— Përse është më e rrezikshme?

— Nuk e dëgjove ulërimën? Asaj nuk i besohet se i kanë vrarë këlyshët.

— Nga e di ti? — i thashë.

— Pse ku jam rritur unë? — më tha. — Babai im ndeshej çdo dimër me ujquit dhe më tregonte gjithmonë. Ujquit e tregojnë budallallëkun e tyre kur u vret shokët apo këlyshët. Ata mendojnë se janë të paçpueshëm nga plumbi. Ti nuk ke parë, por ujku ia mbërthen një herë sytë pellgut të gjakut, ngre kokën dhe ulërin, duke çaplyer keq gojën. Ndonjë thotë se është vajtim. Jo, ujku s'di të vajtojë. Ai ulërin, sepse nuk i besohet që ai gjak është gjaku i tij. Prandaj dhe kërcen i tërbuar në kulm. Po të vajtonte, ai nuk do të lëvizte nga vendi, si sorkadhet. Ato lëshojnë edhe lotë.

Nëna fliste me zë të ulët dhe të butë. Flokët i ishin lëshuar mbi supe. Nëna ka ca flokë të dendur që kanë filluar të thinjen. Ajo i thur gërshetë ose i mbledh prapa kokës.

— Ujkut nuk i duhet zënë besë kurrë-kurrë.

Unë e kuptova se nëna po fliste me veten e saj, duke m'u drejtuar mua. Ajo do të më tregonte pas pak ndonjë histori. Të tillë shprehje i merrte ftyra, sa herë më tregonte ndonjë ngjarje. Kishte një shprehje të ëmbël dhe tërë dhëmshuri. Ajo heshti. Pylli ushtonte akoma nga të shtënat, që sa vinin e rralloheshin. Fshatarët po i ndiqnin prapa ujquit. Tani të shtënat ishin të ndara në dy anë, nga pylli dhe arat me thekër. Ato hynin në çadrën tonë si zëra të largët. Nëna donte të më tregonte diçka, por, siç duket, vëmendjen e saj e tërhoqën krismat, dhe ajo heshti. Por në një natë si kjo, fantazia ime sillte para syve gjithçka që u kishte lënë mbresë viteve të mia. Dhe nuk e di, por atë çast, m'u kujtua historia e gjyshes së nënës. Ajo ma kishte treguar disa herë, dhe unë e dija përmendsh. Ishte një histori e dhimbshme.

Në malin përballë fshatit të nënës sime, mes pishave të vjetra, janë gërmadhat e një manastiri të djegur.

Dikur ai ka qenë shumë i madh dhe shumë i bukur. Dhe mes atyre gërmadhave, mbuluar nga degët e shtogjeve dhe nga bari, është varri i stërgjyshes sime. Pse u bë kallogre? Këtë gjë nënës sime nuk ia thanë. Më vonë u sajuan aq shumë historira, sa asnjerës nuk mund t'i besoje. Stërgjyshja ime jetoi në manastir nëntëmbëdhjetë vjet. Dimrin e njëzet ra dëborë e madhe. Priftërinjtë, të trembur nga dimri, zbritën në fshat. Dhe mbeti stërgjyshja ime e vëtmuar mes manastirit. Thonë se kur nuk frynte erë, ajo dilte majë kambanares dhe thërriste njerëzit për t'i pyetur në ishin gjallë apo jo. Thonë se zëri i saj të trempte, sepse i ngjiste një ulërim. Koha sa vinte dhe keqësohej. Askush nuk dilte jashtë. Dhe vinin dëri brenda ulërimat e koperave të ujqve. Thoshin se vetëm në manastir ata nuk guxonin të hynin. Kur dëbora pushoi dhe mbi heshtjen e saj të bardhë nuk shkelte kush, veç kafshëve të egra, njerëzit prisnin të dëgjonin zérin e stërgjyshes. Por manastiri heshtte. Atëherë një fshatar tha se ajo ishte kthyer në shenjt. Gjyshi im mblodhi nja dhjetë burra të fortë dhe u nis. Dëbora ishte e ngrirë, dhe pishat mezi mbanin peshën e bardhë të dimrit. Burrat ishin të armatosur. Manastiri ishte i shkretë. Gjyshi zuri të thërriste. Hynë nëpër dhoma, por ato ishin aq të heshtura, sikur aty nuk kishin banuar kurrë njerëz. Kur hynë në kishë, aty gjetën disa koska, dhe ikona e madhe e manastirit ishte e gjakosur. Atëherë e kuptuan ç'kishte ndodhur. Kur ma tregonte këtë ndodhi, nëna më thoshte gjithmonë:

- Mos bëra keq që ta tregova?
- Po, përsë?
- Sepse mos trembesh.
- Nga kush?

Nëna nuk më përgjigjej. Pastaj më mbërhente sytë e më thoshte:

— Nga askush. Ti s'ke përse trembesh.

Pastaj, kur mbetesha vetëm, rrija dhe mendoja. Asaj gruaje të vojtur, që ishte bërë kallogre, kushedi për ç'arsye, nuk i shkonte aspak ndër mend se ujqit mund të hynin në kishë dhe ta shqyeren para ikonave. Ajo, me siguri, ka qenë duke u lutur dhe nuk ka kundërshtuar fare...

Në pyll u bë qetësi.

— Tani duhet të vijë babai, — thashë.

— Mundet.

— Të shtënati pushuan. Ujqit kushedi nga janë shpërdarë, të çakërdisur. Besoj se kanë marrë aq frikë, sa mos i afrohen më këtij fshati. Si thua ti, mama?

— E, sikur të ishte, si thua ti! Kjo e sotmja ka vite që përsëritet. Ndofta që kur është ngritur fshati. Dhe do të përsëritet gjersa të ketë ujq.

Nuk kisha biseduar ndonjëherë kaq seriozisht me nënën për një çështje që s'lidhej aspak me mua, me shkollën, apo me shokët. Duke e parë nënën të merrej çdo ditë me punët e shtëpisë në heshtje, nuk mendoja se ajo ruante një përvojë burri. Prandaj më kapi një dashuri që po më përhapej në tërë trupin për nënën. Doja t'i hidhesha dhe të fusja kokën në gjoksin e saj. Por ajo po bisedonte me mua si me një të rritur, prandaj u steba.

Nga e çara e vogël e derës po hynte një dritë e drojtur, e mbytur, e hirtë. Avujt e mëngjesit po ngriheshin, duke e bërë freskinë më të theksuar e më depërtuese. Era ishte gati e pandjeshme dhe vetëm sa i lëkundte paksa majat e barit të harlisur, gjethet e thanave dhe pendët e ndonjë zogu që s'kishte gjumë. Motra flinte. Nëna u kreh dhe rregulloi çadrën më herët se çdo ditë tjeter. Unë u lodha së larguari një gur, aq sa të më nxinte të nxirri ja jashtë trupin. Më në fund arrita ta lëvizja nga vendi

dhe dola jashtë. Gjithçka po merrte trajtën e saj: maja e malit, arat me tershërë dhe thekër, gurët e zinj tek burimi, drurët e drejtë, tërë nyje të pishave. Fluturuan një tufë harabelash, tërë potere dhe u vërvitën mbi çatinë e drunjtë të barakës së rojes së druve. Ajo lëshonte një tym të hollë. Me siguri, ai po ziente qumështin. Agimi ishte kaq i pastër, kaq i lehtë, sa unë e harrova natën pa gjumë. Dielli donte më shumë se një orë që të dilte nga malet e Gramozit. Rruga e fshatit ishte e përgjumur dhe nuk po shkundej akoma nga dremitja. Ajo humbiste në një kthesë të fortë, përtej përroit që rriddhe i qetë.

Mora enët të mbushja ujë poshtë, te burimi. Doja të vrapoja, por ecja rëndë. Kisha kaluar një natë të shqetësuar, plot përgjegjësi, dhe kjo s'kishtë se si të mos pasqyrohej edhe në atë ditë të re që po fillonte. Nuk them se ndryshova aq sa të mos më njihnin shokët, por që kisha pësuar një ndryshim, kjo s'kishtë dyshim. Këmbët m'u njomën. Lava sytë dhe pashë shtëpinë më të lartë të fshatit. Asaj i dukej çatia me plloça dhe oxhaku që lëshonte tym. Mëngjesin e hëngra shpejt dhe shkova të takoja babanë. Ata po pinin kafe tek mulliri. Dyqani nuk ishte mbyllur tërë natën. Të gjithë ishin bërë në qejf. Mbi të gjithë binte në sy Peçi i Gjatë. Ai seç tregonte me këmbë e duar. Babai e dëgjonte dhe queshte. Edhe vëllai rrinte rëndë. Ai as që më foli. Në shesh kishin hedhur rrëmujë pesë ujq të vrarë. Ishin të shëmtuar. Në sy nuk u ishte shuar akoma egërsia. Edhe drita e diellit sikur shëmtohej në bebëzat e tyre. Sapo të vinte makina e parë, do t'i nisnin për në qytet.

— Koçi, — i thirri babai dyqanxhiut, — silli djalit llokume.

Koçi po mblidhët në një disk të vjetër filxhanet e kafesë. Edhe vëllai kishte pirë kafe.

— Si fjete? — më tha. — Unë s'kam vënë gjumë në sy.

— As unë, — i thashë.

— Ti s'kishe përse të mos flije! Mirë ne, që u rro- patëm pas ujqve, — ma ktheu vëllai.

— Ti s'ke qenë vetëm, kurse unë isha vetëm gjithë natën.

— Andej s'kishin përse të vinin ujquit.

— Thua ti! Gjersa erdhën në fshat, edhe nga çadra jonë mund të vinin.

— Ashtu është. E si mund të flinte ai? — tha babai.

— Kushedi, ujquit atë prisnin që këtë ta mbërthente gjumi, dhe ata të bënин kërdinë.

Vetëm atëherë unë hëngra llokumet. Peçi ktheu me fund gotën me raki kumbulle. Ata e zienin vetë dy herë rakinë. Dikush lëshoi një shaka dhe të githë qeshën. Di- elli rëndoi mbi kurorën e pishës më të lartë.

THËLLËZA

Në korijen e vogël nuk kishte pasur ndonjëherë thëllëza. Kisha dëgjuar që aty kishin kapur mullenja, pupa, cërre, por thëllëza, jo. Prandaj u çudita kur kapa një thëllëzë rrëzë një dushku. Ajo rrinte e tulitur dhe shikon te e trishtuar vendin rrëth e rrrotull. Unë u afrova ngadalë dhe i kërceva sipër, duke u çjerrë nëpër shkurre. Bile në faqe më doli gjak. Ishte mëngjes, dhe bari ishte spërkatur me vesë. Shtrëngova në gjoks thëllëzën dhe ia krisa vrapi. Korija e vogël mbeti prapa dhe për një çast m'u duk sikur i vodha diçka. Por nuk kisha kohë të vrisja mendjen se çfarë i vodha korijes së vogël atë mëngjes. Unë vrapoja e vrapoja duke shtrënguar në gjoks thëllëzën. Sapo hyra në shtëpi, mora shportën e madhe, futa aty thëllëzën dhe e vara në ballkon. Zogu zuri një qoshe dhe u struk, duke fryrë pendët e bukura. Shokët e mi erdhën menjëherë dhe donin ta preknin me dorë, por unë nuk i lija.

— E, mo, kjo është e sëmurë! — tha Beni.

Unë u nxeva dhe i thashë:

— Ty të vjen inat, që nuk e zure vetë!

Thëllëza, si për të më bërë qejfin, përplasi krahët dhe lëshoi një klithmë. Unë nuk u gëzova. Zogu hodhi sytë andej nga ishte korija.

— Kur tē pjellë, do tē mē japësh një zog mua? — tha Mondi.

— Ik, mo, ku pjell dot nē shportë. Ajo do korije që tē bëjë fole, — tha Beni.

Fillova ta kem inat Benin, megjithëse e kuptoja se ai kishte tē drejtë. Thëllëza lëvizte nëpër shportë dhe godiste me sqepin e kuq thuprat. Pranë nesh erdhi duke gérhitur maçoku kobash i Todit. Ai u ngrit mbi këmbët e prapme dhe zgjati tē përparmet drejt thëllëzës. Si i shkëlqyen sytë maçokut kobash tē Todit! Ne tē gjithë e kishim inat, sepse nē dimër kur ra dëborë e madhe dhe nuk i lëshonim pëllumbat, ai u fut nē kafazin e tyre dhe e shqeu Bojëhirin, pëllumbin, që ngrivej më lart se tē gjithë. Ne u betuam se do ta vrisnim maçokun, por ai na e kishte frikën dhe ua mbathte me tē katra sa herë që na shihte. Unë nuk kam parë maçok më frikacak se ai i Todit. Prandaj dhe e urrenim. Kurse tani ai kishte guxim dhe zgjaste thonjtë drejt shportës me thëllëzën. Ajo u tremb. Mondi e goditi me shqelm maçokun. Ai u largua dhe kërceu nē avllinë përkarshi. U ul nē diell dhe zuri tē lëpihej tërë kënaqësi. Sot nuk na e kishte frikën. Dukej sikur tallej dhe sikur na falënderonte. Kisha dëgjuar se mishi i thëllëzës është i shijshëm. Por unë nuk e kapa për ta shijuar maçoku kobash i Todit. Ai nxirrte gjuhën, lëpihej mirë e mirë dhe hidhte sytë nga shporta e varur.

— Thëllëza do bar, që tē bëjë fole dhe tē flerë natën, — tha Beni.

— Shkojmë mbledhim, — tha Mondi.

— Jo, — i thashë, — ti do tē rrish roje, mos na e hajë maçoku.

— Mirë, — u gjëzua Mondi.

Unë, Beni, Lekoja dhe Ili u nisëm për në kodrën pranë. Ata flisnin tërë gaz, kurse unë heshtja. Kjo më ndo-

dhte për herë të parë. Sepse nuk më ndahej nga mendja korija e vogël, me vesën e pastër, si pika loti. Kush i kishte lëshuar ata lotë? Ndofta nata. Thëllëza kishte humbur rrugën, sepse nata kishte rënë, kur ajo nuk e priste. E përse nata ra aq shpejt, sa e hutoi zogun? Apo që në mëngjes të vija unë dhe ta kapja? Apo mos ndofta thëllëza kishte ardhur për të bërë fole dhe për ta mbushur korijen me zogj të bukur? Në kokë më vërtiteshin mijëra pyetje. Ato ishin të çrregullta, si milingonat kur ua prish folenë. Këpusja bar, i mërzitur, dhe nuk dëgjoja ç'flisnin shokët. E ndieja se ishin të gëzuar. Dhe tërë gëzimi i tyre ishte varur nën ballkon, në një shportë, së cilës ja ngulte sytë tërë lakmi maçoku kobash i Todit. Mbi korije valëvitej një mjegull e hollë, e lehtë, e bardhë, mjegulla e pranverës. Pastaj do të çelnin lulet dhe do të vinin qyqet. Sepse m'u duk sikur edhe qyqet do t'i trembeshin korijes dhe s'do të këndonin. Bari mbante erë tërfil, që të kujtonte lepujt dhe përrenjtë malorë me ujë dëbore.

Mblodhëm shumë bar. Në shtëpi hymë me vrap. Thëllëza kishte zënë qoshen e shportës dhe herë pas here mbylli te qepallat, sikur dremiste.

— Thëllëzës i flihet, — tha Mondi. — Unë nuk kam bërë fare zhurmë. Maçoku donte ta zgjonte, por nuk e lashë.

Ne dëgjonim Mondin dhe shikonim zogun. Ai as që e çau kokën për bar. Hapte dhe mbylli te sytë, sikur sillte ndër mend ndonjë gjë.

- Është e lodhur nga rruga, — tha Beni.
- Pse, nga ka ardhur? — pyeti Mondi.
- Nga malet. Babai më ka thënë se thëllëzat jetojnë në male.
- E lëmë të flerë, — thashë unë.
- Mirë, — tha Lekoja, — le të flerë pak. Tërë ajo

rrugë që ka bërë thëllëza, lodh burrat e jo të mos lodhë një zog të vogël.

— Unë kam parë një tufë thëllëzash në Ballabanovë, — tha Ili. — Kishin shkuar në burim për të pirë ujë dhe po ngjiteshin për një pyll. Në krye ecte nëna, kurse prapa e ndiqnin zogjtë. Doja t'i kapja, po nuk më la babai. «Mos i tremb, — më tha, — Shiko sa bukur ecin mes barit!»

Edhe unë kisha parë thëllëza në Ballabanovë. Në shkonim çdo verë aty me babanë. Babait i pëlgente shumë pylli. Sapo merrte lejën, ai gjente një makinë dhe na çonte në Ballabanovë. Pranë sharrës ku rrinë druvarët, në mes të pyllit, është një lëndinë e vogël, e rrethuar nga një gardh i gjelbër lajthish, thanash, pi-shash dhe ahesh. Drurët janë ngatëruar me njëri-tjetrin, sa është zor t'i çash. Aty ne ngrinim çadrën e vjetër, të mbetur që nga koha e Luftës. Në mes të çadrës varnim fenerin me vajguri, kurse poshtë shtronim fier. Ato pësëmbëdhjetë ditë që rrnim në Ballabanovë, kalonin shpejt e shpejt. Dhe një mëngjes, kur apo isha zgjuar, motra hyri në çadër me një zog të bukur. Babai na tha se ishte thëllëzë. Kur e kontrolluam, një krah e kishte të gjakosur.

— Do ta ketë plagosur ndonjë gjuetar, — tha vëllai.

— A rron dot me një krah të thyer? — tha motra.

— Kjo është budallaqe! — tha vëllai. — Ku ke parë zog të fluturojë me një krah?...

— Po mirë, kjo le të mos fluturojë, le të ecë më këmbë, — tha përsëri motra, së cilës po i vinte keq për thëllëzën e plagosur.

— Zogu ngordh, po të mos fluturojë — tha rëndë-rëndë vëllai.

— Lëshojeni, — thashë unë. — Le të shkojë të gjejë shoqet, dhe ato le ta shërojnë.

Por vëllai nuk më dëgjoi. Ai mori pak kafe dhe ia pllakosi plagën. Në qoshe të çadrës thurëm një fole me fier dhe e futëm aty thëllëzën. Ne u nisëm me babanë për nga përroi i rrëmbyeshëm që të zinim trofta, kurse nëna qëndroi në çadër të preqatiste drékën. Vëllai e porositi disa herë ta kishte kujdes thëllëzën. Kur u kthyem, thëllëza kishte ngordhur. Kishte rënë mënjanë dhe sqepin e kuq e kishte lënë pak të hapur. Të gjithëve na erdhì keq.

— Ju thashë unë që thëllëza nuk rron dot pa një krah, — tha vëllai.

E morëm thëllëzën dhe e lamë diku pranë burimit, ku bari ishte më i dendur dhe lulet rozë të tërfilit kun-dërmonin pranverë. Kjo kishte ndodhur para dy vjetësh në Ballabanovë, ku shkonim me babanë për pushime.

Thëllëza rrinte në shportë dhe as që e vinte re praninë tonë. Ajo, me siguri, kujtonte pyllin, barin dhe burimet... dhe shoqet. Ky trishtim do të vazhdonte gjatë, gjatë, derisa... Unë nuk doja të mendoja se ajo do të ngordhëte, megjithëse malli i madh që e kishte kapur thëllëzën, ishte shumë i fortë. Papritur shporta u shkund, dhe ne pamë thëllëzën që u përplas furishëm pas purtekave të thurura. Ishte hovi për të fluturuar. Atë çast ajo harroi se ishte e mbyllur, se hapësira ishte e vogël dhe nuk e lejonte as të përplaste lirshëm krahët. Thëllëza nuk donte të besonte se qelli ishte futur në shportë. Asnjëherë nuk kishte menduar që qelli që lëshon shi të rrëmbyeshëm, breshër kokërrmadh, dëborë me furtunë, që qelli që ngarkohet me ré të rënda, të mbyllej në një shportë. Prandaj ajo u përplas e u përplas një copë herë të gjatë, derisa u rraskapit. Ne të gjithëve po na vinte keq. Edhe zemra po na rrihte jo si herët e tjera. Beni u prek më tepër. Ai tha i pari se, po të mos e lëshonim, thëllëza me siguri do të ngordhëte. Ai e tha këtë ngadalë, sa m'u

duk sikur e dëgjova vetëm unë dhe maçoku kobash i Todic. Ai kishte tendosur trupin, sikur do t'i hidhej në grykë ndonjë miu.

Shokët e mi u larguan të hanin drekë. Mondi erdhi shpejt e shpejt. Ai kishte marrë bukë në dorë.

— T'i jap pak? — më tha.

— Ajo nuk ha bukë, — thashë unë.

— Ndofta e ka marrë uria, sepse s'ka ngrënë që në mëngjes.

— Jo, jo, nuk do bukë.

— Po mirë, çfarë do?

Unë doja të thosha «korijen e vogël», por sepse nuk fola dot. Heshta. Koha po bëhej për shi. Retë vinin ngadalë nga perëndimi dhe pas pak do të ndodheshin mbi çatinë e shtëpisë sime. Nga arat u kthyen pëllumbat. Ata u ulën duke bërë zhurmë mbi ashef. Bardhua këndoi, dhe pastaj të gjithë u shtrinë mbi tjegullat, duke pritur shin. Ata u qetësan dhe çukisinin pendët tërë dembellëk. Asnjëri prej tyre nuk e pa thëllëzën. Po sikur të miqësoheshin bashkë? Atëherë unë do të bëja një fole të bukur për thëllëzën, më të bukur se kafazin e pëllumbeve. Herët në mëngjes ajo do të këndonte mbi dritaren e dhomës sime dhe pastaj do të merrte arat nga shkonin për ushqim pëllumbat. Por pëllumbat as që donin të dinin për thëllëzën. Ata çukisinin pendët dhe prisnin të luheshin në shi, kurse thëllëza ua kishte mbërthyer sytë dhe nuk ua ndante. Unë e zbrita shportën dhe e vura mbi çatinë e ashefit. Sapo ndjeu pranë pëllumbat, thëllëza zuri të rrötullohej nëpër shportë. Ajo i binte shportës nga të katër anët. Bile derdhi edhe kutinë e vogël me ujë. Pëllumbat ngriten qafën dhe Kuqua u çapit rëndë - rëndë drejt shportës. Puthiti sqepin dhe nisi një bisedë, që as unë, as maçoku kobash nuk e kuptionim. Erdhën edhe pëllumbat e tjerë. Ata shikonin thëllëzën. Edhe

ajo herë i afrohej njërit, herë tjetrit. Kështu vazhduan derisa nisi një shi i qetë dhe i lehtë. Mos vallë ai ishte shiu i parë i pranverës, shiu që gëzon barin, zogjtë dhe manushaqet? Nuk e di. Por di këtë, që ishte shiu i parë që binte mbi thëllëzën e mbyllur në shportë. Netët e tjera ai e kishte zënë diku në pyll...

Shiu binte mbi kajsinë e madhe. Pëllumbat laheshin mbi çati. Thëllëza u mblodh në qoshe të shportës. Ajo ua kishte frikën pikave të shiut.

— Mos sëmuret? — tha Mondi. — Shiko sa shumë shi po bie.

E vara përsëri shportën nën ballkon dhe doja të rrija vetëm. Pas pak do të vinin shokët. Dola jashtë te porta. Aty kalonte një vijë e hollë uji, kur binte shi. Ajo zbriste nga kodra rrëzë së cilës e kishim shtëpinë. Aty ne bënim gara, Lëshonim shkrepset e djegura apo kleçka ~~te nolla si vapore dhe iherrenim te ena do te qillte e para. Edhe varka letre lëshonim, por atyre u hyrte vixi~~ shpajt dhe mbyteshin. Vija e ujtit nuk ishte e lundrueshme për varka letre. Fillova të luaja me Mondin pa qejf. Edhe kur u mblodhën të gjithë, unë qëndrova mënjanë. Mendjen e kisha tek thëllëza, sepse unë e kapa nga korija e vogël. Dita po thyhej, dhe muzgu po ndehej si një mace e hirtë. Tani duhej të kthehej edhe babai nga puna. Nuk e di, por a do ta zinte gjumi vallë thëllëzën? Babai im i do shumë zogjtë. Mezi prisja sa të vinte ai. Ndofta gëzimi i tij do të ma zhdukte mërzitjen. Kjo kishë ndodhur mjaft herë. U ula në prag të derës dhe po prisja. Babai vinte nga rruga, dhe unë e shihja vetëm kur dilte nga qoshja e shtëpisë së Kozmait, që ishte ngjitur me tonën. Rruga jonë është e qetë. Unë i dëgjoj hapat e tij nga larg. Ai ecën ngadalë, por rëndë. Koha kalonte. Ende nuk ishte errur, kur erdhi babai. Dukej i lodhur. Unë i dola përpara.

— U lodhe? — i thashë.

— Pak. Si është mamaja?

— Mirë. Ma jep mua torbën.

I mora torbën, dhe, kur po hynim në oborr, zemra më rrahu fort. Ç'do të thoshte kur ta shihte thëllëzën e mbyllur në shportë?

— Kush e kapi? — tha ai me kokën ngritur nga thëllëza.

— Unë, sot në mëngjes, në korije.

— Pse e ke mbyllur kështu, apo të ngordhë?

S'fola. Babai nuk u gjëzua fare. Bile mua m'u duk sikur lodhja u shtua mbi ftyrën e tij. Doli nëna. Ajo i tha të ulej të hante, se gjellën sapo e kishte ngrohur. Babai nuk lëvizi nga vendi. Tha se nuk kishte uri. Mori shkallën dhe hoqi shportën nga ballkoni. Pastaj ma bëri me shenjë ta ndiqja pas. Nëna e pyeti se ç'kishte ndër mend të bënte, por ai doli në rrugë pa u përgjigjur.

— Nxito! — më tha.

Unë mazi e ndiqja. Babai i bëndi hapat më të mëdhenj se zakonishi, sikur kishte frike mas më zinte rata. Kur po ngjishnim kodrën, ai qëndroi dhe u mbush me frymë. Ishte lodhur. Unë u mata t'i thosha që të pushonim pàk, por ai u nis përsëri. Në dorë i tundej si një fener shporta me thëllëzën e bukur, të kuqe. Toka ishte e freskët dhe e lagësht. Nuk lëvizte gjë prej gjëje, përvëç ndonjë zogu të trembur nëpër ferra. Babai ekte mes korijs me akacie. Ai ishte i parruar dhe me siguri që do ta kishte marrë uria. Fletët e vogla të pemëve binin mbi ftyrën e tij. Ai çante gjithmonë me nxitim përmes drurëve dhe barit. Babai nuk e dinte fare se unë e ndiqja. Ai nuk e kishte kthyer asnjëherë kokën prapa. Por sot nuk kisha përsë të fyesha. Unë e ndieja veten të gjuar, që babai nuk e kthente kokën mbrapa. Sepse i druhenja vështrimit të tij. Mjaftonte që thëllëza dukej si një

flakë e kuqe në dorën tërë qime dhe të madhe të babait tim. Kur kapërcyem korijen me akacie, e pyeta:

— Ku po shkojmë?

— Që këtu nuk duken malet, — tha babai pa kthyer kokën.

Dolëm në rrugën që të conte në korijen e vogël, ku kisha kapur thëllëzën. Ajo ishte në një gropë, prandaj aty ishte më errët. Nuk po e dalloja dot vendin ku e kisha kapur në mëngjes thëllëzën.

— Baba, po bëhet natë.

— Edhe pak.

Përsëri unë vrapoja, ndërsa babai nxitonte. Nuk kishte nxituar kurrë kështu. Të paktën, deri atëherë nuk kishim ecur kurrë kështu unë dhe babai im. Aty ku janë dy gurë të mëdhenj të zinx, babai u ndal. Vendosi shportën dhe u ul. Aty u kujtua të ndizte cigaren. Babai im e pi shumë cigaren. E thithi thellë dhe vështroi i merrakosur malin. Pastaj hapi shportën dhe nxori thëllëzën. E mbajti pak në dorë dhe e hodhi përpjetë. Thëllëza përplasi njëherë krahët si e pasigurtë, u ul deri përtokë, por pastaj hovi dhe u zhduk nga gryka e malit.

— U bë natë, — i thashë babait.

— S'ka gjë, — tha ai.

Kudo ishte një qetësi e thellë. Atë e prishi për një çast fluturimi i thëllëzës. Babai e ndoqi me sy fluturimin e saj, pastaj vuri bërrylin mbi gju dhe thithi i menduar cigaren. Unë u afrova më shumë pranë tij.

— Eja të kthehem i në shtëpi, — i thashë.

— Ja, sa të mbaroj cigaren, — më tha.

TELEGRAMI URGJENT

Sa herë që marr shërbimin, rri dhe vështroj malet, që gjithmonë notojnë në një mjergull të lehtë, të bardhë. Kufitarët e vjetër thonë se mjegullat trëgojnë që po vjen pranvera. Nuk e di, po në fshatin tim pranvera vjen me lindjet e kuqe dhe me avujt e fushës. Tani atje duhet të kenë çelur bajmet, kurse këtu as thanat nuk duken se do të çelin së shpejti. Dhe megjithatë, po të mbash vesh mirë do të dëgjosh zhurmat e pranverës. Dëbora rrit nën vete barin dhe lëshon gurgullimën e përrenjve malorë. Edhe erërat e buta të jugut kanë filluar të fryjnë. Unë më tem pas shokëve, dhe ata, kur më shikojnë ashtu të menduar, më ngacmojnë. Unë nuk nxehem kur rrë, sepse i dua shumë. Para se të viaj në postë, nuk merrte mendja se gjithçka do të ishte aq e bukur, aq e thjeshtë dhe aq e madhe. Shikoj si bie dielli mbi majën më të lartë të malit dhe më duket sikur në atë çast të gjithë ata që dua bëjnë të njëjtën gjë. Dhe sepse më duket sikur bisedoj për nënën, për grurin dhe për Vjollcën. Vjollca është vajzë e urtë, jemi rritur bashkë. Kur më përcollën, ajo sikur më vështronte ndryshe nga të tjerët. Më vjen mirë të mendoj kështu, por diçka, brenda meje, më kundërshton dhe atëherë them me vete se më kanë bëë sytë. Ne venim kudo bashkë, tamam si dy shokë.

kë të mirë. Ajo më dërgoi një letër, që nuk ndryshonte aspak nga e shokëve. Më shumë më fliste për grurin. Dhe, kur e mbarova, u inatosa. «Budalla, — i thashë vetes, mbasi e mblodha mendjen, — për çfarë prisje të të shkruante?» Megjithatë, përse ta fsheh, e lexova edhe një dy herë të tjera. Dhe m'u shfaqën arat me grurë. Arat me grurë i kam pérherë pranë, sa herë që marr shërbimin dhe vështroj mjegullat e pranverës, që mbështjellin malet.

Ne kaluam shtegun e ngushtë që të çon thellë pyllit me pisha. Posta jonë mbëti pas. Ktheva kokën dhe dillova tymin që dilte nga kuzhina. Besniku e kishte ndezur mirë furrën. Nata do të ishte e ftohtë dhe, ndofta, edhe me stuhi dëbore. Kështu na tha komandanti para se të niseshim. Ai është një burrë i thinjur që e njeh shumë mirë motin e këtyre viseve. Tërë jetën ia ka kushtuar kufirit. Ne e duam komandantin, sepse e kemi edhe shok, edhe prind. Këtë dashuri po e provoj tani, dhe vërtet është diçka e bukur, kur takon në jetë një njeri që është për ty prind dhe shok. Unë e kam parë shpeshherë komandantin të lumtur, kur i vijnë letra nga kufitarët që kanë kryer së bashku me të shërbimin ushtarak. Dhe në letra ata kujtojnë. Ne kufitarët kemi shumë kujtime.

Era filloj të luante me dëborën, duke e çuar atë lart, sikur të ishte pluhur.

— Dreq! — shau Shpëtimi. — Kjo erë do të forcohet dhe do t'i zhdukë lehtë gjurmët.

Në një kohë të tillë, shërbimi është i vështirë dhe duhet t'i bësh sytë katër. Sepse jo më kot thonë: ujku mjegull do. Kur ishim thellë pyllit, na arriti Petriti. Merrte frymë me zor. Unë fle pranë Petritit dhe u çudita kur e pasë. E lamë me temperaturë.

— Përse erdhe? — e pyeti Shpëtimi.

Ai u mbush mirë me frymë dhe m'i nguli sytë.
— Ti kthehu në postë, kështu urdhëroi komandanti.
— Po përse?
— Do të ta thotë vetë.
— Po në vendin tim kush do ta bëjë shërbimin?
— Unë.
— Ti je sëmurë dhe, me siguri, nuk i ke thënë komandantit.

Shokët na i kishin ngulur sytë dhe nuk flisnin. Era e rrëzoi dëborën me potere nga degët e një pishe të madhe. Po errej.

— Nisu, — më tha prerë Petriti dhe pastaj shtoi:
— Po vonohemi.

Unë mbeta i habitur. Nuk dija si të vaproja. Të mos kthehesha në postë, kjo do të thoshte se nuk e dëgjoja urdhrin e komandantit; por edhe të lija Petritin e sëmurë në një kohë të tillë, më vinte rëndë. Shokët po më humbisnin nga sytë. «Gjersa më hoqi nga shërbimi, duhet të ketë ndonjë punë të ngutshme,» mendova dhe u nisa drejt postës.

Dhoma e komandantit kishte dritë. Trokita e hyra brenda. Prisja me shqetësim ç'do të më thoshte komandanti.

— Ulu, mos rri më këmbë.

Po unë nuk ulesha dot. Mbi xham fishkëllente era, që po e vërtiste dëborën në vorbulla të vrullshme.

— Këtej pranvera nuk vjen aq shpejt, sa nga anët tuaja, — tha komandanti me zérin e tij të qetë. Por unë e nuhata, që ai kishte një brengë.

— Ashtu është, — i thashë, sa për të mos ndenjur pa folur.

Komandanti hoqi vështrimin nga dritarja dhe më tha:

— E di, Agron, përse të thirra: na erdhi një tele-

gram urgjent, ku thuhet se ke nënën shumë sëmurë. Ne vendosëm që ti të shkosh që sonte. Në vendin tënd, u tregua i gatshëm Petriti për të shërbyer.

— Por ai ishte vetë i sëmurë, — gati sa nuk thirra.

— Ashtu?! — u habit komandanti.

— Po.

— Përse s'na the, mor Petrit Tomorri, përse? — foli komandanti, sikur të kishte përpëra Petritin. Pastaj ra në mendime. — Mirë, mirë ti nisu, pa këtë punë e rregullojmë, — shtoi.

— Sikur të shkoj nesër, mbasi të kthehem nga shërbimi.

— Jo, jo, ti do të nisesh që tani.

— Po, ku i dihet, shoku komendant, shiko ç'mot i keq po bën! Ndofta sonte do të na duhet të jemi të gjithë në shërbim.

Komandanti u çua dhe më hodhi krahun në qafë.

— Mos ki fare merak, Agron. Ej, dhe unë e mbaj akoma! O burra, dil në Qafë të Drerit, sa s'kanë kaluar makinat e druve. Hajt, udhë e mbarë dhe e gjetsh shëndoshë! Të fala.

Unë nuk arrita të flisja, se ai doli nga dhoma. Nuk e kisha menduar se do të veja në shtëpi me zemër aq të thyer. Më kishte marrë malli për prindërit, shokët, fu-shën. Kur të më jepnin leje, do të shkoja drejt tyre i përmalluar dhe i lehtë. Kurse sot, nuk doja. Jo se nuk u shqetësova për nënën, por sepse ndieja diçka që më rëndonte thellë dhe nuk më linte të përqëndrohesha. Dola jashtë. Besniku më dha diçka të mbështjellë me letër.

— Ta kesh për rrugë, — më tha.

E putha dhe u nisa drejt Qafës së Drerit. Era nuk më linte të nxitoja, sepse më frynte nga përpëra. Mendjen e kisha sa tek nëna, aq tek shokët. Në Qafë arrita për gjysmë ore. Nuk prita shumë, kur pashë nga larg dri-

tat e një makine. Ajo afrohej ngadalë. I zgjata dorën dhe makina ndaloi.

Shoferi rastisi një burrë i heshtur, tamam si doja vetë. Ai ishte i shqetësuar, se mos zihej rruga nga dëbora. Dhe një gjë e tillë mund të ndodhët nga çasti në çast. Zinxhirët kërcisnin pas parafangove, monotonë. Dhe mua kudo më dilnin para syve shokët dhe nëna. Vettëm kur ramë në fushë, shoferi u kujtua të më pyeste se ku shkoja, I thashë se kisha marrë një telegram urgjent nga shtëpia, ku thuhej se kisha shumë sëmurë nënën.

— Pse s'ma the që kur hipe si e kishe punën? — tha shoferi dhe shtoi shpejtësinë.

Në fushë binte llohë. Kur mbërritëm në Laç, ora kishte shkuar dympëdhjetë.

— Eja fli nga unë, — tha shoferi. — Tani zor se kalon ndonjë makinë. Nesër nisu me trenin e parë.

— Jo, të falem nderit. Ndofta kalon ndonjë.

— Mos e kishe punën ashtu, s'të lija, — tha shoferi.

— Të falem nderit, — i thashë përsëri.

— E shikon atë dritën atje? Ja, ajo dritarja, s'ka tjetër me dritë. Atje e kam shtëpinë. Po më pret gruaja. Sido-qoftë, unë nuk po e mbyll dritën. Po e pe se nuk gjen dot makinë hajde, mos ki fare drojtje.

I shtrëngova dorën dhe e ndoqa me sy, gjersa më humbi. Lloha ishtë e ftohtë dhe të priste fytyrën. Ngrita jakën e kapotës dhe zura të lëvizja për t'u ngrohur. Qyteti flinte. S'pipëtintë gjë prej gjëje. Bëja ç'bëja, dhe ktheja kokën nga dritarja e ndezur e shoferit të panjohur. Dhe sepse lehtësohesha e më dukej sikur nëna ishte bërë më mirë, sikur shokët kryenin shërbimin pa ndonjë shqetësim. Por menjëherë më kujtohej Petriti. Pastaj qetësohesha. Komandanti do ta zëvëndësonë patjetër. Kështu kaloi gati një orë. Dhe kur i humba shpresat për

makinë, dëgjova zhurmën e një motori. Ishte makina e spitalit të Rrëshenit që conte një të sëmurë në Tiranë. Hipa prapa.

— Mirëmbërëma, — i përshëndeta.

Ata m'u përgjigjën me zë të ulët. I sëmuri kishte humbur në kllapi. Ishte një djalë i ri. E shoqëronte i vëllai dhe një infermier.

— Mos u mërzit kështu, or Preng! Ja, mbërritëm në Tiranë dhe Marku ka për t'u shëruar, — tha infermieri.

— Ty të falem nderit, or Ndue, për ç'ka bëre. S'di në do të ta shpérblej dot.

— Mos e thuaj atë fjalë, se më turpëron, or Preng!

— Jo, se ti më je gjendur, vëlla e shkuar vëllait.

I sëmuri sec foli. Infermieri i kapi dorën, i shqetësuar dhe i mati pulsin. Ne pritëm si të ngrirë. Ajo minutë që zgjati për t'i matur pulsin të sëmurit, na u duk e gjatë. Gjatë asaj minute nuk dëgjonim as motorin që uturinte, as frenat, kur makina merrte kthesat me shpejtësi, as shiun që trokiste mbi llamarinën e kabinës, as frymëmarrjen tonë. Na dukej sikur po udhëtonim mbi një heshtje, mbi një boshllék pa ajër. Infermieri ia mbuloi me kujdes dorën të sëmurit dhe lëshoi frymën, që e kishte mbajtur përbrenda.

— Po ti me lejë? — m'u drejtua mua.

S'doja ta rëndoja më tepër atë kabinë të bardhë dhe thashë:

— Po.

— Sa ke pa shkuar në shtëpi?

— Gati një vit.

— Mezi pret, besoj, sa të shkosh në shtëpi? Të ka marrë malli.

Doja t'i thosha se nuk e kisha përfytyruar kështu udhëtimin tim drejt shtëpisë, por heshta. Edhe ata nuk më pyetën më gjatë. Autoambulanca ecte shpejt.

Orët e sahatit të Tiranës shënonin tre. Binte një shi

i hollë dhe i dendur. Për në fshatin tim u nisa me makinën e gazetës. Sa më shumë që i afrohesha shtëpisë, aq më tepër më rritej shqetësimi pér nënën. Dhe më silleshin para syve tërë ato kujtime. Nëna ka pasur një rini të trishtuar. Prindërit i vdiqën nga malarja, dhe ajo mbeti jetime. Nëna ime u bë nënë që fëmijë. Shpesh më tregonte se shkonte nëpër komshinjtë me tas në dorë pér t'u kërkuar një çikë dhallë. Dhe me të i njomte bukën vëllait të vogël. Pastaj vëllai i vetëm iu vra në Luftë. Njerëzit ia fshehën vdekjen e të vëllaït pér gjashtë muaj. Dhe kur e mori vesh, ajo ngriu. Ajo që qante njerëzit, sepse ishte vajtojcë, pér të vëllanë nuk derdhi lotë.

Shiu pushoi dhe në hundë m'u përplas aroma e fushës. Ishte një erë e njojur, e dashur. Isha rritur me atë erë. Hodha sytë, por agimi ende nuk dukej të binte, megjithëse mugëtira e mëngjesit kishte filluar të shtrihej ngadalë mbi fushë. Tek kthesa e madhe zbrita. Që andej fshati im mban ndonja tre çerekë ore, por unë e bëra më shpejt. Ishte ndezur drita në shtëpinë e xha Isufit. Pas saj vijnë shtëpitë e Bariut, të Gëzimit e të Kostës. Fshati është krejt i ri, dhe shtëpitë janë ngritur buzë rru-gës, njëra pas tjetrës. Nga oborri i Vjollcës dolën tërë potere rosat. Kur ishim të vegjël, i kullostim bashkë. Atë do ta takoja me siguri, sepse do të vinte pér nënën. Ndofta... Kisha mbërritur para derës. Ndieja shqetësim dhe mall. Asgjë nuk kishte ndryshuar. Bajamja kishte çelur dhe ngjante me një vorbull dëbore. M'u kujtuan shokët. Nuk guxoja të trokisja. Hoqa rezen dhe hyra në oborr. Të gjithë flinin. Kjo më qetësoi. Trokita lehtë në xhamin e derës së korridorit. Nga dhoma ku flenë prindërit, u dëgjuia kërcitja e krevatit dhe zëri i nënës:

— Kush është?

Ishte ai zë i ngrohtë që më hapte derën sa herë që vonohesha. U mata të flisja, por nuk nxora dot zë. Gjer-

sa ajo po ngrihej për të më hapur derën, do të thosh se ishte shëruar. As vetë nuk e kuptova si trokita më fort.

— Ja, erdha. U, unë e shastisura, që ju bëra të prisni! Erdha, erdha. — Dhe nën dritën e korridorit dallova nënën, ashtu trupvogël dhe të shkathët. Ajo ngriu në vend kur më pa dhe m'u platit në gjoks.

— Sa më ka marrë malli, t'u bëftë kurban mamaja! O, Demir, po çohu, se na erdhi Agroni, çou!

— Si je, mama? — e pyeta.

— Mirë, kurban mamaja, mirë! Po edhe ti mashalla, qenke bërë tamam burrë! Po, ç'më rri në prag, hyr, hyr brenda!

Unë hyra në dhomën e zjarrit, sikur më shtynte njeri nga prapa. Gjithçka më dukejë ëndërr, sikur ajo që po më ndodhët mua, i kishte ndodhur dikujt tjetër, një të panjohuri.

— Po, hë, si je tanë? — e pyeta përsëri nënën.

— Mirë, kurban mamaja, mirë. Po sa shumë që je rritur, mor Agron! — Ajo s'dinte ç'të bënte nga gjëzimi.

Babai më shtrëngoi dorën dhe u ul përballë meje. Nxori paketën e cigareve dhe ma zgjati. Asnjëherë nuk ma kishte zgjatur paketën babai. Unë i thashë se nuk e pija.

— Pa, hë, ç'kemi andej? Si shkon me shërbim, me shokët?

— Mirë, — i thashë.

— Ashtu, t'u bëftë mamaja, të shkosh mirë me shokët, që të mos turpërohesh.

Nxora nga xhepi telegramin. «Me siguri do të jetë bërë gabim», mendova. Por jo. Telegrami ishte i përpiktë dhe me shenjën e kuqe të urgjencës.

— Mama, po ti ke qenë sëmurë? — e pyeta.

— Jo, nuk kam qenë. Hiç mos ki merak për mua, se nuk më gjen gjë!

Ajo po ndizte zjarrin pér tē ngrohur qumështin.

— Po ky telegrami?! — dhe zgjata dorën.

— Na kishte marrë malli, mor bir, prandaj e bëmë,
— tha nëna.

— Asnjëherë nuk e kam ndier veten më ngushtë, sesa kur dëgjova fjalët e saj. Të thuash se më ra tavani në kokë, éshtë pak. M'u duk sikur kisha mashtruar shokët, komandantin dhe vijën e kufirit. Po, po. Ajo tokë që quhet vija e kufirit, nuk éshtë si çdo tokë, ajo éshtë njëri, éshtë nënë, grua, fëmijë, ajo éshtë si damarët që shpërndajnë jetën. Këtë e kisha ndier kur shtrihesha pranë saj gjatë shërbimit. Ja, vija veshin tek ajo dhe dëgjoja hapat e nënës nëpër shtëpi, shokët që ktheheshin nga fusha dhe gjithë ata që i njihja. Prandaj më dukej sikur e kisha mashtruar. Tërë pesha e natës së ftohtë atje larg, në postë, sikur u fut në mendimet e mia. Nëna seç pëshpëriste e lumtur me veten e saj. Kur e pashë ashtu të lumtur, u zbuta.

— Pse e bëtë këtë? — thashë.

— Na kishte marrë malli, mor bir. U bë një vit që s'të kishim parë.

— Mua do tē më jepnin lejë, — i thashë.

— S'ka gjë, hajde, përsëri.

— Jo, — i thashë, — nuk kam pér tē ardhur, sepse do tē më vijë turp.

Nëna ngriti kokën e habitur, kurse babai nuk fliste. Me siguri që ai e kuptonte gjendjen time. Dhe ai lufkonte si unë.

— Të gjithë shokët e mi kanë nëna, por ato nuk dërgojnë telegrame. Edhe ato i zë malli.

— I zë, kurban, i zë...

— T'i s'duhej ta dërgoje, mama. Në vendin tim shkoi Petriti. Kur u nisa, filloi dëborë dhe më duhej tē isha patjetër në shërbim, por komandanti më dha lejë, sepse

dhe ai është prind. Pastaj, koha ishte e keqe. Ti baba më ke thënë se ujku mjegull do, apo jo?

— Po, — mezi foli rëndë babai, pa më parë.

— E pra, kur u nisa unë, ra mjegull.

Nëna e humbi gjëzimin e parë. Ajo vështronte sa nga unë, aq dhe nga babai. Në dhomë po hynin zhurmat e zgjimit, që më shfaqeshin shpesh atje, në postën e largët të kufirit. Dikush përshëndeti me zë të lartë.

— Xha Latifi, — thashë pa e kuptuar.

— Pyet gjithmonë për ty, — tha nëna.

Pastaj nuk foli kush. Ata, prindërit e mi të thjeshtë, i brente pendimi dhe po e vuanin atë me singeritëtin prej fshatari. Nga dritarja pashë si çaheshin retë.

— C'mund të ketë bërë vaki atje? — tha babai.

— Nuk e di. Por unë di se tani duhej të isha atje.

— Duhej, kurban, duhej...

— Po atëherë, moj nënë, c'të shtyu që bëre atë dreq telegram?

— Ku e dija unë, mor bir, se është kaq me zarar!

— Në kufi çdo gjë është me zarar.

— Është, mor bir, është. Që hëngërt kokën e tij dushmani...

— Nuk e ha, se i dhemb. Dhe kur u nisa unë, binte dëborë, ashtu siç e do dushmani, moj nënë. Vendin tim e zuri Petriti, ai shoku që u kam shkruar në letër. Ai ishte edhe pa qejf. Por, edhe po të mos ishte Petriti, do ta zinte dikush tjetër vendin tim.

— Po, ti, mor burrë, që i di më mirë punët, pse s'më re dorës?

Babai nuk foli. E vështroi nënën krejt i pafuqishëm.

— E bëmë këtë, or bir. Po si ta ndreqim?

— Unë po nisem që tani, — u thashë.

— Të çlodheshe pak, nuk hoqë as kapotën nga trupi, — tha nëna me dhembshuri.

— S'ka gjë.

— Të gjithëve t'u kërkosh të falur nga ne. Nejse, po u nis një letër, — tha babai i mërzitur.

Nëna erdhi dhe më puthi. Unë e shtrëngova në gjidhë, s'di pse, tanë e ndjeva që isha në shtëpinë time, ku në çdo cep përgjonte diçka e paharruar. Jashtë kishte ardhur pranvera. E putha nënën, i shtrëngova dorën babaite dhe hodha në shpinë çantën.

— Po nisesh, bir?... — më tha nëna.

— Duhet, nënë.

— Ne as u çmallëm... S'ka gjë, ti je bërë burrë. U, si nuk të dhashë diçka përrugës dhe për shokët!...

— dhe fluturoi në dhomën ngjitur.

Mbeta vetëm me babanë. Ai thithë cigaren dhe dora i dridhej.

— E bëmë ne, o bir. Shokëve u, kërko të falur nga unë. Dreqi e mori, njeriu nuk duhet ta humbasë kaq tepërtoruan. Do të më mbetet peng, ja, mu këtu! — dhe i rame forcë gjoksit të tij disa herë radhazi. Nëna kishte mbushur mësallën me bajame. I futa në çantë. Ata më përcollën deri ku mbaron rruga e gjerë. Kur kalova para shtëpisë së Vjollcës, sesi më rrahu zemra. M'u bë sikur ajo po këndonte. Përse më duket sikur ajo këndon gjithmonë? Doja të ndaloja, t'i thërrisja. Por vazhdova rrugën, jo se do të vonohesha, por se nuk do të dija si t'i përgjigjesha.

— Kthehuni tanë, — u thashë.

Nëna më mori kokën dhe më puthi. Ajo po qante. Babai përsëriste me vete:

— E bëmë tanë, or bir, e bëmë. Ja, peng e kam.

U sula me nxitim drejt xhadesë. Kokën nuk e ktheja dot prapa. Mëngjesi ishte shumë i bukur. Tani shokët po linin shërbimin. Në mbrëmje do të isha pranë tyre. Hapat i hidhja të gjatë, të nxituar. Kur kisha bërë një co-

pë rrugë, ndala. Prindërit e mi s'kishin luajtur nga vendi. Ato dy silueta të largëta ishin dy njerëzit më të shtrenjtë për mua. Çova dorën lart dhe i përshëndeta. Nuk e di në e panë dorën time, se mosha bën të sajën, por ata do të qëndronin aty gjatë. I përshëndeta edhe një herë dhe u nisa. Fusha po zgohej, dhe mëngjesi ishte i bukur, i lehtë, i qetë...

NJERIU MË I FORTË

Djali nuk e dinte ku ndodheshin. Ai shikonte nga malet ku sapo kishtë qenë dhe kujtonte rrugën. Gjithmonë, në këto çaste mendonte se a do t'i binte rasti të vente edhe një herë andej. Malet ishin të zhveshura, vetëm nga lindja ato ishin tërë gjelbërim. Nga malet e gjelbër zbriste një lumë i vogël, i cili bashkohej me lumenin e madh, që djali e njihte shumë mirë. Kishin qëndruar aty ku bashkohej Devolli me Tomorricën. Djali shikonte bashkimin e tyre dhe përpinqej të dallonte në ujin e lumenit se cila masë kishte rrjedhur nga lumi i vogël, nga malet, dhe cila kishte ardhur deri aty nga lumi i madh. Por uji rrëshqiste pa zhurmë rrëzë brigjeve. Dhe as vetë nuk po e kuptonte se ç'ishte ajo ndjenjë që e kishte pushtuar. Ndofta djali po provonte diçka të rrallë, diçka që provon vetëm kur ndodhesh pranë bashkimit të dy lumenjve në një të vetëm, më të madh, më hijerëndë, më të sigurtë në rrjedhjen e tij. Ai rrinte si i shastisur nga tërë ajo hapësirë që shtrihej para tij.

Nga xhadeja zbriti poshtë një djalë i ri me këmishë të bardhë. Ai u përshëndet me babanë dhe u ul pranë tij. Djali e vështroi, por pastaj përsëri e tërhoqi hapësira e asaj dite gushti.

— Sot nuk ka pasur fare lëvizje, — tha djali me kë-nishë të bardhë.

— Që kur ke dalë për makinë? — e pyeti Petroja.

— Kam një orë.

— Çfarë punon?

— Ndihmësmjek.

Djalit i dukej sikur e kishte dëgjuar edhe herë të tjera këtë bisedë dhe sikur të gjithë ata që kishin udhë-tuar me babanë, kishin qenë ndihmësmjekë. Bile atij iu duk sikur kjo bisedë ishte bërë në të njëjtin vend, pranë bashkimit të dy lumenjve, nën diellin përvëlues të gu-shtit.

— Sa kohë ke që punon në këto anë? — pyeti Pe-troja.

— Viti i parë, — tha ndihmësmjeku.

Mbas kësaj Petroja nuk kishte më pyetje të tjera. Të dy do të mendonin për gjëra të ndryshme. Nga një arë e korruar me grurë po këndonin gjinkallat. Papritur mbi sipërfaqen e lumit fryu një erë e lehtë. Të tre ngritën kokën lart. Kishin dalë disa re të holla, të bardha.

— Do të bjerë shi, — tha ndihmësmjeku.

Petroja u hodhi edhe një herë sytë reve të holla dhe sikur nuk iu mbush mendja që ato të sillnin shi. Veshi këpucët dhe tha:

— Hajde nisemi.

Ndihmësmjeku i shkoi pas, kurse djali nuk donte të largohej. Lumi sikur ia kishte mpirë tërë gjymtyrët dhe sikur e kishte futur në një gjendje dremitjeje. Petroja i thirri nga makina, dhe ai u shkëput tërë dembellëk. Nuk i ndahej pamja e bashkimit të lumenjve.

Petroja mendoi për ndihmësmjekun si për një pa-sagjer të heshtur. Vapa po shtrëngonte akoma më tepër. Ndihmësmjeku fshinte djersët dhe buzëqeshte me vete. Kur e vuri re këtë gjë, Petroja mblodhi buzët, sikur don-

te tē thoshte se ç'njerëz tē çuditshëm ka nē këtë botë. Gjatë jetës së gjatë si shofer, ai kishte hasur njerëz nga më tē ndryshmit. Dhe përsëri thoshte se asnjerë nuk i ngjiste tjetrit. Edhe ky ndihmësmjek i ri fshati, me këpu-cët tërë pluhur dhe me pantallona doku, kishte diçka që i têrhiqte vëmendjen. Dukej djalë i shtruar dhe i ur-të. Në një gropë ai frenoi, dhe ndihmësmjeku sa nuk për-poqi kokën pas xhamit.

— Të flihet? — tha Petroja.

— Kam dy net pa fjetur, — tha ndihmësmjeku i turpëruar.

— Kaq shumë punë keni?

— Jo, ashtu ishte një rast, dhe nuk mund tē flija.

— Kështu e ka zanati juaj.

Ndihmësmjeku u kënaq dhe iu largua fare gjumi. Tani ai nuk mund tē rrinte pa folur. Nxori paketën e cigareve dhe i zgjati një Petros. Petroja e mori dhe, kur ndihmësmjeku ndezi cigaren, e kuptoi se ai sapo e kishte filluar duhanin. E kuptoi nga lëvizja e ngathët e duar-ve dhe nga afrimi i shkrepse pranë cigares.

— Shpejt e ke nisur këtë tē flamosur duhan, — tha.

— Epo, ç't'i bësh, — tha përsëri ndihmësmjeku, duke u skuqur.

— Lëre dreqin pa e mësuar, se më vonë e ke zor.

Por ndihmësmjeku ishte nga ata djem që, sapo fillojnë punën, duan tē burrërohen menjëherë dhe fillojnë duhanin. Petroja nxehet me ata djem që mendonin se ishin burra, vetëm se pinin duhan. Por me ndihmësmjekun nuk po nxehet. Ai ishte një djalë i shtruar dhe i urtë, që kishte dy net pa fjetur dhe që po shkonte në shtëpi për tē parë prindërit. Ishte i lodhur, por gjumin sikur ia kishte larguar njeri nga sytë.

— Andej nga punoj unë është freskët, — tha ai.

Petroja i njinte mirë ato vende. Edhe fshatin e njii-

hte. Ishte rrëzë rrugës, midis pyllit dhe lomit. Qe një fshat i bukur dhe me ujë të ftohtë prapa Tomorrit.

— Përse nuk ke fjetur? — e pyeti, se e ndjeu që ndihmësmjeku atë priste.

Djaloshi u mendua një çast, thithi cigaren dhe vështroi shoferin, sikur të sigurohej nëse tjetri do ta dëgjon te me vëmendje apo jo. Dhe nuk nisi të fliste, por të tregonte.

— Pardje isha vetëm në spital. Mjeku kishte shkuar në qytet për një mbledhje. Unë vizitova të sëmurët dhe shkova të shtrihem në dhomën time. Doja të lexoja diçka, por nuk përqendrohesha dot. Sikur më shponte diçka. Hapa dritaren dhe pasqë andej nga Tomorri. E di sa i bukur duket Tomorri kur ka hënë?... Pylli fëshférinte lehtë, dhe unë dëgjoja si zbriste tërë potere uji te mulliri i fshatit.

Ndihmësmjeku pushoi papritur. Ju duk sikur kishte folur me veten e kishte thënë budallallëqe. E ç'i duhej shin këtij shoferi hëna dhe pylli? Por shoferi po e dëgjonte me vëmendje dhe, sa po pushoi ndihmësmjeku, i tha:

— Lëre mos e nga! Edhe mua më qan zemra për të fjetur në pyll.

Ndihmësmjeku mori zemër nga kjo gjë dhe vazhdoi të tregonte.

— Po rrija në dritare, kur shoh të vijnë dy fshatarë. Nën dritën e hënës nuk i dallova mirë. Po më ngjanë si të njobur. Kur u afroan, njoba xha Selmanin me të birin. Ata rrinë në një fshat andej nga Qafa e Gjarprit. U bëra zë, dhe xha Selmani erdhë pranë, kurse i biri nuk lëvizi nga vendi. Ç'kemi? u them. Xha Selmani pa njëherë rrëth e rrötull dhe më pyeti: «Është doktori»? Jo, i them. «Mos, bre, se na more në qafë!» Unë u çudita. Pse, mos ishte faji im që doktori kishte shkuar në qytet?

Mor po si e keni hallin? — i pyes. «Lëre, — tha xha Selmani, — mos na e hap më tepër plagën». Vendosa të mos i pyes më dhe prita. Xha Selmani vështroi nga i biri, sikur t'i kërkonte ndihmë, por ai ishte më i hutuar se i ati. S'm'u durua dhe e pyeta përsëri se si e kishin punën. Të them të drejtën, edhe m'u prish pak gjaku, se pse e shikoja që ata nuk kishin fare besim tek unë.

Shoferi qeshi. Djalit të shoferit, që në fillim nuk e kishte dëgjuar me vëmendje dhe mendonte akoma për bashkimin e dy lumenjve, po i pëlqente ndihmësmjeku. Bile po i dukej sikur e kishte shok dhe e shikoi me inat babanë kur ky qeshi.

— Më në fund, xha Selmani më tha se kishte keq të renë, — vazhdoi ndihmësmjeku. — I biri u kthyte pak anash kur dëgjoi të atin. Unë, ngaqë isha i prekur në sedër, bëra gabimin e parë. Nuk e pyeta se ç'kishte, por mora gjilpërat, futa disa ilaçe në çantë, dhe u nisëm. Në spital kisha vetëm dy të shtruar. Por edhe ata nuk kishin ndonjë gjë për t'u shqetësuar. Ecëm nëpër pyll më shumë se tri orë. Ata e njihnin rrugën me pëllëmbë. Mua më dukej sikur do të humbisnim, kur ata më nxirrin nëpër shtigje të holla. Edhe po të mos kishte hënë, ata do t'i gjenin shtigjet, më të shkurtra. Nuk shkëmbyem asnje fjalë. Rrugës vetëm mendoja për çuditë që do të bëja. Më parë nuk e dija se kisha aq sedër. Kur hymë në fshat, hëna kishte perënduar. Po mugullonte. Diku, andej nga shtëpia e xha Selmanit, kishte dritë, dhe unë pashë hijet e njerëzve që lëviznin nëpër oborr. Fshati flinte i qetë. As qentë nuk lehnin. Kaluam nëpër fshat pa zhurmë, dhe, apo hymë në shtëpi, të gjithë njerëzit sikur ngrinë. Edhe këtu hasa po atë vështrim që më hodhi xha Selmani. «Dreq o punë, — thashë me vete, — asnjërit nuk ia mbushkam syrin». Por isha i sigurtë se do t'i lija me gojë hapur. Kur iu afrova të sëmurës, ngriva i téri dhe

qind për qind më ka ikur gjaku nga fytyra. E reja e xha Selmanit rënkonte nën dhimbjet e lindjes. Aty e kuptova gabimin tim që nuk i pyeta. Kishim thirrur maminë, dhe gjithçka do të shkonte përbukuri. Nga gjinekologjia nuk kam shumë haber. Kam lexuar leksionet e mjekut dhe e kam ndihmuar nja dy herë maminë. Por të têrhiqesha, ishte shumë keq, si për nusen e re, ashtu edhe për têrë ata njerëz. Têrheqja ime ishte, mor po thuaje si të duash, vdekje. Mblodha veten, largova burrat, lashë vetëm dy gra dhe fillova të shtrydh trutë. Gruaja ishte keq. Shiko, nuk ta them për t'u mburrur, ë? Veçse ajo ishte grua e fortë. Po të mos ishte aq e fortë, zor se do ta kisha situatën në dorë. E di sa më dha zemër burrëria e saj, sa nuk e merr dot me mend! E, sa të forta janë gratë!

Petroja qeshi. Ndihmësmjeku kishte një fytyrë të njomë, me lëkurë në ngjyrë të kuqe, të shëndetshme. Flökët i kishte të ashpra dhe i rrinin përpjetë, si gjemba iriqi. Në krehjen e tyre ndihej mundimi për t'i ulur e zbutur.

— E ke provuar të marrësh zemër nga një grua?

Petroja hapi sytë i çuditur dhe ngriu.

— Jo, — tha ai, — nuk kam parë kurrë grua duke lindur dhe as dua të shoh.

— Nuk e kam fjalën për rastin tim, — e shfajësoi ndihmësmjeku, — por në përgjithësi.

— Të them të drejtën, nuk ia kam vënë veshin, por s'besoj.

— Nejse, s'ka rëndësi. Kur e mbledhka njeriu veten, çdo gjë i shkon fjollë. Ajo e kishte lindjen e tretë. Ishte mbuluar têrë djersë dhe nuk kishte forcë as të rënkonte, as të shtërongohej. Të birin e xha Selmanit e nisa të thërriste maminë, kurse vetë fillova të ndihmoj gruan për

të lindur. As kisha haber sa ishte ora. Dritën nuk e fikën nga hutimi, sepse dielli hynte në dhomë. Kur pashë fytyrën e gruas, ajo ishte e deformuar.

— Jo, mor? — tha Petroja.

— Posi, vetëm ajo e dinte ç'hiqte. Ne, sado që ta marrim me mend, aha, zor se e përfytyrojmë dot.

— Edhe mua kështu më ka thënë doktor Riku.

— Kush?

— Doktor Riku.

— Nuk e njoh. Mallkova sedrën time dhe shtrën-gova dhëmbët. U përpoqa ta sillja fëmijën në pozicionin normal. Kishte shumë rrezik që të lindte duke nxjerrë këmbët.

— Është e vërtetë që ata që nxjerrin këmbët, bëhen të prapë? — pyeti Petroja.

— Nuk e kam lexuar në ndonjë libër këtë gjë. Por fëmija që nuk është në pozicion normal para lindjes, rrezikon si nënën, ashtu edhe veten. Dhe unë nuk e dija se kush ishte më tepër në rrezik: fëmija apo nëna. Gruaja e kuptoi menjëherë gjendjen time. Mua më erdhi keq përtë dhe doja të shqyeja veten me dhëmbë. Në profesionin tonë çdo pakujdesi është e tmerrshme. Dhe në ato çaste ajo grua m'u bë aq e afërme, sa nuk doja të besoja se ishte keq. I fshiva djersën dhe e vështrova në sy. Fytyra e saj po e largonte ngadalë dhimbjen dhe erdhi duke u qetësuar. Në oborr kishin ngritur folenë disa verdashë, që këndonin tërë potere. Ajo ktheu kokën nga dritarja. Dielli binte mbi degët e një arre të madhe, e cila i kthen-te rrezet në qindra diej të tjerë, të vegjël, si pika vese. Gruaja, më ka thënë doktori, e do jetën më shumë se kurrë, kur lind. Dhe në sytë e asaj nëne unë e pashë këtë gjë fare qartë. Po të kisha parë tmerr në sytë e saj, nuk do të dija si të vaproja, do të më priteshin duart. Por

gruaja u kthye nga unë, u mundua të vërë buzën në gaz dhe më tha me një zë të mekur: «Mos u mërzit, kështu e kanë këto punë». Buzët i ishin çarë. Nuk guxoja të flisja. U hutova dhe ma pret mendja se duhet të jem bërë si guak. «Tani jam mirë», tha gruaja. Por isha i sigurtë se më gënjenjtë. Dhimbjet e saj nuk ka burrë që t'i përshkruajë. Por pikërisht ishin dhimbjet ato që i jepnin një forcë të çuditishme. I fshiva përsëri djersët nga balli. Ajo ishte për mua si ai dielli që shpërndahej nëpër fletët e arrës së madhe. Shtrëngoi nofullat, mblodhi gjithë muskulaturën e trupit. Dhe mua m'u duk sikur më tha përsëri me atë buzëqeshjen e drojtur: «Mos u huto, kështu e kanë këto punë». Mblodha veten dhe fillova ta ndihmoj. Sikur e vura në vijë punën. Gruaja s'kishte pikë fuqie. E lashë të qetësohej pak dhe i thashë të shtrëngohen për herë të fundit. Dhe ai ishte shtrëngimi më i rrezikshëm për të tre ne. Nuk e di, po isha aq i sigurtë, sa s'tregohet. Apo më duket tani, hë? Kur lindi fëmija, më dridhej trupi. Isha si i dehur. Doja të çlodhesha dhe të mos mendoja fare. Por u qetësova vetëm kur gruaja ra në gjumë dhe në dhomë hyri mamia. Atëherë dola jashtë tek burrat, piva pak raki të zier dy herë dhe dëgjoja bisedat e tyre. Nuk flisja. Sikur nuk kishte lezet të flisja. Xha Selmani më mbushi edhe një gotë. E ktheva me një frymë. M'u morën mendtë, sepse s'kisha ngrënë.

— Nuk e ke pasur nga të pangrënët, — tha Petroja.

— Po nga se? — e pyeti me naivitet ndihmësmjeku.

Petros i erdhi keq t'i thoshte se ai nuk kishte pirë ndonjëherë raki, prandaj u mendua.

— Kur lodhem, dy gota raki më çmpijnë, — tha ai.

Ndihmësmjeku vështroi rrugën dhe ndjeu t'i rëndoheshin qepallat.

«Ndofta kam qenë i dehur pa pirë raki», mendoi.

Dita po thyhej. Djali i shoferit vetëm kishte dëgjuar me vëmendje dhe nuk kishte lëvizur fare. Kur ata të dy, Petroja me ndihmësmjekun, nuk e prisnin, ai foli:

— Po të mos ishe ti, ajo gruaja do të kishte vdekur?

— Jo, jo. Ishte grua e fortë ajo, nuk vdiste kollaj, por fëmija... — tha ndihmësmjeku dhe u mbështet mirë në sedile. E zuri gjumi.

Djali e vështroi me zili ndihmësmjekun. Ai i dukej njeriu më i fortë.

P O R T O K A L L I

Plaku rrinte në verandën e ngushtë të klubit të Lukovës dhe vështronte detin. Në tavolinë ishin dy filxhanë kafeje, që i kishte pirë tek priste ndonjë makinë që shkonte për në Vlorë. Dielli po bëhej gati të perëndonte, dhe kushdo tjetër do të shqetësohej nga qetësia e rru-gës, kurse plaku nuk e prishte qejfin. Bile ai dukej sikur sapo ishte ulur aty dhe po çlodhej para se të kthehej në shtëpi. Deti ishte i qetë, dhe ajri i mbushur me aromën e luleve të portokallit. Ullinjtë lëviznin gjethet e tyre të vogla si gjuhë, që flisnin e flisnin papushim. Plaku nuk ngopej së pari detin dhe shpesh ndiente sikur ai ishte poshtë murit të verandës. Ai e ndiente detin gjithmonë pranë, sa dilte majë Llogorasë e deri në Lukovë. Në vitet e tij deti kishte vendin më të madh. Dhe plaku ishte i lumtur. Ai hodhi sytë nga rruga. Edhe ajo sikur po binte në dremitje. Por plaku nuk e prishi gjakun. Nuk ishte hera e parë që nata e zinte larg shtëpisë.

— Si u ngryse? — e pyeti një fshatar.

— Mirë, të falem nderit, — iu përgjigj plaku. — Do të pish një kafe?

— Jo, se më bën dëm. Do ti një?

— Edhe unë kam pirë boll. Pranvera ka ardhur e mbarë sivjet.

— Po, — tha fshatari. — S'ma merr mendja të ketë vend më të bekuar se ky yni!

Plaku e vështroi fshatarin në sy dhe tundi kokën. Dielli po ulej mbi det dhe po e përskuqte. Dukej sikur dikush po derdhte portokalle të shartuara me shegë mbi det.

— Nga je, zotrote? — pyeti fshatari.

— Nga Vlora.

— Ke njeri tëndin këtej?

— Jo, — tha plaku. — Erdha për të mbjellë një portokall. E nxora në gërmadhat e Vunoit. Këtë tjetrin do ta mbjell në shtëpi. Kam qenë vetë atëherë kur u dogj Vunoi. U dogjën edhe portokajtë. Po ja ata mbinë prapë.

— Vetëm për këtë more gjithë atë rrugë, or i uruar?...

— E pse çuditesh, zotrote! Dhe s'kam për të vdekur, pa ngrënë portokallet që mbolla vetë. Ja, këtu do të jemi, — foli plaku nie inat.

Ai ishte shtatëdhjetë e tre vjeç. Ishte i dobët dhe krejt i thinjur. Thinjat e bardha ngjisnin me dëborën e Çikës, kur bie dielli i mëngjesit. Kamarieri mblodhi filxhanët bosh.

— Qenke ters, — i tha plakut me të qeshur. — Vetëm sot s'lëvizka makinë.

Plaku nuk ia vari fare. Kamarieri mendoi se nuk e dëgjoi dhe u mat ta përsëiste, kur plaku ngriti kokën dhe ia nguli sytë.

— Mos u mërzit për mua! Po s'më mbajte ti sonte, nisem më këmbë deri në Piqeras. Aty do të trokas në portën e parë që do të has.

— S'e kisha aty, — tha kamarieri, — po me tërë mend sonte as që ka shenjë për ndonjë makinë.

Muzgu po binte ngadalë, dhe në breg deti po formon-

te një vijë të bardhë nga valët. Edhe ajri, i mbushur me erën e luleve të portokalleve, po ftohej.

- Eja nga unë, — tha fshatari. — Nesër dil herët.
- Jo, — tha plaku, — do të pres edhe pak. S'i dihet.
- Po dal këtej pas ndonjë ore, — tha fshatari.
- Të falem nderit, — tha plaku.

Ai mbeti përsëri vetëm në verandën e klubit. Pak nga pak çdo gjë po fshihej nën errësirën e pranverës joniante. Plaku ndjeu se ishte lodhur dhe po i vinte gjumë. Portokalli i vogël, që plaku e kish vënë në këmbë, lëkundte lehtë gjethet, që kishin filluar të drobiteshin. Plaku i preku lehtë dhe foli:

— Ka pér të marrë dhe ty malli pér këtë erë, prandaj mos u mërzit. Kjo erë ta nxori kokën nga gërmadhat dhe nga hiri. Kjo erë nuk të plak. Edhe gurin e bën të dridhet, e jo ty, që je si njeri. Në Vlorë do të jemi të dy. Kemi pér të bërë muhabet, sa ta mërzitim njëri-tjetrin. Apo jo?

Fshati ndezi dritat. Edhe fshatrat e tjerë. Yjet po zbrisnin drejt detit të lanin sytë. Lulet e bardha të portokalleve feksin si guralecë.

«Ku është toka, ku është qielli?» — tha plaku.

Nga larg u shkëput një këngë e lashtë himariote. Kënga herë afrohej, herë largohej, si të ishte frymëmarrja e asaj nate. Edhe hëna doli, e plotë, e kuqe. Mali i Vëtëtimës lëshoi hijen e tij. Plaku i kishte mbërthyer sytë andej nga ishte deti. Me siguri që ai e shihte atë, ashtu siç e kishte parë kur ishte ditë. I erdhi keq që deti ishte i qetë dhe nuk bënte zhurmë. Do të donte të dëgjonte përplasjen e valëve pas brigjeve, sepse do t'i dukej sikur e kishte poshtë, te këmbët.

— Edhe sa do të presim? — tha plaku. — Shpejt është akoma. E ku të zë gjumi në një natë si kjo! Pastaj edhe ty do të marrë malli. Apo jo?

Plaku shihte portokallin dhe e ndiente si diçka të aférme, që ia kuptonte fare mirë mendimet. Duke parë fletët e drobitura, plakut iu duk sikur portokallin e zuri malli pér shokët. Ai e përfytyroi atë rrënje në kopshatin e vogël, atje në Vlorë, duke hedhur shtat e duke fëshfëritur. Më vonë ai do të lëshonte filiza të njoma, dhe plaku në çdo filiz shihte vitet e tij të rinuara. Jo, ai s'kishte pér të vdekur, pa mbjellë filizat e portokallit në Lukovë. Atëherë portokallet do të ishin rritur shumë, si një pyll i madh, në këmbët e maleve Akro-keraune. Ai s'kishte ndër mend të vdiste. Pastaj, plaku mendonte pér vdekjen me mospërfillje. Edhe po të vdiste, s'bëhej qameti. Do të vinin djemtë me nipërit. Ej, sa shumë do të mbillnin ata! Plaku kishte vendosur të mbillte në Lukovë një rrënje portokalli nga Vunoi, sikur të bëhej qameti. Dhe e mbolli. Edhe filizat e tjerë do të rriteshin. Në rritjen e tyre plaku shikonte jetën e vet.

Papritur plaku filloi të këndonte këngën pér Kanan Mazen. Ishte kënga më e dashur pér të. Nën atë këngë i kishte rritur djemtë.

Kanan Mazeja nga Shkoza
Me një nofull copa - copa,
Kanan ç't'u prish bukuria,
Le të rrojë Shqipëria.

Edhe nën portokallin e Vunoit do ta këndonte. Do të rrinte atje në Vlorë, do të shikonte detin e do të këndonte. Me këngë bisedonte plaku me vitet që kishte kaluar dhe me ato që do të vinin. Dikush mund të thosh se kjo ishte shenjë pleqërie, por ai nuk e pranonte. Ai s'ishte plak. Dhe iu kujtua kapedan Sali Vranishti. Plaku qeshi.

Lule kapedan Vranishti,
Sa rrojte të punoi gishti.

Ai e dinte prej kohësh se mund të plakej, ashtu siç e dinte se mund të mbetej pérherë i ri. Shumë shokë të tij kishin mbetur pérherë të rinj. Dhe iu kujtuan plakut të rënët. Ata flinin këtë natë së bashku me këngët. Edhe kur vjen pranvera, ata bëhen më të rinj; edhe kur vjen vjeshta, bëhen më të rinj; edhe kur vjen dimri, bëhen më të rinj. Në çdo frysma marrje të tokës, në çdo rilindje të saj, ai shihte të rënët. Dhe niste me ta bisëdën e gjatë të viteve.

Plaku rrinte atje në verandë dhe e kishte humbur fare ndjenjën e kohës. Në rrugë s'lëvizte njeri. Ishte aq qetë dhe nata kishte aq dritë, sa mund të kenë vetëm netët e Jonit. Dhe përsëri dritat iu dukën plakut si tufë yjesh që po zbrisnin të lanin sytë në det. Dhe përsëri lulet e bardha të portokalleve iu dukën si zile të argjendta, që binin gëzueshëm pér të lajmëruar pranverën. Plaku dëgjonte tringëllimën e tyre, dhe sytë po i mbylleshin ngadalë. Ai dremiti pak. Dhe pa një ëndërr. Kur çeli sytë, nuk e mbante mend ëndrrën. Ai u përpooq ta kujtonte, po nuk mundi. Dhe u mërzit.

— S'duhej ta harroja, — tha plaku. — Asgjë nuk duhet harruar.

Plaku po ndiente të ftohtë. U çua dhe lëvizi nëpër verandë. Nga poshtë fshatit ngjitej një njeri. Ai iu afroa plakut dhe i tha:

— Më dërgoi babai, të të marr në shtëpi.

— I biri i kujt je ti?

— I Petraq Ristos.

Plaku nuk kishte ndonjë të njojur me këtë emër.

— Shkojmë, — tha djali. — Babai po të pret. Tani

s'kalon më makinë. Nesër po të përcjellim me makinën e fermës.

— Sikur të rrinim edhe ca, mër djalë.

— Kot të rrimë. Pastaj, edhe të ftohtët po shtohet.

Plaku e ndjeu se ishte e kotë ta kundërshtonte. Edhe atij i pëlqente të flinte në Lukovë. Në jetën e tij të gjatë kishte takuar shumë njerëz të mirë. Dhe gjëzimi i takimit me ta kishte mbetur i pandryshuar. Prandaj, shpesh plakut i ngatërröheshin vitet e moshës dhe i dukej sikur ato orë i kishte jetuar vite dhe vite të shkuara.

— Çfarë pune bën babai? — pyeti plaku.

— Ç'të duash. I zë dora gjithçka.

— I ke ngjarë ndopak edhe ti?

Djali qeshi dhe nuk iu përgjigj menjëherë. Era e luleve të portokalleve po bëhej më e lehtë. Në mes të detit hëna formoi një rrëth të bardhë dhe i theksoi akoma më tepër rrymat, që ngjanin si damarë të ngatërruar. Maled Akrokeraune u bënë të lehtë, si një dekor teatri që lëkundet nga era. Plaku sikur u magjeps dhe nuk hidhet dot hapin e parë, që do ta ndante nga ajo natë. Dhe për herë të parë mendoi se ishte plak dhe, ndofta, nuk do t'i mjaftonte mosha ta jetonte prapë atë natë.

— Eja, — tha djali. — Mund të ftohesh.

Plaku u ul dhe mori portokallin e njomë. Rrënjën, së bashku me dheun, e kishte mbështjellë me një qese nailoni. Portokalli i përkëdheli faqet. Fletët e lëmuara dhe të forta i kujtuan doçkat e mbesës së vogël. «Do të jenë bërë merak», — mendoi plaku.

— Shtëpia jonë është ajo atje, mes ullinjve, — tha djali.

Sapo filluan të zbrisnin, nga rruga e Sarandës u dukën dritat e një makine. Plaku ndaloj mes xhadesë.

— S'ke përsë të nisesh tani, — tha djali.

Makina qëndroi. Ishte një mikrobus. Shoferi zgjati kokën.

— A ke një vend? — pyeti plaku.

Nga mikrobusi zgjatën kokën dy vajza dhe seç thanë për hënën e pasqyruar në det.

— Mund të flemë në Himarë, — tha shoferi

— S'ka gjë.

— Mirë, hajde hipni.

— Kot që nisesh, — tha djali. — Babai do të mëritet.

— I bëj të fala, — tha plaku, — dhe të më ndjeni se ju vura në siklet.

— Ç'është ajo! Kur të vish herë tjetër, të ktheheshtek ne.

— Të falem nderit, — tha plaku. — Do të vij së bashku me nipin dhe do të rri një natë. Edhe ju, kur të vini në Vlorë, të më ktheheni. Pyesni ku e ka shtëpinë Isuf Picari dhe do t'jua tregojnë.

Shoferi i dha gaz makinës.

— Rri me shëndet, — tha plaku dhe përqafoi djalin.

— Udhën e mbarë, xha Isuf, dhe u bëj të fala atyre nga shtëpia.

Plaku zuri vend dhe portokallin e mbante në prehër, si një fëmijë.

Mikrobusi ecte me shpejtësi, dhe plaku e kyçi gojën. Iu përgjigj pyetjeve të zakonshme dhe u zhyt në mendime. Pasagjerët filluan të këndonin. Kishin qenë ekskursion në Sarandë dhe kishin vendosur të udhëtonin për tërë natën gjer në Vlorë. Plaku nuk i dëgjonte fare. Ai ndiente një farë mërzie apo trishtimi që zakonisht të kap kur ndahesh nga njerëz të mirë, me të cilët ta ka ënda të rrish sa më gjatë. Plaku tani donte të kthehej sa më parë në shtëpi dhe të ndante mbresat e udhëtitimit me shokët dhe të afërmit. Portokalli, duke e prekur në fytyrë, e

shkëpuste shpesh nga mëndimet. «Edhe ty nuk të pri-tet, sa të të mbjell. Mos u mërzi, xhan, mos u mërzi!»

Kaluan Piqerasin. Vetëm disa drita ishin ndezur. Fshati po flinte.

— Nga ky fshat ishte Vasil Laçi. — tha një burrë. — Kur do ta pushkatonin, kërkoi një krehër. » «Përse e do?» i thanë. «Që të vdes i bukur», u tha.

— Kush rritet pranë bukurisë, vdes i bukur, — tha njëra nga vajzat.

— Perandori ishte i shkurtër dhe i shëmtuar. Kur e kam parë në një fotografi, hipur mbi veturë, më ngjau me një sorrë të lagur nga shiu. Ja, mendoje vetë.

— E di, Zamira, Vasil Laçi e kishte futur revolen në një tufë lulesh. Tani më duket sikur atë shkurton e shëmtuar ë qëlluan portokallet tona, këto male dhe kjo natë e pastër plot dritë.

Vajzat heshtën një copë herë dhe ranë në mendime.

— Zamira, kur do të vijmë përsëri këtu?

— Ku e di unë, moj Liri. E di si më duket, sikur kam kohë që udhëtoj pranë detit dhe sikur ky udhëtim është endërr. Hë, të duket edhe ty kështu?

— Nuk e di. S'ma merr mendja se mund ta përcak-tojë dot njeri se çfarë ndien kur je pranë Jonit.

— Shiko, — tha Zamira.

Në faqen e malit dritat e Kudhësit dukeshin si ujë-vara të bardha apo si konstelacione yjesh. Vajzat mbë-shtetën faqen mbi xham dhe nuk ia ndanë sytë Kudhësit derisa ai mbeti pas. Nga maja e Malit të Vetëtimës dukej Himara. Edhe një konstelacion i ri yjesh pranë detit Jon. Gjiu i bukur dukej si një zemër e gjerë dhe e kthjellët. Deti ishte i qetë. Rruga zbriste, dhe mikrobusi hidhej mbi gropat e vogla si një guaskë gjigante, që shpejton të futet në ujë. Shoferi fërshëllente një këngë të re të grupit të Pilurit. Plakut i zuri veshi vetëm fjalën

«e bardhë». Dhe vajzat këndonin. Ishte kënga e bejkës së bardhë. Epiteti «i bardhë» ishte i pranishëm në shumë këngë, ashtu si fjala «lule». Dukej sikur epitetet dilnin nga gjiu i detit dhe ngjiteshin malit karvanë - karvanë. Ishte një karvan i bukur, i lehtë, që përshkonte rrugë të gjata drejt njerëzve.

Liria, që ishte ulur pranë plakut, po i përshpëriste diçka në vesh shoqes së saj.

— Si e ke emrin? — e pyeti plaku.

— Liri.

— E gëzofsh! — i tha plaku dhe nuk dinte ç'të thosh, se u prek.

— Po ti, gjysh, ke ndonjë hall, që u nise tani natën?

— Jo, moj bijë, jo. Po edhe mua më pëlqen të eci natën.

Vajza i foli shoqes diçka në vesh dhe të dyja ia ngulën sytë plakut. Plaku ktheu kokën. Rruga i ishte afruar detit. Dikush mbështeti kokën në sedile dhe fjeti. Kur mbërritën në Himarë, restoranti nuk ishte mbyllur. Zbritëtëtëtë hanin darkë. Plaku nuk lëvizi nga vendi.

— Zbrit dhe ti, — i tha shoferi.

— Hajde ulu me ne, — i thanë vajzat.

— S'ha darkë, — tha plaku.

— Po mirë, mirë, pse të rrish vetëm?

Dhe plaku doli, duke marrë me vete portokallin. Në restorant piu vetëm një çaj. Plaku vuri re se si vajzat përsëri përshpëritën midis tyre:

— Ç'kini? — tha plaku.

— Mos! — i kapi dorën Liria shoqes së saj.

— Gjysh, — i tha Zamira, — kur u nisëm nga Tiranë, i ati e porositi njëqind herë Lirinë t'i sillte një rrënjë portokalli. Por ne nuk gjetëm, se qëndruam më shumë në Sarandë dhe Butrint...

— Mirë, moj bijë, — tha plaku, — ta jep gjyshi portokallin.

— Po ti...

— Hë, se do të vij përsëri unë, — dhe plaku ia dha portokallin Lirisë. Kjo e mori me kujdes. Plaku e pa portokallin dhe i tundi kokën, sikur po përshëndetëj. Në restorant ishte qetësi. Dëgjohej vetëm deti, që vinte deri afër tyre, duke nanurisur natën, që ishte aq e bukur dhe aq e kthjellët.

NJERIU QË TAKOJA SHPESH

Qyteti i vogël N ia shuan kureshtjen njerëzve shumë shpejt. Për t'i rënë nga lagjja e sipërme deri në atë të poshtmen, nuk të duhet më shumë se gjysmë ore, bille edhe duke studjuar arkitekturën e shtëpive. Dhe me gjithatë, njerëzit që kanë banuar aty, thonë se N-ja krijon një intimitet, i cili nuk të ndahet asnjëherë dhe të detyron të qëndrosh një natë aty, kur të bie rruga. Të them të drejtën, kur shkova për herë të parë për të marrë emërimin si agronom, kjo gjë nuk më ra në sy. Mbasit u vërtita rrugëve, u ula në tavernën e turizmit dhe porosita një peshk dhe një gotë verë. Ishte vjeshtë dhe mbi qytet frynte një erë e fortë, që gati sa nuk i thyente pemët. Kamarierja më solli peshkun duke më buzëqeshur, sikur njiheshim prej kohësh. Por unë mendova se ky është një zakon i zanatit dhe nuk ia vura shumë veshin. Ishin ditët e para të jetës sime të pavarur, larg familjes dhe konviktit. Në atë qytet nuk njihja njeri. Dhe kjo ishte e natyrshme. Familja ime, denbabaden, kishte banuar në Shkodër, kurse qyteti N, ndodhet në Jug. Të thuash se isha i mërzitur, nuk e thua dot, por, ama, edhe një farë trishtimi e ndieja. E ndieja, sepse akoma nuk kisha zënë shok dhe qyteti N më dukej i qetë, i urtë, aty në këmbë të malit dhe detit. Por s'kaloi shumë dhe takova

të njohurin tim të parë. Ishte një student për pikture, me të cilin isha njohur në aksion, në Mirakë. Ai u ul së bashku me një shokun e vet në tavolinën time dhe filloi të më pyeste. Kur mori vesh se isha emëruar agronom në kooperativën më malore të rrëthit, filloi të më fliste për peizazhin e bukur të fshatit. Unë nuk flisja, sepse akoma nuk e kisha parë fshatin. Po të dy ia kishim harruar emrin njëri-tjetrit.

- Kur do të nisesh për në fshat? — më pyeti.
— Nesër. Më thanë se zurret makina e kooperativës,
— iu përgjigja.
— Kryetarin e kam shok, — tha piktori. — Hë, se nuk ju njoha.
— Faik Lama, — tha burri.
— Agron Çoba, — ia ktheva unë dhe i dhashë edhe një herë dorën.
— Kështu, Agron, — tha piktori, — ne me Faikun do të vijmë gjithmonë, por edhe ti mos na harro. Sa herë të zbresësh këtu, o mua, o Faikun të na takosh patjetër.
— Ju falem nderit.

Faiku kishte një buzëqeshje pak si të drojtur. Ajo që më bëri më shumë përshtypje, ishin sytë e tij të butë dhe të thellë. Dukej që ishte një burrë i përbajtur dhe krejt i kundërt 'me piktorin. Të them të drejtën, kjo më habiti pak. Piktori, si gjithë studentët e artit, ishte djalë i hedhur dhe pak harrakat. Nuk ma merrte mendja që Faiku të ishte një shok i këndshëm për shaka. «Por qyteti N është i vogël dhe i bashkon njerëzit», mendova. Piktori filloi të kujtonte ditët e aksionit dhe qyfyret e jetës studenteske. Dhe, me sa kam vënë re, studentët e arrit kanë shumë qyfyre. Ndofta, ngaqë dinë t'i tregojnë edhe bukur. Por biseda kalonte në gjëra të ndryshme, dhe unë harrova se ajo ishte dita e parë imja në qytetin e vogël N. Faiku nuk para fliste. Ngandonjëherë ai buzë-

queshte vetëm sa për të mos ia prishur humorin shokut të vet. Në tavernë qëndruam deri sa e mbyllën. Piktori i përshëndeti me intimitet kamarieren dhe kuzhinierin dhe i porositi të më kishin kujdes, kur të viaj herët e tjera.

Në rrugë frynte mjaft erë. Ngrita jakën e paradesysë dhe m'u kujtua se kur shkruaja poezi (kur isha student), më pëlqente ta përfytyroja veten në një qytet të huaj me jakën e paradesysë ngritur dhe me cigaren gjysmë të fikur në buzë. Qesha. Në atë erë ishte e kotë të ndizje cigaren.

— Ç'do të bësh? — më tha piktori.

— As vetë nuk e di. Por më mirë po shkoj në hotel.

— Eja nga unë, — tha Faiku. — Gruaja është në punë, kurse fëmijët me siguri do të shkojnë për peshk.

— Jo, — i thashë. — Jam pak i lodhur dhe do të shkoj të shtrihem.

— Mirë, — tha piktori. — Takohemi në darkë. Apoj, Faik?

— Në rregull.

— Si nuk ma prishe një herë, mor Faik! — bëri shaka piktori.

Faiku vuri buzën në gaz dhe nuk ë vështroi në sy shokun. U ndava prej tyre dhe shkova të shtrihesha në hotel. Rrugës nxitonin duke qeshur vajzat e shkollës së mesme. Unë i ndoqa me sy dhe m'u kujtua kthimi im nga shkolla. Tani në rrugën e shkollës ecnin të tjerë. Dhe nuk e di pse ai qytet i vogël, në këmbë të malit dhe detit, më kujtoi fëmininë. Ndofta prandaj dhe e quajnë N -në qytet intim.

Të nesërmen u nisa për në fshatin ku do të punoja. Ishte koha e të vonave, prandaj u harrova në punë. Vëtem pas dy muajsh zbrita në qytetin N Koha ishte e qëtë dhe nuk frynte erë.

— Sepse pata përshtypjen sikur këtu fryn gjithmonë erë, — i thashë Faikut.

— Ç'ka, edhe fryn. E takove Edin?

— Jo.

— Shkojmë hamë bukë, pastaj e takojmë. Sot kemi vendosur të shkojmë se mos punojmë ndonjë peizazh.

Unë u mata të ecja drejt restorantit, kur Faiku më zuri për mënge.

— Jo, do të vish nga unë.

Unë jam tip i drojtur dhe s'para futem tek njerëzit që sapo i kam njojur, por Faikun nuk mund ta kundërshtoja. E shoqja ishte një grua e qeshur, plot humor. Ajo, sikur unë të isha i shtëpisë, filloi të fliste dhe as që u justifikua që i gjeta pa preqitur. Nuk e di, por mua nuk më pëlqen kur gruaja zë dhë i thotë burrit: «Po të më kishe lajmëruar, mor...», «sa zakon të keq që ke ti...», «as më dërgon haber...». E shoqja e Faikut më tha:

— Qyteti ynë është i bukur. Edhe të marrësh nuse prej këtej, nuk është keq. Apo jo, Faik?

— Po ja, gjeji ti ndonjë.

— S'na the gjë tani. Po mbeti t'ia gjej unë, më mirë të ngryset beqar.

Drojtja, për të cilën kisha inat veten, më pengonte të flisja dhe vetëm buzëqeshja. Përtej, midis hapësirës që krijonin perdet, dukej deti i qetë. Në kuzhinë bënte ngrrohtë dhe ndihej era e gjellës. Në mur ishte portreti i një djali të ri, riprodhuar nga ndonjë fotografi pashaporte.

— Kush është? — pyeta.

— Një shoku im. U vra në luftë, në Tiranë.

— Vetë e ke zmadhuar?

— Vetë.

Faiku punonte në repartin e pikturës. Aty ishte njojur me Edin.

— Tani keni punë, se po afron Viti i Ri, — i thashë.

— Të them të drejtën, gjithmonë kemi punë. Nga shkurti do të hapim një ekspozitë. Them të paraqit edhe unë ndonjë peizash dhe kam nja dy vjet që punoj mbi një kompozim.

— Me ç'temë?

— Nga Lufta.

— As që ka për ta mbaruar ndonjëherë, — u ankua e shoqja.

— E kam të vështirë, — tha Faiku. — Ti nuk e merr me mend sa vështirë e kam!

Mua sikur më erdhi keq. «Mos kushedi i është futur ndonjë pune që kërkon më tepër talent, sesa ka», mendova.

— Po çfarë do të paraqitni?

— Kur u përhapën fjalë nga armiku se partizanët u zhdukën, batalioni ynë caktoi tre partizanë të shkruanin parulla në muret e bashkisë. Edhe të futeshe në qytet ishte vështirë, mendo pastaj të shkruaje parulla në muret e bashkisë, ku roja qëndronte ditë e natë dhe ku hynin e dilnin gjermanë e ballistë. Por tre partizanë zbritën në qytetin tonë dhe i shkruan parullat. Njëri mbante me muhabet rojen, kurse dy të tjerët shkruanin parullat. Dhe si mbaruan punën, u larguan për në batalion.

— Qenka diçka e vështirë, — thashë.

— Po, — tha ai. — Të paktën për mua është tepër e vështirë.

Heshtëm. Gruaja e Faikut bëri gati tavolinën. U ulëm dhe ngritëm gotat e rakisë. Biseda kaloi në gjëra nga më të ndryshmet. Por unë e pyeta përsëri për pikturën. Ai më foli për detin. Detin e donte më shumë sesa tre-gonin peizazhet e tij. I thashë të më falte një peizazh.

Ai më çoi në një dhomë të vogël dhe më tha të zgjidhja vetë.

Kur u ndava prej tyre e shoqja më porositi të vija gjithmonë dhe të mos zija kurrë hotel. Kështu, kur më binte rasti, do të kthehesha patjetër në shtëpinë e Faikut. Ai ishte, si gjithmonë, i qetë dhe e donte detin më tepër sesa tregonin peizazhet e tij. Nja dy herë u ngjit deri në fshat për të më parë, se kisha kohë pa shkuar në qytet. Kështu u bë i dashur për mua qyteti i vogël N.

Megjithatë, unë nuk e kisha këtu qëllimin kur u ula për të shkruar këtë tregim. Por e pranoj, ky është tregimi im i parë dhe nuk di si shkruhen ato. Të më thuash për tokën, për grurin, për misrin, të shkruaj sa të duash, pa e torturuar veten fare, por për tregime nuk ia them. Ndofta ky është i pari dhe i fundit, prandaj qoftë me hajër. E, pra, kur e nisa këtë tregim ishte diçka tjetër që më shtyu. Po mbushja vitin e dytë në rrëthin N. Një ditë erdhi tek unë një shok i fakultetit. Ai, krahas agronomisë, mbaroi edhe për gazetari. Punonte në një organ qëndror. Si u çmallëm me kujtime, e pyeta se ç'do të shkruante tjetër, përveç artikullit për kooperativën tonë, që kishte pasur rendimentin më të lartë në misër, si koperativë malore. Ai më tha se do të bënte një shkrim për ilegalët.

— Në muzeun e N-së, pashë një shënim. Më 14 shtator 1942 iu bë atentat prefektit. Pyeta se si ndodhi kjo. Dhe drejtori i muzeumit më tregoi. Njësiti gueril, me porosi të qarkorit, caktoi dy ilegalë për vrasjen e prefektit. Njëri prej tyre është vrarë, tjetrin do ta takoj sonte. Ilegalët u armatosën me revolverë dhe zunë të presin prefektin para restorantit. Zakonisht prefekti hante drekë në orën dymbëdhjetë e gjysmë. Ora kaloi nga dymbëdhjetë e gjysma, dhe ai s'po dukej. Ilegalët u shqetësuan. Por prefekti, kushedi përsë, u duk bashkë me trimin e

vet nja njëzet minuta me vonesë. Atentatorët iu afroan me shpejtësi dhe dy plumba u zbrazën në kokë të prefektit! Sa u përmend «trimi» i tij, atentatorët ishin zhdukur. Njëri prej tyre u vra më vonë, kurse tjetrit drejtori i muzeumit më tha se do të ma gjente sonte. E kemi lënë për në orën gjashtë. Jam shumë kureshtar ta njoh. Unë, si të thuash, e përfytyroj, por prapë s'jam i qetë sa të takohem.

Nuk e pyeta shokun tim se si e përfytyronte atentatorin, por e shihja se përfytyrimi i tij kishte diçka të jashtëzakonshme. Kjo më nxiti edhe mua. Kisha për të çuar një studim në seksionin e bujqësisë dhe, meqë shoku im kishte makinë, vendosa të zbrisja në qytet me të. Me makinë qyteti N nuk mbante më shumë se tre çerekë ore. Kur hyn në N, në fillim duket deti, pastaj shtëpitë e lagjes së sipërme. Shoku im, gjatë tërë rrugës, më fliste për takimin me atentatorin. Për herë të parë e pata zili që ishte gazetar, por kjo ndjenjë më kaloi shpejt. Në qytet arritëm në orën pesë. E lashë me shokun tim të takoheshim në muzeum. Unë shkova në seksion, dorëzova studimin, por atje më mbajtën të bëja një relacion për shtimin e bagëtive të imta. Desha s'desha, e bëra dhe relacionin. Nuk e di në u pëlqeu shokëve të seksionit, por unë nuk isha veteriner, ashtu siç nuk jam shkrimitar, megjithëse po shkruaj këtë tregim. Në orën gjashtë e gjysëm u largova nga seksioni dhe nxitova për në muzeum. Kisha frikë se mos gazetari kishte mbaruar punë. Hapa derën e jashtme dhe hyra në oborr. Seç kam një zakon që, sa herë hyj nëpër muzeume, më duket sikur humbas. Në oborr ishte qetësi. Ndofta qetësinë e theksonin edhe pemët e dendura apo dritarja e ndezur e zyrës së drejtorit. Ajo ishte e vetmja dritare e ndezur. Dhe në atë dhomë gazetari bisedonte me atentatorin. Kaq donte fantazia ime për të shpërthyer. Në korridor ishte errët.

Gjeta me hamendje shkallët dhe fillova të ngjitesha. Se-pse më dukej sikur kisha hyrë gabim. Ata që ishin lart dëgjuan hapat e mia, dhe drejtori i muzeumit hapi derën.

— Ti, Agron, je? — më pyeti.

— Unë.

— Pse nuk e hap dritën? E ke në krye të shkallës. Por unë isha ngjitur. Në zyre ishte gazetari dhe Faiku. U përqafova me Faikun dhe u ula.

— S'paska ardhur? — i thashë gazetarit.

— Ja ku e ke, — tha ai dhe më tregoi Faikun.

PËRSE QËNDRONI SI TË NGIRIRË?

Ai ishte një tregim i thjeshtë për dashurinë dhe atë ia kishte treguar një shok i tij shumë muaj më parë. Shoku ia kishte treguar në bisedë e sipër, pa menduar se po i jepte një subjekt. Dhe javën e fundit Spiros po i pëlqente për herë e më shumë. Ai u ul dhe donte ta mbaronte tregimin, i cili po i dilte më i gjatë, sesa e kishte menduar. Kjo gjë nuk e mërziste, bile i lindi ideja për një novelë. Por tregimi mbaroi vetë papritur, dhe ai u çudit. E lexoi dhe ndjeu se nuk mund t'i shtonte skena të tjera. Kur doli nga zyra, ishte natë. Qielli ishte tërë yje, sikur ato t'i kishte shpërndarë era që fryu tërë mbasditen nga veriu. Ai shkoi hëngri darkë dhe të nesërmen e çoi në redaksinë e një gazete. Pastaj s'ishte i zoti të shkruante më asgjë tjetër, pa marrë përgjigje në do të botohej apo jo tregimi. Redaktori i gazetës po e vononte leximin e tregimit.

Një ditë, kur mbeti vetëm me Fredin, Spiroja ia dha edhe atij ta lexonte. Ai nuk mund të qëndronte në një vend me atë që lexonte tregimin e tij. Doli jashtë dhe u kthye më vonë, kur Fredi duhej ta kishte lexuar tregimin. Fredi e kishte lexuar tregimin dhe po vështronë përtej dritäres. Spiroja e kuptoï se ai po vështronë jashtë më shumë për t'u thelluar në mendime, sesa për

t'u çlodhur. Asnjëri nuk foli. Të dy po qëndronin në heshtje dhe sikur prisnin që të fliste tjetri i pari. Por Spiroja, edhe po të fliste, do të pyeste për tregimin, dhe kjo gjë nuk i pëlqente. Prandaj u ul dhe zuri të shfletonte një revistë të vjetër. Fredi u kthyte nga ai dhe qeshi. Spiroja nuk e kuptoi përsë qeshi Fredi.

— E? — tha.

— Ti e di se unë nuk marr erë nga letërsia, — tha Fredi.

— Megjithatë, ty t'i kam dhënë t'i lexosh për herë të parë tregimet e mia.

— Shiko, Spiro, ky tregim nuk është i keq, veçse emrat e personazheve...

— Ehë! — qeshi Spiroja dhe u kujtua. Ai i kishte vënë emrin e Fredit djalit dhe vajzës emrin e një shoqje që punonte në zyrë me ta. Ata kalonin mirë midis tyre. Të gjithë e dinin këtë. Dikush mund të kishte dyshuar. Spiroja nxohej kur dikush dyshonte kot. Ata e kishin vetëm shoqe Mirën. Fredi gjithnjë thoshte: «S'ka gjë më të bukur, sesa të ketë në shoqëri edhe vajza». Dhe Mira ishte e lezetshme. Spiroja i thoshte shpesh se ajo kishte mbetur nga shqetësimet gjithmonë studente. Mira qeshte dhe nuk nxohej asnjëherë.

— Ç't'u tek t'u vësh personazheve emrat tanë? — tha Fredi.

— Kot, — tha Spiroja. — U mendova dhe s'gjeta emra të tjerë më të përshtatshëm.

— E di ç'ke ti: ndërroji emrat!

— E përsë?

— Hiqi më mirë. Pastaj sikur s'ka emra të tjerë. Do të të gjej unë?

— Fredi, nuk ka asgjë të keqe që unë u kam vënë emrat tuaj personazheve. Ndofta, nesër do të ndahemi,

kështu që e kemi nga një kujtim. Sidomos Mira, kushedi, kur të martohet...

— Pikërisht për këtë them dhe unë t'ia ndërrosh emrat. Do të ketë njerëz që do të dyshojnë.

— Punë e madhe.

— Nuk është kaq e thjeshtë. Ti, Spiro, shpesh i thjeshtëson gjërat. Mos harro se ajo është vajzë.

— Dhe çfarë se është vajzë?

Fredi nuk u përgjigj. Ai shkoi përsëri në dritare. Qëndroi atje dhe, me kurrizin kthyer nga Spiroja, tha:

— Ti, o nuk e kuption, o bën sikur nuk e kuption!

— Unë, nuk kuptoj asgjë. Ç'të keqe ka këtu?

— Kot që e zgjasim. Ndërroi emrat dhe eja të pimë nga një kafe.

— Unë e kam çuar për ta botuar.

— Kur?

— Ka dy javë.

— Me këta emra?

— Po.

— Sa ke që e ke çuar?

— Dy javë.

— Dhe a mund të botohet?

— Nuk më kanë dhënë akoma përgjigje.

— Unë e njoh redaktorin. Në qoftë se ty të vjen turp, po shkoj unë ta tërheq tregimin, i ndërroj aty për aty emrat dhe ia jap përsëri.

— Mua më pëlqen që të botohet me ata emra.

— E përse të pëlqen kaq shumë? Emrat tanë janë nga më të rëndomtiti.

— Sepse kur e shkrova tregimin, shpesh, dashur pa dashur, ju kisha ju para sysh.

— Spiro, ti nuk duhet të mendoje kështu për ne!

— Kot, fare kot, por më e cte më mirë tregimi.

— Eja dalim se mos gjemë redaktorin.

— Po përse, djalli e marrtë, do me kaq këmbëngulje që unë t'i ndërroj emrat?

— Eja, eja.

Ata dolën dhe tërë rrugës vështronin me kujdes njerëzit që u kalonin pranë.

— Fredi, më duket se po tregohemi më shumë sesa duhet kureshtarë.

— Ty të vjen rëndë, që unë kërkoj me çdo kusht redaktorin mes njerëzve?

— Jo, por e gjithë kjo gjë më duket e kotë.

— Mirë, mirë, po sonte për djall paska shumë njerëz në xhiro.

— Lëri, ç'ke me ta, — qeshi Spiroja.

Të dy i ranë disa herë bulevardit, po redaktorin nuk e panë gjékundi.

— Po mirë, o Fredi, shkojmë nesër. Megjithëse ti kot ngul këmbë kaq shumë.

Fredi i tha natën e mirë dhe u largua. Spiroja e ndoqi me sy i habitur dhe nuk po e kuptonte dot shqetësimin e papritur të tij.

* * *

Të nesërmen tregimi u botua në gazetë, dhe Mira, sapo hyri në zyrë, i tha Spiros se tregimi i kishte pëlqyer shumë. Bile ai ishte tregimi më i bukur që kishte shkruar. Ata po prisnin Fredin. Ai u vonua atë ditë. Kur erdhi dukej i mërzitur. Mira e pyeti në e kishte lexuar tregimin e Spiros. Ai u përgjigj se nuk kishte kohë të lexonte budallallëqe. Kjo ishte një përgjigje e çuditshme dhe jo e zakonshme për Fredin. Ajo mendoi se ata të dy tani u përjetësuan në letërsi. Fredi nuk i foli, u ul në tavolinën e vet dhe, ashtu i ngrysur si u ul, ashtu punoi deri sa u lodh. Midis tyre, si frika e një njeriu që ecën mbi një akull të hollë që mund të thyhet nga çasti në

çast, mbretëronte heshtja e acaruar. Mira nuk e dinte bisedën e djeshme të tyre dhe shqetësimin e Fredit, pranadaj fliste herë pas here. Por kur e shikonte se ata të dy nuk i përgjigjeshin, edhe ajo heshtte. Kur doli Fredi, ata të dy sikur u lehtësan.

— Ç'ka? — tha Mira.

— Atij nuk i pëlqeu që e botova tregimin me emrat tuaj, — tha Spiroja.

— Vetëm për këtë?

— Po.

— E ç'të keqe ka këtu?

— Nuk e di.

— Ndofta ka ndonjë hall tjetër.

Spiroja nuk iu përgjigj në çast. Rregulloi dosjen mbi tavolinë dhe zuri të lëvizte nëpër zyrë. Ai zakonisht gjëzohej sa herë që botonte ndonjë tregim. Bile i dukej sikur gjithmonë provonte gjëzimin e botimit të tregimit të parë, gjëzim që nuk e harronte kurrë. Dhe tregimin e fundit e kishte shkruar me shumë dashuri.

— Ti the se mos ka ndonjë hall tjetër. Po të kish te, do të na e thosh. Kam frikë se, pas mërzitjes së tij, fshihet diçka tjetër, diçka që as ty, as mua nuk na pëlqen, — tha Spiroja, dhe Mira vuri re se ai i hapi e i mbylli sytë, duke i shtrënguar aq fort, sa iu formuan rrudha në ballë. Mira e njihte këtë gjë, si shenjë inati. Kështu i mbyllte dhe i hapte sytë Spiroja sa herë që haste ndonjë padrejtësi. Jashtë mëngjesi ishte i freskët, dhe në rrugë kalonin me shpejtësi makinat. Zhurma e tyre dukej si një dallgë e gjatë përshtës.

— Me siguri që kështu është, — tha Spiroja, sikur nuk po aprovonte mendimin e tij, po të një tjetri.

— Ç'farë? — tha Mira.

— Ai ka frikë se mos lindin keqkuptime nga tregimi.

— Sot i pari që takova ishte Nikoja. Ai e kishte lexuar tregimin dhe nuk m'u duk se e kishte keqkuptuar. Bile, më tha se nuk të dinte me kaq talent.

Spiroja qeshi lehtë. Ai po mendonte për Fredin. Iшин shokë, dhe ai e donte atë.

— Po ta dija se ai do të mërzitej kaq shumë, kisha gjetur emra të tjerë, — tha.

— Ndofta ai ka ndonjë hall tjetër, — tha Mira.

— Edhe unë atë dua.

Biseda e tyre nuk mund të zgjatej më shumë. Spiroja nuk e kishte menduar kështu mëngjesin e asaj dite kur do të botohej tregimi. I vinte keq që u zhgënjenye. Hyri Fredi, dhe gjëja e parë që tha ishte kjo:

— Urime, Spiro! Bën mirë të dalësh në korridor dhe të dëgjosh komentet për tregimin tënd.

Mira nuk e kapi që në fillim ironinë e tij.

— U ka pëlqyer? — tha.

— Posi, shumë! Bile ata më uruan dhe mua.

— Përse të uruan?

— Po ja, që qenkat një personazh kaq i goditur në jetë. E s'thonë kot, që shkrimtarët janë dreqi vetë!

— Ti, Fredi, e di se unë nuk jam shkrimtar, — tha Spiroja.

— Po të pëlqen, ama, të bëhesh. Pastaj, ç'rëndësi ka? Në mos sot, nesër patjetër që do të japësh intervistë për veprat e tua të pabotuara.

— Nuk më pëlqen të zihem me ty, Fredi, — tha Spiroja.

— Kujt nuk i pëlqen, ty apo mua? — Më fal: në ç'datë jepen honoraret? Duhet t'i pimë të tre, apo jo?

— Patjetër që do të mblidhem i të tre atë ditë, — tha Mira.

Fredi e vështroi me tallje Mirën dhe nuk foli. Ajo u prek dhe doli jashtë.

— Përse e fyeve? — tha Spiroja.

— Kë?

— Mirën.

— S'ma merr mendja të fyhet aq lehtë. Mos u bë, sentimental, i dashur Spiro. Ajo është ende e papjekur prandaj nuk kuption shumë gjëra. Kur të vijë, unë do të bëj një shaka me të, dhe ajo do të harrojë gjithçka.

Komentet për tregimin vazhduan disa ditë në institucionin e tyre. Aty punonin pak veta, prandaj dhe e lexuan njëri pas tjetrit. Dikush bëri shaka me Fredin. Por ai ia preu shkurt se tregimi ishte një trillim i fantazisë së Spiros. Dhe, siç është e natyrshme, njerëzit u lidhën me punën e tyre dhe e harruan tregimin. Megjithatë, Spiroja e ndiente se Fredi ishte i shqetësuar. Edhe Mira e ndiente. Ai u largohej gjithmonë, sidomos Mirës.

— Ai sikur më ka frikë kur më takon në korridor, — i tha ajo Spiros. — Menjëherë më thotë se nuk është e hijshme të bisedojmë në korridore. Ne gjithmonë kemi biseduar në korridor. Sot i thashë të zbrisnim bashkë në bufe. Ai nuk donte.

— Ndofta ka frikë se mos njerëzit dyshojnë se tregimi është shkruar për ju të dy.

S'ka kuptim, — tha Mira. — Ai edhe këtu rri ftohtë. Nganjëherë më vjen çudi dhe më duket sikur ne nuk kemi qenë aq shokë.

— Ndofta dhe nuk kemi qenë, Mira.

Ajo shtangu dhe u kthyte e tëra nga Spiroja. Ai nuk e duroi dot vështrimin e saj dhe uli kokën.

— Tani, pavarësisht se nuk më pëlqen, unë them se nuk e kemi njojur njëri - tjetrin.

— Po ne kemi kaq kohë bashkë...

— Mira, — tha Spiroja, — unë të kam aq shoqe, saqë nuk kam pasur asnjë deri më sot. Dhe ti je vajzë e mirë. A të kujtohet Pëllumbi?

— Po.

— Po drejtori i parë?

Mira nuk u përgjigj.

— Drejtori i parë, — vazhdoi Spiroja, — bëri si bëri dhe e qarkulloi Pëllumbin, vetëm se ai dashuroi Verën. Më duket se të gjithë ia vunë në dukje këtë, apo jo? Kurse ai nuk e pranoi, ashtu siç nuk pranoi shumë gjëra në fillim. Por, kur iu ngritën të gjithë, e pe si u thye prepotencia e tij? Unë e njoh Pëllumbin më mirë se veten. Ai pret tani të bëhet baba. Dhe është shumë i lumtur atje ku punon.

— Po ç'lidhje ka kjo me Fredin? Drejtori shkoi atje ku e meritonte.

Spiroja shkoi afër dritares dhe u mbështet mbi parvazin e saj. Jashtë ende nuk kishte ardhur pranvera, po ajo ndihej. Të paktën ata të dy e ndienin afrimin e saj. Rojtari plak, që kishte dalë para dy vjetësh në pension, kujdesej për kopshtin e vogël, sa vinte pranvera. Ai po mbillte lule. Në zyrën e tyre dëgjohej goditja e lehtë e kazmës që shkriftonte tokën. Rojtari plak lodhej kur e nxirrte kazmën dhe rënkim i tij vinte deri në zyrë.

— Ai i do shumë lulet, — tha Mira. Po vjen pranvera, Spiro.

Ata kishin disa vjet që punonin aty dhe ishin mësuar të përcaktonin ndërrimin e stinëve nëpërmjet kopshtit dhe rojtarit plak. Të dy qëndronin në këmbë dhe vështronin format e reve dhe çatitë e kuqe e të qeta të shtëpive. Drurët e zhveshur të pemëve ngatërrorëshin midis tyre si mendimet e paqarta që sillte padurimi i ardhjes së pranverës.

— Ti mos u mërzit, — tha Spiroja.

Mira nuk foli, mbështeti kokën në dritare dhe përshtëndeti rojtarin plak.

Ka shumë gjëra që nuk i zbërthejmë dot, ngaqë ndo-

dhin papritur. Bile ne nuk e kuptojmë të papriturën, me gjithëse e pregatisim vetë. Prandaj çuditemi, shqetësohem, dëshpërohem. Në këtë gjëndje i la ata të dy sjeillja e Fredit. Spiroja tani u lidh më tepër me Mirën, por kjo ishte një lidhje e heshtur, e drojtur, sikur kishte frikë mos thyhej papritur. Fredi hynte dhe dilte sikur në zyrë s'kishte njeri. Ai, edhe kur i përshëndeste, nuk i vështronë në sy. Spiroja mbyllej në vetvete dhe mendonte, kurse Mira bënte ç'bënte dhe mbështete kokën në dritare. Kur në kopsht punonte rojtari plak, e përshëndeste me dorë. Rojtari plak ngrinte trupin e lodhur dhe i buzëqeshte. Pastaj ia bënte me shenjë se lulet po rriteshin. Mira aprovonte. Dhe në aprovimin e saj Spiroja ndiente një farë trishtimi.

Atë ditë ata ishin vetëm në zyrë. Fredin e kishte thirrur drejtori i ri. Fredi u ngrit dhe eci shumë lehtë. Kështu ecte ai kur shkonte tek drejtori. Kur u kthyte, ishte i qeshur.

— Që kur u botua tregimi, nuk isha takuar me drejtorin, — tha. Ata u çuditën nga kjo hyrje.

— Ç'të donte? — tha Mira.

— Kot. Më pyeti si shkonim me punën. E di, Spiro, edhe tregimin tënd e kishte lexuar. Interesant sa shumë lexon ai, — tha Fredi dhe nisi të fliste shpejt, sikur kishte harruar të pushonte. Ata të dy e vështronin dhe nuk e kapnin domethënien e këtij ekzaltimi. Fredi e ndiente këtë dhe bënte ç'mos t'i sillte në formë. Por ata vetëm e dëgjonin, të hutuar. Ai u tha të shkonin të pinin nga një kafe. Ata nuk lëvizën. Pastaj dhe ai heshti papritur. Hesh-tja e rëndoi gjendjen e tyre. Nga jashtë u dëgjua kazma e rojtarit plak.

— E di, — tha Fredi, — ne kemi kohë që nuk kemi pirë bashkë kafe. Mua më ka marrë malli. Besoj se edhe juve ju ka marrë malli. Hej, sa mirë e kupton letërsinë

drejtori! Sa vajti ora? Një pa pesë. Kemi vetëm pesë minutë kohë për të zënë bufenë hapur. Hej, më qeshet kur kujtoj drejtorin! Sa mirë e kuption letërsinë!... Minutat po ikin dhe ju e dini se, po kaloi edhe një minutë nga njëshi, Tana s'na bën kafe, sikur të hidhemi përpjetë. Hej! — Fredi qeshi me vete dhe u nis. Ai mendoi se ata do ta ndiqnin pas si atëherë, por ata nuk lëvizën. U kthyte dhe mbeti edhe ai i habitur.

— Ç'kini, pra, që qëndroni si të ngrirë? — tha.

Ata heshtën. Në heshtjen e tyre hyri zhurma e shatës së rojtarit plak, i cili rregullonte kopshtin e vogël.

Kishte ardhur pranvera.

DËBORË NËN DIELL

Qafën e Krrabës e ngjitën pa folur. Petroja e ngiste taksinë me kujdes dhe nuk e kishte kthyer kokën asnjetëherë nga xha Samiu. Ai ishte i trondit tur dhe nuk po e merrte dot veten. Shante nëpër dhëmbë, por tronditja, si një udhëtar i qetë, kishte zënë vend në tërë qenien e tij. Asfalti ndriste nga rrezet e diellit, sa të vriste sytë. Mëngjesi ishte i kthjellët dhe i heshtur. Ai sikur thithte edhe zhurmën e lehtë të taksisë, që rrëshqiste mes gjelbërimit të parë. Ruzhdiju kishte mbështetur bërrylin në xham dhe mendonte. Prapa, me kokën në prehrin e së shoqes, rrinte si i humbur xha Samiu. Petroja nxori paketën e cigareve dhe ia zgjati Ruzhdium.

- Kur u sëmur ustai? — tha ai.
- Ka nja dy javë.
- Menjëherë ra?
- Po.

Petroja donte të kthente kokën prapa, por nuk mundi. Kishte udhëtar për tërë natën, që të arrinte në mëngjes në Tiranë. Gjumë nuk kishte fare. Vendin e tij e kishte zënë ajo rrugë e gjatë që duhej të bënte, me ustanin e sëmurë rëndë.

- Këtu po vjen pranvera, — tha.
- Po, — tha Ruzhdium.

— Andej nga ne ka ende dëborë.

— Mal, — tha Ruzhdiu.

— Po, po, mal.

Dhe përsëri nuk dinin ç'të flisnin. Majë Krrabës kishëtë mjegull dhe frynte erë. Ajo hyri në kabinë dhe e detyroi Petron të kthente kokën nga ustai. Era i përkëdhelte ustait flokët e thinjura.

— Mbylle xhamin, — tha e shoqja e xha Samiut.

— Jo, — u përgjigj shpejt e shpejt Petroja, — atij i pëlqente shumë era e malit.

Dhe nuk e mbyllën xhamin. E lanë erën të hynte në kabinë. Nga maja u dukën malet me dëborë. Mbi kokën e maleve rrinin retë. Vetëm në verë nuk ka rë mbi ato male. Petroja e ka parë me qindra herë këtë peizazh. Atij i bëri shumë përshtypje në udhëtimin e parë. Kurse sot ai peizazh sepse u vesh me petkun e një malli. Ngadalësoi shpejtësinë dhe tha:

— Çojani kokën. Ai nuk mund të rrijë pa i parë malet. Më thoshte gjithmonë: «Kur të dal në pension, do të shkoj në Voskopojë, në mal».

Gruaja e urtë e xha Samiut e ngriti me kujdes ushtarin dhe e mbështeti në ndenjëse. Era i rrahu fytyrën.

— E, usta, si duke? — tha Petroja.

Ustai qëndroi për një çast i pafuqishëm, pastaj habi sytë. Sëmundja nuk kishte mundur të dobësonë trupin e tij të madh. Ai nuk e kishte pasur të lehtë të shkëputet nga timoni dhe rrugët. Kur kishte shkuar në Tiranë tek i biri, dilte gjithmonë rrëzë rrugës së Elbasanit, se mos takonte ndonjë shofer nga qyteti i tij. Kur kthehet i ati në shtëpi, Ruzhdiu e kuptonte në kishte takuar njeri apo jo. Kur s'takonte njeri, i ati heshtte dhe përpiquej të flinte. Ndofta ai flinte me shpresë se mos i shihte në ëndërr rrugët dhe makinat. Ato duhet të ishin ëndrrat e tij më të bukura.

— E, usta Samiu, si dukesh? — tha përsëri Petroja.

Të tre ia kishin mbërthyer sytë kokën së thinjur të ustait. Ai hodhi sytë në kabinë, pastaj përtej xhamit të përparmë. Rruga e lagur nga vesa ndriste. Ustai qëndroi kështu për një minutë, pastaj vari kokën në supin e së shoqes. Ajo e përkëdheli si një fëmijë. Petroja nuk donte të besonte që pyetja e tij kishte mbetur e varur dhe kishte ardhur e ishte këputur, si një dru i prerë. Gruaja përkëdheli edhe një herë kokën e të shoqit dhe i tha:

— Fli, kurban, fli!

— Kur i iku goja? — pyeti Petroja.

— Para se të vije ti.

— Mezi e gjeta Stefin për t'i marrë çelësat. Ishte në një dasmë.

Petroja nuk punonte me taksi. Taksinë e kishte Stefi. Por Petroja, sa po mori vesh se ustai donte të vinte në qytetin e tij, u nis menjëherë. Më ustanë kishte bërë udhëtimin e parë, kurse tanë ustai po bënte me të udhëtimin e fundit. Taksia ecte ngadalë. Le të ishte udhëtimi më i gjatë.

— E di sa kam qenë, kur më mori ustai ndihmës?

— prishi heshtjen Petroja.

— Jo, — tha Ruzhdiu.

— Më rrinin këmbët varur në ndenjëse. Ama, një rrugë të bëje me ustanë, dhe të dukej vetja burrë. S'dinte ky dërcivërci. Kur e kapte timonin me dorë, dridhej makina.

— Ashtu është, — tha duke vënë buzën në gaz Ruzhdiu, megjithëse ndiente një farë ndrojtjeje, ngaqë po ia mburrnin babanë.

— Stefi donte të vinte vetë. E pse të mos donte! Ustai linte kokën për ne. E di ti, apo jo? Ja, ky baba-xhan na ka bërë njerëz mua me Stefin!

Petroja ktheu kokën nga ustai. Ai kishte mbyllur

sytë, i mbështetur mbi supin e së shoqes. Dukeshin si dy fëmijë të urtë e të qetë.

Makina po zbriste qafën e Krrabës. Dukeshin bërryllat e Shkumbinit dhe mbi to një tis i hollë mjegulle. Mjegulla e bardhë, e lehtë e pranverës. Petroja foli me vete diçka që nuk u kuptua. Dhe përsëri heshtën. Zhurma e lehtë e motorit herë dëgjohej fort, herë shuhej fare, nën degët e ullinjve. Duke parë poshtë, Ruzhdiut iu kujtua një nga ditët e tij pranë babait. Ai kishte shkuar së bashku me nënën dhe motrën në Voskopojë. Dhe papritur erdhi babai. Ruzhdiu u habit kur pa autobusin e madh në sheshin e fshatit. Deri atëherë nuk kishte shkuar ndonjë autobus i madh në Voskopojë.

— Mbete kokëshkretë, mor i zi, — i tha nëna.

Babai, si zakonisht, vuri buzën në gaz nga fjalët e nënës.

— S'më gjen gjë mua, jo, — tha ai.

Ruzhdiun e pushtoi një ndjenjë e ngrohtë për babanë, që ishte aq i patrembur. Shkuan poshtë nga luadhet, tek një çezmë që i pëlqente shumë babait. Qëndruan dy orë. Nëna rrinte e rrinte dhe shante. Babai vetëm buzëqeshte.

— Si do t'ia bësh kur të kthehesht, mor qyq?

— Mos, u mërzit grua! Mbi Voskop ty do të të zbras.

— Nuk kam hallin tim, jo, se ku do të mytemi pa ty, por s'vure që s'vure mend...

— Do pimë ujë tek Çezma e Floririt, pastaj do të nisemi. Apo jo, grua?

Nëna u zbut menjëherë. Ruzhdiu habitej me nënën. Ajo e donte shumë Çezmën e Floririt. Edhe babai. Ish-te i vogël dhe nuk e kuptonte përsë prindët e tij e domin aq shumë atë çezmë të zakonshme. Ruzhdiut i kujtohet mirë gjithçka, por sidomos shprehja që përsërisnin prindët e tij.

— E, mban mend, moj grua?...

Dhe nëna tundte kokën. Ishin rritur në Voskopojë.

Kur u nisën, babai e vuri Ruzhdium, si zakonisht, mbi motor. Rruga ishte e prishur nga shirat. Autobusi kaloi pishat e Gjonomadhit dhe doli mbi kthesat e forta të Voskopit. Nëna nuk ishte më e shqetësuar. Babai ndali autobusin dhe u tha pasagjerëve të zbrisnin. Zbritën të gjithë.

— Edhe ti, — i tha babai nënës. — Merre çupën dhe zbrit.

Nëna nuk e kishte kundërshtuar asnjëherë babanë. Ajo zbriti.

— Mos do të zbresësh edhe ti? — i tha babai Ruzhdium.

— Jo.

— Jo, se mos kushedi nga ke ngjarë, — tha babai dhe filloj të fuste marshin.

Kthesa ishte shumë e fortë dhe rruga e ngushtë. Ai i shkoi kthesës derisa rrotat e para filluan të dilnin pak mbi rrugë. Ruzhdium pa motrën tek po qante dhe nënën që tundte kokën. Babai frenoi dhe i dha makinës përsëri prapa. Ai e përsëriti këtë gjë tri herë. Kur mori kthesën, babai qeshi. Ruzhdium e kuptoi se ajo e kishte lodhur. Kthesat e tjera nuk i bënë shumë përshtypje. Kur njerëzit hipën në autobus, Ruzhdium e ndiente veten të madh, të fortë, sepse nuk kishte pasur frikë. Babai zuri të bënte shaka me nënën. Ajo rrinte dhe dëgjonte. Ruzhdium nuk foli fare gjatë rrugës. Rrinte rëndë dhe përpigjet të imitonë të atin.

Dhe tani që shikonte nga qafa e Krrabës luginën e Shkumbinit, iu mblodh një lëmsh në grykë dhe donte t'ia tregonte edhe Petros kujtimin e asaj dite fëmijërie pranë babait. Por Petroja frenoi taksinë te çezma.

— Këtu ndalonim gjithmonë, — tha ai. — U hidhnim ujë makinave. Hajde ta nxjerrim pak.

E kapën nga tē dy krahët dhe e ulën pranë çezmës. Ustai nuk kishte forcë ta mbante kokën lart. E shoqja lagu shaminë dhe i férkoi ballin. Pastaj u ngritën. Petroja ishte i sigurtë se ustai nuk do tē qëndronte i hesh-tur. Tani donte që ta ngiste makinën më shpejt, që tē arrinin sa më parë nē viset nga udhëtonin më tepér. Ra-në nē fushë. Era nuk ndihej më. Ndihej aroma e tokës së lëruar. Ruzhdiu i tha s'ëmës tē vinte përpara, tē çlo-dhej pak. Por ajo tha se nuk ishte e lodhur. Petroja e njihte mirë atë grua tē urtë. Ajo nuk do tē lodhej kurrë, sado që tē zgjaste ai udhëtim, duke mbajtur nē prehër kokën e tē shoqit. I thanë se mos donte tē hante gjë. Tha përsëri «jo». Ruga shtrihej nën ca rrepe tē lashta.

— Ej, — tha Petroja me veten e tij, — sa herë e kemi bërë këtë tē uruar rrugë!

Ruzhdiu ktheu kokën dhe, ngaqë nuk dinte ç'të fli-ste, u rregullua nē sedile. Nuk donte tē besonte se ky ishte udhëtimi i fundit i tē atit. Edhe kur i lindte ky mendim, e largonte menjëherë. Dikur kishte pasur dëshirë tē bëhej shofer, si çdo fëmijë, por u bë gazetar. Megjithë-se shikonte ngjashmëri midis këtyre dy profesioneve, prapë kishte çaste kur fëmijëria e mbulonte me ëndrrat e saj.

... Ai e priste babanë tek udhëkryqi nē çdo kohë. Një-herë kishin fjetur tek «Plloça e Vjetër», sepse ishte pri-shur motori... Njëherë tjetër babai qe larë nē liqen. Ai ishte zhveshur dhe ishte hedhur nē ujë, ashtu i trashë siç ishte, dhe kishte zënë tē notonte. Në fillim ai kishte pasur frikë se babai nuk do tē dinte not... Kur bëheshin qershítë nē Elbasan, babai sillte shportën e madhe plot. Ai hante e hante, dhe babai kënaqej e qeshte me tē... Në shtëpi kishte një guaskë tē madhe deti. Ia kishte sje-

llë babait nga Saranda. Në qytetin ku kishte lindur, në shtëpinë e vjetër ishte kafazi bosh i pëllumbave... Pastaj ai kishte dashuruar një vajzë. Babai kishte ndalur makinën para fakultetit dhe e kishte thirrur me zë të lartë. Ai kishte çarë mes studentëve, i skuqur nga turpi. Babai i kishte thënë se donte të takonte vajzën. Ai kishte ulur kokën. Vajza qe afruar vetë. Babai i kishte dhënë dorën dhe i kishte thënë se radhën tjetër do të merrte me vete edhe nënën. Ajo ishte bërë merak. Babai kishte thënë se gratë bëhen gjithmonë merak kot fare. Dhe ishte nisur. Ruzhdju kështu e kishte të ngulitur në mëndje: përherë duke u nisur, duke lënë prapa karrocerinë me targën e bardhë. Boja e targës mjegullohej dhe kthehej në mall për shtëpinë e vjetër ku kishte lindur. Në oborrin e saj dëgjoheshin hapat e babait...

— Fli, kurban, fli! — foli gruaja e urtë e xha Samiut.

— Mos u trondita? — tha Petroja.

— Jo, xhan, jo, — tha gruaja. — Mos u bëj merak fare për ne.

— Doni të ndalojmë në ndonjë vend të hani bukë?

— Jo, jo.

— Le që, ustai do të na thotë vetë të ndalojmë.

— Të lumtë ajo gojë!

Petroja tundte kokën, sikur habitej me mendimet që i lindnin. Ai lëvizte vetullat dhe fliste nëpër dhëmbë.

— Apo jo, or jo!. — Dhe si rrinte pak, i drejtohej Ruzhdiut: — Ja, e shikon këtë burrë! Kur merrte vesh se kishin mbetur shokët të izoluar, nisej pa pyetur fare. Dhe ne, sapo shikonim dritat e makinës, e njihnim xha Samiun. Ka lezet kështu, bre! Lëre, mor, mos m'i thuaj mua këto!

Petroja harronte se kujt i drejtohej dhe fliste gjatë. Me siguri, në përfytyrimin e tij shfaqeshin gjithë njerëzit

që kishte njohur xha Samiu. Dhe fillonte bisedën me ta, me një nerv të tendosur.

— Si o nuk e mbaj mend! E, o, e! Ja, ky burrë ishte. Se mos je ti i pari që hidhesh në zjarr! Tamam kur kishte vërvhuar uji në Qafëzez, ja ky, nuk pyeti fare pér kokën e tij, por e kaloi. Ore, njeriu, po mendoi vetëm pér kokën e tij, nuk është njeri. Apo e kam gabim?

— Çfarë? — tha Ruzhdiu?

Petroja u hutua pér një çast dhe nuk diti ç'të përgjigjej.

— Them se njeriu nuk duhet të mendojë vetëm pér veten.

Ruzhdiu pohoi me kokë. Petroja nuk fliste më. Kudo ishte qetësi.

— Qejfi i tij ishte të shkonte i pari me makinë, kur hapeshin rrugët.

— Ashtu është, — tha e shoqja e xha Samiut.

— «Po pse tē pëlqen kaq shumë, ë?» e pyesja nganjëherë, por ai s'më kthente përgjigje. Qeshte.

Kishin kaluar Librazhdin dhe po i afroheshin Hotolishtit. Ustai lëvizi. Petroja frenoi.

— Çfarë do, usta?

Fytyra e hequr e ustait u mblodh. Ai u përpooq tē buzëqeshte dhe lëvizi pak buzët. Asnjëri nuk kuptoi se ç'donin tē thoshin buzët e tij.

— Petroja jam, usta, Petroja!

Ustai lëvizi përsëri pak kokën.

— Si tē duash, po ne thamë tē pushonim pak, — tha Petroja dhe e nisi taksinë.

Ruzhdiu u habit. I ati nuk kishte folur asnjë fjalë, kurse Petroja i ishte përgjigjur sikur tē bënин një bisedë tē zakonshme.

— Ju thashë unë se ai do tē fliste, ju thashë! — Dhe Petroja, pa e kuptuar, shkeli gazin.

Nga malet në të djathtë derdheshin të bardhë, të kthjellët përrenjtë e dëborës. Ata ishin të shumtë dhe afër njëri - tjetrit. Dukeshin si shirita që i lëkund era. Uji që binte nga një shkëmb i lartë, formoi ylber. Pastaj ai u zhduk. Askush nuk e dëgjonte zhurmën e tyre, me gjithëse ajo ishte e pranishme në atë kabinë të vogël. Atë zhurmë kishte qejf ta dëgjonte ustai në gjumë. Ai flinte pranë tyre. Zhurma e përrenjve malorë, kur vjen pranvera...

Ustai hapi sytë dhe pa rrotull, duke lëvizur me zor kokën.

— Je mirë, xhan? — tha e shoqja.

Asnjëherë në jetën e saj nuk i kishte thënë kështu, as kur ishin vetëm dhe as në prani të njerëzve të tjerë.

— Mos ia ki merakun, nuk vdes kollaj ustai. Kam frikë se mos kërkon timonin dhe nevrikoset, — tha Petroja.

Ruzhdju qeshi. Edhe e ëma vuri buzën në gaz.

— Ta paçim borxh për gëzime, për të gjitha! — tha ajo.

— Ç'është ajo fjalë, të mos e dëgjoj më. Për ustanë...

Në kthesën e Quksit, ai i ra borisë fort. Po kalonin një grup kamionash. Shoferët, sa shikonin ustanë, i binin borisë si përshëndetje dhe pyesnin.

— Mirë është, mirë! — u thërriste Petroja. Por sepse ia pati frikën tërë atij gëzimi. Dhe përsëri, si atëherë kur u nisën, nuk guxonë të kthente kokën prapa. Mbështeti bërrylin në xham dhe ndezi një cigare. I dukej sikur ishte lodhur së foluri. Fërkoi sytë dhe sikur humbi durimin. E hodhi cigaren dhe ndezi një tjeter. Qafa e Thanës ishte e turbullt. Era ishte më e lehtë, por të priste fytyrën. Mbylli ngadalë xhamin. Dushqet e rralla dukeshin si të

ndryshkur. Në rrënje të tyre ishte lëndina e bardhë e dëborës së fundit.

— Ra shumë dëborë sivjet? — tha Ruzhdiu.

— Çka.

— Sikur nuk bie më dëborë, si qëmoti.

— Jo, mor, edhe bie.

Dhe përsëri heshtën. Taksia ngjitej duke u sforuar. Nuk kishte shumë lëvizje. Ruzhdiut kështu i kujohej Qafa e Thanës në këtë muaj. Ajo priste ashtu e ftohtë, e heshtur. Nuk e dinte, por sapo fillonte ngjitja e saj, ndiente praninë e shtëpisë ku kishte lindur, dhe, sapo mbaronte zbritja e saj, kur kthehej për në Tiranë, shtëpia i dukej e largët. Prandaj provonte një ndjenjë të çuditshme sa herë që ndodhej në Qafë - Thanë. Një ndjenjë të tillë ai kishte provuar natën e parë në Tiranë, kur, duke ndenjur me xhaxhanë në ballkon, kishte parë Krrabën. Përfytyrimi i tij nuk shkonte drejt e në shtëpi, shkurt, por udhëtonte gjatë tërë rrugës automobilistike. Ishte djalë shoferi.

— Bjeri borisë, — tha papritur ustai.

Ai zë i dobët ushtoi në kabinë si një buçitje e tërë asaj pritjeje. Një zë të tillë duhet të kenë boçet e pishave kur çelin, bari kur çan tokën pas shiut, mollët kur hapin lule, gjethet e vishnjave, zogjtë kur fluturojnë për herë të parë. Ai zë ishte i thellë, ishte zëri i një jete tetëdhjetëvjeçare. Ata që ishin në kabinë nuk e besuan në fillim. Pritën që të dëgjohej përsëri. Por ustai nuk foli më. Dhe ata thanë me vete se u bënë veshët. Petroja e mblo-dhi veten dhe i ra fort borisë. I ra gjatë, gjatë. Dora i dridhej dhe gati sa nuk qau.

— Shoferi mbetet deri në fund shofer, — tha.

Petroja ndaloj makinën tek çezma buzë liqenit. Ustai bëri një përpjekje për të ecur vetë.

— Lëreni, — tha e shoqja, — ai është burrë.

Ustai hodhi një hap të rëndë. Pastaj qëndroi dhe ngriti kokën lart. Prapa vinte Ruzhdiju me Petron. Pas tyre e shoqja kishte ngrirë në vend. Të tre ngritën kokën lart. Qielli ishte i lartë. Liqeni përplaste valët e vogla pas gurëve të bardhë të bregut. Ustai hodhi edhe një hap. Edhe ata të tre hodhën nga një hap. Kallamat u përkulën në liqen. Edhe dushqet. Peshkatarët u nisën nga shtëpia buzë liqenit. Ustai i njihet të gjithë. Rrinte shpesh me ta dhe i pëlqente të dëgjonte për liqenin. Kur kapnin koran, dilnin buzë xhadesë dhe e prisnin.

Ustai ua bëri me shenjë ta ndihmonin. Petroja dhe Ruzhdiju e kapën për krahu dhe e afruan tek çezma. Ai u ul dhe piu ujë. Pastaj drejtoi trupin dhe përsëri ngriti kokën lart.

— Kam frikë se do të bjerë dëborë, usta, — tha Petroja.

Ustai qeshi, por nuk foli. Në rrugë tha:

— Po vjen behari.

— Po vjen, xhan, po vjen.

Pastaj fytyra iu ndriçua. Thinjat i dukeshin si vite jargavani. Nuk pranoi të mbështetej në prehrin e së shoses. Donte të qëndronte vetë dhe të shikonte. Kur kalluan urën e fundit, nisi të binte një dëborë e rrallë, e bardhë, tërë kristale. Ajo vërtitej nëpër ajër dhe binte me zor për tokë. Ishte nga ato dëborëra që bien në mars tërë përkëdheli. Ndofta, kjo është nga dëborërat më të bukurë dhe më të rralla.

— Paskan çelur mollët, — tha ustai.

Dëbora binte nën diell.

PASQYRA E LËNDËS

Udhëtim në dimër	3
Dy njerëz mes acarit	14
Ndoci i mirë	24
Gabim buzë vjeshte	38
Era e pishave	50
Ujq në verë	68
Thëllëza	82
Telegrami urgjent	91
Njeriu më i fortë	103
Portokalli	112
Njeriu që takoja shpesh	122
Përse qëndroni si të ngrirë?	130
Dëborë nën diell	140